



# Mbrojtja

Viti i 88-të i botimit  
Shtator 2020/ Nr. 9



**Gjeneralmajor Begaj-nënkolonel Erol Munir**  
Gjeneralmajor Begaj:  
SHBA-kontribut në  
modernizimin e FARSH



**Forca Tokësore-Zall-Herr**  
Trupat Komando:  
12 javë stërvitje,  
përfundon Kursi XVI



**Zv/ministri në Kumanovë**  
Koçi: Brigada (SEEBRIG)  
promovon bashkëpunim  
dhe stabilitet rajonal



**Akademia e FA**  
**Ministrja e**  
**Mbrojtjes**  
**Olta Xhaçka:**  
**Aplikojnë 675**  
**maturantë**  
**për të ndjekur**  
**studimet**  
**Bachelor**

# Përmbajtja

Numri 9

## STUDIMI

- 5** Xhaçka: Janë 8 kuota, ja afati për të aplikuar

## YURI KIM PUBLIKON VIDEON

- 12** Bombarduesi amerikan B-52 fluturoi mbi qiellin shqiptar

## BETEJA E VARSHAVËS

- 13** Zv.ministri Petro Koçi në 100 vjetorin e Betejës së Varshavës

## DREJTUESI MODEL

- 27** Ndahet nga jeta komandanti i QBO, kolonel Neshet Shena

## ANALIZA

- 41** Një Ukrainë e pavarur është thelbësore për sigurinë euro-atlantike

## STAFI

### DED KOLA

Shef i Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

### Gazetarë:

Mimoza GOLIKJA  
Saimir ALIJA

### Graphic Designer:

Afërdita HYSAJ



## 4 AKADEMIJA E FA

**Ministria e Mbrojtjes Xhaçka: Aplikojnë 675 maturantë për të ndjekur studimet Bachelor**

675 maturantë, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm këtë vit, kanë zgjedhur shkencat ushtarake pranë Akademisë së Forcave të Armatosura...



## 9 BEGAJ-EROL MUNIR

**Gjeneralmajor Begaj: SHBA-kontribut në modernizimin e FARSH**

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Bajram Begaj, priti më 20 gusht 2020, në një takim shefin e Zyrës së ODC, në Tiranë, nënkolonel Erol Munir, i cili shoqërohej...



## 10 FORCA TOKËSORE-ZALL-HERRI

**Trupat Komando: 12 javë stërvitje, përfundon Kursi XVI**

Të premten e javës që kaloi më 7 gusht 2020, në mjediset e batalionit Komando, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit XVI "Komando"...



## 45 URDHËRI

**Politikat dhe procedurat e rekrutimit të kandidatëve për oficerë të rinj në FA**

Ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka, mbështetur në pikën 4, të nenit 102 të Kushtetutës, ose Republikës së Shqipërisë, në gërmën "f", të pikës 2...



Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

# Mbrojtja



## REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror  
i Ministrisë së Mbrojtjes  
Viti i 88-të i botimit  
Nr. 9/2020

### © Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë  
revistë nuk mund të riprodhohen  
elektronikisht apo fizikisht e të  
përdoren për qëllime përfutimi, pa  
marrë autorizim nga botuesit e saj.

### Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,  
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut  
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe  
Botimeve të Mbrojtjes

### Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni “Skënderbej”

Revista mund të gjendet në formatin  
elektronik (pdf) në adresën:

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/  
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)





## Akademia e Forcave të Armatosura

# 675 Ministrja e Mbrojtjes Xhaçka: Aplikojnë 675 maturantë për të ndjekur studimet Bachelor

maturantë, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm këtë vit, kanë zgjedhur shkencat ushtarake pranë Akademisë së Forcave të Armatosura, si një prej degëve ku duan të studiojnë, që në tetor hap për herë të parë programin Bachelor.

Pak ditë pas përfundimit të aplikimeve, grupi i parë i të rinjve, nisën javën që kaloi konkurimin për kontrollin mjekësor dhe testimin fizik përmes ekipit profesionist të mjekëve dhe pedagogëve e specialistëve të edukimit fizik në AFA.

Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka ndërsa publikon edhe fotot nga procesi i testimave fizike e mjekësore, thekson se në përfundim të konkurimit do zgjidhen 60 studentët e parë të AFA, që do të nisnin vitin akademik në muajin tetor.

“675 maturantë kanë aplikuar deri tani për të ndjekur studimet Bachelor pranë AFA dhe jemi super optimistë që në përfundim të raundit të tretë do të kemi 60 studentët e parë të shkollës sonë ushtarake, shtyllës kryesore të formimit të Forcave tona të Armatosura.”, - shprehet ministrja e Mbrojtjes.

Akademia e Forcave të Armatosura, sipas ministres Xhaçka, është një mundësi e jashtëzakonshme për të gjithë të rinjtë që mbarojnë shkollën e mesme. Veç formimit

*“Në përfundim të raundit të tretë do të kemi 60 studentët e parë të shkollës sonë ushtarake, shtyllës kryesore të formimit të Forcave tona të Armatosura”*

akademik, për çdo student fitues ka një pagesë mujore ndihmëse për të gjithë periudhën e studimit, akomodim dhe ushqim falas, zero tarifë

studimi në vit si dhe punësim i sigurtë pas përfundimit të studimeve për tu bërë pjesë e elitës së Forcave të Armatosura.





# Xhaçka: Janë 8 kuota, ja afati për të aplikuar

“Krahas hapjes së programit bachelor në Akademinë e Forcave të Armatosura, Ministria e Mbrojtjes do të vijojë ofrimin e bursave të plota, për studimet në akademitë ushtarake jashtë vendit”.

**M**inistria e Mbrojtjes do të vijojë ofrimin e bursave të plota, për studimet në akademitë ushtarake jashtë vendit, konkretisht në Turqi, ku janë 8 kuota akademike. Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, bëri të ditur se afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 17 Gusht 2020. “Krahas hapjes së programit bachelor në Akademinë e Forcave të Armatosura, Ministria e Mbrojtjes do të vijojë ofrimin e bursave të plota, për studimet në akademitë ushtarake jashtë vendit. 8 kuota në akademitë e Turqisë janë dispozicion të të rinjve që përmbushin kushtet dhe duan të bëjnë karrierë në FA”, - shprehet Xhaçka. Ajo sqaron dhe cilat kurrikula ofrohen në bursa. “4 bursa për Forcën Tokësore; 1 bursë për Forcën Detare; 1 bursë për Forcën Ajrore; 2 bursa për Fakultetin e Mjekësisë “Gulhane”, - sqaron Xhaçka, e cila kujton se dita e fundit e aplikimit

është data 17 gusht 2020.

Ministria e Mbrojtjes në faqen e saj zyrtare njofton dhe kriteret që duhet të plotësojë aplikanti dhe rrugën që duhet të ndjekur për përfituar nga bursa. “Aplikanti duhet të ketë shtetësi shqiptare. Ai duhet të ketë kryer arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe ekuivalente nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë ose në raste të veçanta të jetë në vitin e fundit të studimeve parauniversitare. Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë. Të jetë në moshë jo më pak se 18-vjeç dhe jo më shumë se 20 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik. Të mos jetë i martuar, i fejuar, i ve ose të mos bashkëjetojë. Të jetë i aftë nga ana shëndetësore. Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 170 cm për meshkujt dhe jo më pak se 165 për femrat dhe pa tatuazhe. Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme) të tjera. Të mos ketë kaluar apo të vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zembrës, veshkave, hepatike, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose jetë përdorues i lëndëve narkotike”, -sqaron Ministria e Mbrojtjes. “Kandidatët që do të aplikojnë për ndjekjen e studimeve pranë Akademive Ushtarake në Turqi të plotësojnë kriterin e notës mesatare të shkollës para universitare mbi 8, mesatarja e notave të të gjitha viteve të gjimnazit për lëndët Matematik, Fizik dhe Kimi të jetë mbi 8 dhe notat e maturës shtetërore të jenë mbi 8”, - vijon sqarimi. Po ashtu Ministria e Mbrojtjes bënë me dije dhe datat e testimit janë në datat 18-19 gusht: Testi i Gjuhës së Huaj: 18.08.2020, testi Fizik: 18.08.2020, testi Intelktual: 19.08.2020 dhe testi Psikologjik: 19.08.2020.





# Bëhuni elita e së ardhmes në Forcat e Armatosura

*Akademia e Forcave të Armatosura është një mundësi e jashtëzakonshme. Pagesë mujore ndihmëse për çdo student për të gjithë periudhën e studimit. Akomodim dhe ushqim falas për 3 vitet e studimit në Akademi. Tarifë studimi 0 lekë në vit. Punësim i sigurt pas përfundimit të studimeve*

**675** maturantë, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm këtë vit, kanë zgjedhur të studiojnë pranë Akademisë së Forcave të Armatosura, që në tetor hap për herë të parë programin bachelor.

Më 10 gusht përfundoi afati për këtë kategori aplikantësh të cilët kane plotësuar formularin pranë gjimnazit ku janë diplomuar duke zgjedhur Akademinë e Forcave të Armatosura si një ndër preferencat e tyre. “675 maturantë, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm këtë vit, kanë zgjedhur të studiojnë pranë Aka-



demisë së Forcave të Armatosura, që në tetor hap për herë të parë programin bachelor. Por aplikimi ishte i hapur për maturantët e viteve të shkuara. Më 10 gusht përfundoi afati për këtë kategori aplikantësh, të cilët kanë plotësuar formularin pranë gjimnazit ku janë diplomuar, duke zgjedhur Akademinë e Forcave të Armatosura si një ndër preferencat e tyre”, tha Xhaçka.



“Akademia e Forcave të Armatosura është një mundësi e jashtëzakonshme. Pagesë mujore ndihmëse për çdo student për të gjithë periudhën e studimit. Akomodim dhe ushqim falas për 3 vitet e studimit në Akademi. Tarifë studimi 0 lekë në vit. Punësim i sigurt pas përfundimit të studimeve. Duke zgjedhur studimet në Shkencat Ushtarake, keni zgjedhur një karrierë sa të pasur, aq edhe të sigurt! Bëhuni elita e së ardhmes në Forcat e Armatosura”, shprehet Xhaçka.

Programi mësimor “Studime në Shkenca Ushtarake” për tre vitet 2020-2023, është program studimesh universitar i ciklit të parë i organizuar në lëndë e module dhe i vlerësuar në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera formuese janë të organizuara në pesë kategori lëndësh nga A deri tek E, ku bëjnë pjesë lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse. Gjatë vitit të fundit të studimeve, studenti përgatit një temë diplome, për të cilën vlerësohet nga një komision i ngritur nga Fakulteti i Sigurisë dhe Mbrojtjes. Disiplinat mësimore, veprimtaritë dhe detyrimet akademike vlerësohen me kredite ECTS. Veprimtaritë formuese që





# Akademia e Forcave të Armatosura

## Karakteristikat e programit të studimit “BACHELOR”

*Gjatë vitit të fundit të studimeve, studenti përgatit një temë diplome, për të cilën vlerësohet nga një komision i ngritur nga Fakulteti i Sigurisë dhe Mbrojtjes*

janë pjesë e programit “Bachelor” në shkencë ushtarake ndahen si më poshtë: mësim në auditor (leksione, seminare, stërvitje me ndihmën e

kompjuterëve, stërvitje komando shtabi, prezantime, zgjidhje detyre, ushtrime praktike);-përgatitje individuale (hulumtim, kërkim, stu-

dim, punim detyrash e projektesh, përgatitje për provim, përgatitje e tezës së diplomës, etj.); veprimtari të tjera formuese të lidhura ngushtë me profesionin e ushtarakut të tilla si përnjohje terreni, analizë beteje, stërvitje fushore, vizitë mësimore, fushim dimëror e veror, praktikë në trupa, etj. Karakteristika të programit.

Programi i studimeve “Bachelor” në shkencë ushtarake ka karakteristikat e mëposhtme: është program me kohë të plotë, me një kohëzgjatje normale trevjeçare dhe në fund të tij mund të fitohen 180 kredite; procesi mësimor është i organizuar në vite akademike; studenti që ndjek studimet me kohë të plotë fiton deri në 60 kredite në vit; viti akademik zgjat 30-32 javë mësimore, i ndarë në dy semestra; semestri zgjat 15-16 javë mësimore; java mësimore është pesë ditë (e hënë-e premte); çdo ditë mund të zhvillohen deri në 5 orë mësimi; studenti zhvillon jo më shumë se 25 orë mësimore/në javë, në auditor; koha e fillimit, koha e mbarimit, sesionet e provimeve, pushimet, festat zyrtare përcaktohen në kalendarin akademik, i cili miratohet çdo vit. Ndarja e krediteve sipas kategorisë së lëndëve. Sasia e krediteve që duhet të marrë studenti që ndjek këtë program studimi për përfundimin e tij janë si më poshtë: 27 kredite (ECTS) për kategorinë A të lëndëve bazë, përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme; 99 kredite (ECTS) për kategorinë B të lëndëve karakterizuese, përgatitje për disiplinën shkencore; 22 kredite (ECTS) për kategorinë C të lëndëve ndërdisiplinore/integruese, nëndisiplina, profile dhe grup lëndësh me zgjedhje; 28 kredite (ECTS) për kategorinë D të lëndëve plotësuese, gjuhë e huaj, njohuri informatike, praktika profesionale; 4 kredite (ECTS) për kategorinë E, detyrime përmbyllëse për punimin dhe mbrojtjen e tezës së diplomës. Numri i përgjithshëm i lëndëve së bashku me praktikën në trupa (profesionale) është 36 (tridhjetë e gjashtë) orë që zhvillohen në tre vite akademike. Provi- met e studentëve organizohen sipas moduleve.



## Gjeneralmajor Bajram Begaj: Do rrisim bashkëpunimin ushtarak me iniciativa konkrete

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj, gjatë javës së parë të punës ka marrë urime për marrjen e detyrës së re. Disa nga këto urime kanë qenë nga homologët e tij, si: shefi i Shtabit të Republikës së Italisë, Hungarisë, Polonisë, Turqisë apo dhe personalitete të tjera si: ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës së Kosovës, ambasadori i Gjermanisë etj. Ata e kanë uruar për detyrën e re duke shprehur edhe njëherë mbështetjen e tyre për Forcat e Armatosura të RSH dhe vetë shefin e Shtabit të Përgjithshëm.

Gjeneral Andrzejczak, shefi i Shtabit të Republikës së Polonisë, gjatë telefonatës së tij, ndër të tjera u shpreh: "Mirëserdhët në grupin e shefave të shtabit dhe suksese në detyrën e re që nuk është e lehtë, por as shumë e

Gjeneral Andrzejczak, shefi i Shtabit të Republikës së Polonisë: "Mirëserdhët në grupin e shefave të shtabit dhe suksese në detyrën e re që nuk është e lehtë, por as shumë e vështirë"



vështirë." Nga ana e tij, gjeneralmajor Begaj, i ka siguruar homologët e tij dhe jo vetëm, për

angazhimin e tij për të përmirësuar dhe çuar më tej marrëdhëniet dhe bashkëpunimin ushtarak në nisma të mëtejshme të reja duke i përjetësuar me projekte dhe iniciativa konkrete.

Pjesë e axhendës së shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH në këto ditë kanë qenë edhe takimet prezantuese me atashetë ushtarakë të akredituar në vendin tonë. Një ndër këto takime ishte dhe takimi me atashëun ushtarak amerikan, kolonel Hilton, me të cilin, gjeneralmajor Begaj, pati mundësinë e shkëmbimit të ideve për vijimin e bashkëpunimit midis dy vendeve dhe krijimin e mundësive për rritjen dhe forcimin e këtyre marrëdhënieve.

### Kapiteni i rangut të parë

## Ferdinant Kreshpani, emërohet zëvendëskomandant i Forcës Detare

Në mjediset e Komandës së Forcës Detare, u zhvillua ceremonia e emërimit të zëvendëskomandantit të Forcës Detare, kapiteni i rangut të parë Ferdinant Kreshpani. Gjatë ceremonisë së prezantimit të zëvendëskomandantit, ishin pjesë Drejtor i Shtabit të Përgjithshëm Kolonel Ilir Pujo dhe Kolonel Leonard Çoku drejtori i personelit në SHPFA. Drejtori i Shtabit të Përgjithshëm vlerësoi karrierën dhe aftësitë profesionale të zëvendëskomandantit, e cila do ti shërbejë Forcës Detare në realizimin e misionit të saj. Në fjalën e tij ai shprehu besim se Forca Detare nëndrejtimin e kapiten të rangut të parë Kreshpani do të vazhdojë të shquhet si një nga strukturat më dalluese të FARSH, gjithashtu i uroi suksese në detyrën e re si

Forca Detare dhe efektivat e saj do të vazhdojnë të përmbushin me përgjegjësi të gjitha detyrat dhe misionin e ngarkuara



drejtues i Forcës Detare. Kapiteni i rangut të parë Kreshpani falenderoi Ministrin e Mbrojtjes dhe

Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA për besimin që kanë treguar nëpërmjet emërimit të tij në këtë detyrë të rëndësishme dhe me përgjegjësi. Ai siguroi Drejtorin e SHP se Forca Detare si dhe efektivat e saj do të vazhdojnë të përmbushin me përgjegjësi të gjitha detyrat dhe misionin e ngarkuar Forcës Detare dhe Rojes Bregdetare.



# Gjeneralmajor Begaj: SHBA-kontribut në modernizimin e FARSH

**S**hefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Bajram Begaj, priti më 20 gusht 2020, në një takim shefin e Zyrës së ODC, në Tiranë, nënkolonel Erol Munir, i cili shoqërohej nga atasheu ushtarak i SHBA në vendin tonë, CDR James Hilton.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Bajram Begaj, gjatë takimit e falënderoi nënkolonel Munir për kontributin që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë dhënë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, në ndërtimin e kapaciteteve ushtarake të FARSH. "SHBA kanë një kontribut të rëndësishëm në modernizimin e FARSH, duke e mbështetur në shumë projekte si: mjetet taktike të blinduara; helikopterët Black Hawk; Bazën Ajrore të Kuçovës; Njësinë e Mbrojtjes Kibernetike; mjetet taktike të komunikimit ...", theksoi ndër të tjera gjeneralmajor Begaj. Në përfundim të takimit gjeneralmajor Begaj i uroi suksese të mëtejshme në detyrën si shefi i ri i Zyrës së ODC dhe në karrierën ushtarake.

“ Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Bajram Begaj, priti shefin e Zyrës së ODC nënkolonel Erol Munir



## NATO publikon foton

**N**ATO ka publikuar në faqen e saj foton e rreshter Vladimir Bajramajt, pjesë e kontingjentit shqiptarë në Letoni duke demontuar një minë kundërtank. Ministrija e Mbrojtjes Olta Xhaçka duke përcjellë foton shprehet se: "Rreshter Vladimir Bajramaj, pjesë e kontingjentit shqiptar në grup-batalionin e NATO-s në Letoni, duke demontuar një minë kundërtank gjatë stërvitjes BEAVER PRIME në Camp Adaži".

## Rreshter Vladimir Bajramaj në Letoni duke demontuar një minë



Rreshter Vladimir Bajramaj, është pjesë e Kontingjentit VII, EOD, i cili ka mbrriitur në Letoni në fillim të muajt korrik 2020, si pjesë e grup -batalionit të udhëhequr nga forcat kanadeze të dislokuara në Letoni. Kontingjenti VII-te, EOD përbëhet nga 21 efektivë.

# Forca Tokësore-Zall-Herri

## Trupat Komando: 12 javë stërvitje, përfundon Kursi XVI

Trupat Komando kanë një histori të gjatë operacionale si brenda dhe jashtë vendit, ku për më shumë se 25 vjet kanë dëshmuar histori sukcesi.

T ë premtën e javës që kaloi më 7 gusht 2020, në mjediset e batalionit Komando, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit XVI "Komando". Në këtë ceremoni morën pjesë: komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Albert Mullai, komandanti i Qendrës Stërvitore kolonel David Rroku, komandanti i batalionit Komando nënkolonel Edmond Doda, komandantë të reparteve të Forcës Tokësore si dhe familjarë të kursantëve.

Ky aktivitet, ndryshe nga herët e tjera, nisi me demonstrime stërvitore, ku të ftuarit në këtë ceremoni patën rastin të shihnin nga afër veprimet e trupave "Komando" në disa stacione si: kalimi i brezit të kalitjes, mbijetesë, përgatitje fizike me elementët e rinj sipas modelit amerikan, hyrje në godinë, çlirim pengjesh dhe qitje në nivel skuadre.

Më pas, fjalën e rastit në këtë ceremoninë e mori komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Albert Mullai, i cili iu shprehu kursantëve urimet më të mira: "...Sot tha ai, është dita që ju kurorëzoni përpjekjet tuaja 12 javore duke u stërvitur në kushte ekstreme moti dhe terreni, ditën dhe natën duke shpalosur karakterin dhe shpirtin luftarak e të pamposhtur ndaj çdo situatë në të cilën jeni përballur.





Trupat Komando kanë një histori të gjatë operacionale si brenda dhe jashtë vendit, ku për më shumë se 25 vjet kanë dëshmuar histori sukcesi. Ata kanë kontribuar jo vetëm në luftën kundër terrorizmit, por edhe në shërbim të paqes dhe sigurisë, krah për krah me Aleancën në Irak dhe Afganistan” - tha ndër të tjera gjeneral Mullai.

Komandanti i Forcës Tokësore, falënderoi për punën e shkëlqyer drejtuesit e kursit kapiten Skrapalliu dhe kapiten Feti të cilët nën leadershipin e tyre dhe me punën e palodhur të instruktorëve realizuan me sukses Kursin XVI “Komando”. Më pas, Zall-Herri gjëmoi sërish nga betimi i trupave “Komando”, një betim i cili bën krenar jo vetëm këto trupa, por të gjithë Forcën Tokësore. Ceremonia u mbyll me vendosjen e beretave dhe ndarjen e

certifikatave.

Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka ka lajmëruar se ushtarët e rinj kanë përfunduar kursin Komando, duke u bërë pjesë e forcave elitë të Forcave të Armatosura. Kursi Komando XV janë trupat elitare të Forcave të Armatosura që janë stërvitur çdo ditë. Në këtë kurs kanë marrë pjesë të gjitha forcat e FA dhe jo vetëm nga ato tokësore, duke rritur cilësinë dhe sfidën për të qenë pjesë e njësisë elite.

Misioni i kursit komando është të transformojë ushtarakët që përzgjidhen të jenë pjesë e kursit komando, nga një ushtarak konvencional, në një ushtarak të përgatitur dhe të aftë për të vepruar në çdo situatë, në kushte të vështira moti dhe terreni në interes të misionit të batalionit. Risi për kursin XV Komando ka qenë pjesëmarrja e efektivëve nga repartet e tjera të FA, gjë që rrit interesin për t'u bërë pjesëtar i këtij batalioni elite.



*Trupat Komando kanë një histori të gjatë operacionale si brenda dhe jashtë vendit, ku për më shumë se 25 vjet kanë dëshmuar histori sukcesi. Ata kanë kontribuar jo vetëm në luftën kundër terrorizmit, por edhe në shërbim të paqes dhe sigurisë, krah për krah me Aleancën në Irak dhe Afganistan” - tha ndër të tjera gjeneral Mullai.*



# Yuri Kim publikon videon

## Bombarduesi amerikan B-52 fluturoi mbi qiellin shqiptar

**B**ombarduesi amerikan B-52 ka fluturuar ditën e premte, më 28 gusht 2020, në qiejt e 30 shteteve aleate të NATO-s, duke përfshirë edhe Shqipërinë. Në një mesazh në "Twitter", shoqëruar dhe me video, ambasadorja amerikane, Yuri Kim, shkruan se: "Sot, bombarduesi i Shteteve të Bashkuara B-52 fluturon mbi qiejt e 30 Aleatëve të NATO-s, përfshirë edhe Shqipërinë. Nëse nuk keni parë kurrë një B-52, atëherë kjo është një pamje për t'u parë!"

Fluturimi i bombarduesve amerikane B-52 mbi qiellin shqiptar ishte pjesë e operacionit "Allied Sky" ku gjashtë bombardues amerikanë B-52 kanë fluturuar mbi qiellin e 30 vendeve të NATO-s. Ata kanë fluturuar mbi vendet e rajonit Ballkanik si mbi Greqinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Kroacinë, Slloveninë, Bullgarinë, mbi hapsirën e vendeve perëndimore si Itali, Francë, Britani e Madhe, Gjermani, apo Poloni, Letoni, Estoni e Lituani, etj. e deri mbi qiellin kanadez. Në këtë demonstrim spektakolar u angazhuan katër sulmuesit strategjikë amerikanë të cilët fluturuan mbi Evropë dhe dy mbi Amerikën e Veriut.

Në një ditë të vetme janë realizuar këto fluturime për të demonstruar aleancën dhe garantimin e sigurisë midis vendet antare të NATO-s. Gjashtë avionët bombardues amerikanë janë shoqëruar nga rreth 80 avionë luftarakë nga të gjithë vendet e Aleancës të cilët kanë avionë luftarakë bombardues në arsenalin e tyre të Forcave Ajrore. Kanë qënë avionë nga 20 vende antare të NATO-s të cilët kanë fluturuar përkrah 6 bombarduesve amerikanë: Belgjika, Bullgaria, Kanada, Kroacia, Republika Czecheke, Danimarka, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Holanda,



Stërvitje si kjo ndihmon për të siguruar dhe përmbushur misionin tonë kryesor: të parandalojmë agresionin, të parandalojmë konfliktin dhe të ruajmë paqen.



Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Spanja, Turqia dhe Mbretëria e Bashkuar.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg tha: "Ngjarja e sotme e trajnimit demonstroi përkushtimin e fuqishëm të Shteteve të Bashkuara për NATO-n dhe solidaritetin e Aleatëve në veprim. Ndërsa bombarduesit amerikanë ka-

lojnë mbi të gjithë 30 vendet Aleatë të NATO-s në një ditë të vetme, ata shoqërohen nga avionë luftarakë nga e gjithë Aleanca, duke rritur aftësinë tonë për t'iu përgjigjur së bashku çdo sfide. Stërvitje si kjo ndihmon për të siguruar dhe përmbushur misionin tonë kryesor: të parandalojmë agresionin, të parandalojmë konfliktin dhe të ruajmë paqen."





**Beteja e Varshavës 12-25 gusht 1920**

# Zv.ministri Petro Koçi në 100 vjetorin e Betejës së Varshavës

Zv.ministri i Mbrojtjes Petro Koçi ka marrë pjesë në kremtimin e 100 vjetorit të Betejës së Varshavës të vitit 1920, një nga tetëmbëdhjetë betejat më të rëndësishme në historinë botërore. Ambasada e Polonisë në Tiranë e kremtoi jubileun e kësaj ngjarje me 15 gusht 2020, në famullinë e Shën Gjon Pali II në Bathore, në mjediset e së cilës gjenden dy pllaka që i kushtohen marshallit Józef Piłsudski dhe 100-vjetorit të Betejës së Varshavës. Data e Betejës së Varshavës festohet në Poloni si Dita e Forcave të Armatosura.

“Mrekullia e Vistulës është mbiquajtur Beteja e Varshavës, gjatë të cilës ushtria polake, nën komandën e marshallit Juzef Pillsudski, zbrapsi me sukses nga kryeqyteti polak Ushtrinë e Kuqe në mesin e gushtit 1920. Disfata e ushtrisë ruse siguroi mbrojtjen e kryeqytetit dhe mbijetesën e Republikës II Polake, e cila sapo e kishte rifituar mëvetësinë në nëntor 1918, pas 123 vjetësh moskzistencë në hartën e Evropës”, - shpjegon kontekstin e jubileut Ambasadori Karol Bachura. Beteja e Varshavës që u zhvillua në periudhën 12-25 gusht 1920, i siguroi kufijtë



“Mrekullia e Vistulës është mbiquajtur Beteja e Varshavës, gjatë të cilës ushtria polake, nën komandën e marshallit Juzef Pillsudski, zbrapsi me sukses nga kryeqyteti polak Ushtrinë e Kuqe në mesin e gushtit 1920.

lindorë të shtetit polak deri më 17 shtator 1939. Diplomati britanik i rangut të lartë, Lordi D’Abernon, e vlerësoi Betejën e Varshavës si një

nga betejat më të rëndësishme në historinë e njerëzimit, sepse fitorja e saj ndaloi përhapjen e komunizmit në Evropë të paktën për disa dekada.



# Koçi: Brigada (SEEBRIG) promovon bashkëpunim dhe stabilitet rajonal

Zoti Petri Koçi, zv/ministër i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e Kryetarit aktual të SEDM-it, mori pjesë në Kumanovë (kazerma "Boro Menkov") të Maqedonisë së Veriut, në një ceremoni solemne, organizuar më 26 gusht 2020, me rastin e vendosjes në këtë vend (me rotacion) të Komandës së Brigadës së Evropës Jug-Lindore (SEEBRIG) për vitet 2020-2026, ndërrimin e komandantëve të SEEBRIG dhe festimit të 21-Vjetorit të Komandës së SEEBRIG.

Në këtë ceremoni ishin të pranishëm krerët më të lartë politikë dhe ushtarakë të Maqedonisë së Veriut si: Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, z. Stevo Pendarovski, kryeministri z. Oliver Spavovski, ministri i Mbrojtjes znj. Radmila Shekerinska, shefi i SHPPFA të Maqedonisë së Veriut, gjenerallejtënant Vasko Gjurchinovski, zëvendësministri të Mbrojtjes dhe zëvendëshefi të SHPPFA nga vendet e Forcës Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Europës Juglindore (MPFSEE), ambasadorë dhe atashe të Mbrojtjes nga vendet anëtare të PMSC, autoritete lokale dhe personeli i Komandës së SEEBRIG së bashku me familjet e tyre morën pjesë në këtë ceremoni. Në këtë ceremoni mori pjesë edhe Zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu.

Fillimisht të pranishmit morën pjesë në përrurimin e ndërtesës së rinovuar dhe të pajisur e cila do të jetë selia e Shtabit të Përgjithshëm të Brigadës Jug-Lindore (SEEBRIG) deri në vitin 2026. Pas dorëzimit të flamurit nga komandanti i deritanishëm rumun, gjeneral brigade Tudorica Petrache dhe marrjen e detyrës nga Komandanti i Brigadës, Gjeneral brigade Aristedeis Iliopoulos, zv/ministri i Mbrojtjes i Shq-

*Zhvillohet ceremonia e aktivizimit të Komandës së SEEBRIG/Forcës Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Europës Juglindore (MPFSEE), ceremonia e ndërrimit të komandantëve të SEEBRIG si dhe e festimit të 21-Vjetorit të Komandës së SEEBRIG.*

ipërisë, Petro Koçi, ka theksuar rëndësinë e kësaj nisme për rajonin ballkanik dhe më gjerë.

Z. Petro Koçi, si Kryetari i SEDM-it, shprehu vlerësimet dhe falënderimet për autoritetet ushtarake dhe civile të Maqedonisë së Veriut për mbështetjen dhe për kushtet me infrastrukturën e krijuar për Komandën e re të SEEBRIG në Kumanovë, e cila do të jetë "shtëpia e SEEBRIG" për gjashtë vitet e ardhshme. Ai nënvizoi faktin se Forca

Shumëkombëshe Paqeruajtëse e Europës Juglindore (SEEBRIG) është një histori suksesi, pasi ka kontribuar shumë në sigurinë dhe stabilitetin rajonal, në besimin reciprok dhe forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë midis vendeve të Europës Juglindore. Gjatë ceremonisë, komandanti i SEEBRIG u vlerësua nga kryetari i SEDM-CC/PMSC, z. Petro Koçi, me medaljen "SEEBRIG Accomplishment Medal" për shërbimin dhe realizimin me





sukses të detyrave të ngarkuara.

Kurse Komandanti i sapoemëruar i Brigadës, Gjeneral brigade Aristedeis Iliopoulos, tha se "SEEBRIG u krijua 21 vjet më parë për të kontribuar në stabilitetin dhe sigurinë rajonale, si dhe për të promovuar marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë midis shteteve anëtare".

Kurse ministria e Mbrojtjes e Maqedonisë së Veriut, Radmila Sekerinska u shpreh se "Stacionimi i Komandës SEEBRIG në Maqedoninë e Veriut dhe anëtarësimi i plotë në NATO janë dy gjëra me të cilat mund të jemi të kënaqur, në një vit që do të mbahet mend edhe pas krizës globale të pandemisë së koronavirusit. Kjo na sjell një përgjegjësi të madhe, por gjithashtu tregon se mund të rrisim ndikimin tonë dhe të bëhemi një faktor i fortë për stabilitetin dhe bashkëpunimin rajonal". "Do ta bëjmë këtë përmes pranisë së selisë së SEEBRIG-ut në vendin tonë, por edhe duke rritur pjesëmarrjen tonë në operacionet e NATO-s në rajon dhe se se është jashtëzakonisht e rëndësishme që vendi të vazhdojë të investojë në stabilitetin rajonal", deklaroi ministria e Mbrojtjes, Shekerinska.

Në Brigadën e Evropës Jug-Lindore (SEEBRIG) marrin pjesë Shqipëria, Bullgaria, Greqia, Maqedonia Veriore, Rumania dhe Turqia.



# SEDM dhe disa momente kryesore në historikun e SEEBRIG

*Procesi i Ministrave të Mbrojtjes të Evropës Jug-Lindore (SEDM) dhe i Brigadës së Evropës Jug-Lindore (SEEBRIG) startoi me takimin e ministrave të Mbrojtjes të mbajtur në Tiranë në Mars 1996.*

Procesi i Ministrave të Mbrojtjes të Evropës Jug-Lindore (SEDM), filloi me një takim të Ministrave të Mbrojtjes të mbajtur në Tiranë në Mars 1996 i cili kishte tre objektiva kryesore: promovimin e bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, forcimin e aftësive rajonale të mbrojtjes, si dhe bashkëpunimin përmes përpjekjeve kolektive dhe së fundmi, lidhje që lehtësojnë integrimin në institucionet euro-atlantike. Objektivi kryesor i procesit SEDM është forcimi i mirëkuptimit dhe bashkëpunimit politiko-ushtarak në rajon në mënyrë që të rrisë stabilitetin dhe sigurinë në Europen Juglindore.

## **Disa momente kryesore në historikun e SEEBRIG**

Më 31 gusht 1999, në bazë të marrëveshjes së nënshkruar u aktivizua SEEBRIG në Plovdiv, Bullgari. Maj 2001 u deklarua gatishmëria operacionale e brigadës në operacionet e drejtuara nga OKB, OSBE dhe operacionet paqeruajtëse të drejtuara nga NATO. Prill 2003, PMSC deklaroi se SEEBRIG është gati të marrë pjesë në operacionet paqeruajtëse (PSO) të drejtuara nga NATO e BE. 2003-2007 Komanda e SEEBRIG u dislokua në Konstanca, Rumani. Prill dhe tetor 2004, ekipi i vlerësimit deklaroi Kapacitetet Operacionale Fillestare (IOC) dhe Kapacitetet e Plota Operacionale (FOC). 2006, SEEBRIG mori pjesë në operacionet në mbështetje të paqes në Afganistan. 2007-2011, Komanda e SEEBRIG u dislokua në Stamboll, Turqi. 2011-2020, Komanda e SEEBRIG u dislokua në Larisa, Greqi. 2020-2026, Komanda e SEEBRIG disloket në Kumanovë, Maqedonia e Veriut.

## **Objektivat e SEDM**

Promovimin e mirëkuptimit, besimit dhe bashkëpunimit reciprok midis vendeve anëtare, kontributi e SEDM-it dhe Brigadës së Evropës Jug-Lindore (SEEBRIG) në sigurinë dhe stabilitetin rajonal dhe botëror, rritje e ndërvëprimit dhe aftësisë së SEEBRIG dhe aftësinë për t'u vendosur në misionet mbështetëse të paqes, lehtësimin e punës të SEEBRIG në operacionet e mbështetjes së paqes, promovimin e proceseve integruese Euro-Atlantike të kombeve anëtare të SEDM.

## **Bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare**

Që nga nënshkrimi i Marrëveshjes në 26 Shtator 1998, SEDM, me vendet e saj anëtare, kanë arritur një përparim të konsiderueshëm. Deri më tani Ministrinë e Mbrojtjes të Evropës Juglindore (SEDM) kanë luajtur rol në forcimin e paqes dhe stabilitetit në rajonin e Evropës Juglindore dhe kanë kontribuar në përpjekjet e paqes edhe më tej. Gjatë këtyre viteve viteve, forumi SEDM ka qenë efektiv, me dialog që synon ndërtimin e një rajoni më të sigurt dhe më të prosperuar përmes bashkëpunimit të ngushtë rajonal dhe ndarjes së qëllimeve të përbashkëta midis vendeve anëtare dhe kombeve vëzhguese. SEDM ka rritur imazhin e vet në aspektin ndërkombëtar, si një model i shkëlqyeshëm i bashkëpunimit të ndërsjellë midis shteteve që janë të angazhuara për të forcuar paqen dhe stabilitetin rajonal dhe ndërkombëtar. Mbi bazën e këtyre vlerave është forcuar bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare, si OKB, NATO, BE dhe OSBE. Kurse instrumenti ushtarak, SEEBRIG, mundëson të punohet më ngushtë së bashku, për të përmirësuar aftësitë e përbashkëta mbrojtëse, për të ndihmuar në bashkimin me organizatat më të mëdha si NATO dhe BE, i cili forcon lidhjet Euro-Atlantike.



## Forcat Speciale në stërvitjen “Saber Junction 20”



Në stërvitjen “Saber Junction 20” nga data 3 deri 27 gusht, morë pjesë 4000 trupa nga SHBA, Shqipëria, Gjeorgjia, Letonia, Lituania, Moldavia, Maqedonia e Veriut, Rumania dhe Ukraina

Më shumë se 4,000 pjesëmarrës nga SH.B.A. dhe vendet aleate dhe partnere moren pjesë në stërvitjen “Saber Junction 20”, e cila u zhvillua në zonat e stërvitjes “Grafenwoehr” dhe “Hohenfels”, të ushtrisë amerikane në Gjermani, në datat 3 deri 27 gusht 2020. U mbledhën së bashku gjashtë aleatë të NATO-s dhe tre partnerë në Gjermani për të provuar forcën e reagimit të ushtrisë amerikane në Evropë.

Konkretisht në këtë stërvitje morën pjesë forca ushtarake nga Shtetet e Bashkuara, Shqipëria, Gjeorgjia, Letonia, Lituania, Moldavia, Maqedonia e Veriut, Rumania dhe Ukraina.

Lidhur me praninë e Forcave Speciale Shqiptare, ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, shkruan në facebook se “Forcat Speciale shqiptare treguan aftësitë e tyre më të mira krahas 4000 kolegëve aleatë e partnerë nga Shtetet e Bashkuara, Gjeorgjia, Letonia, Lituania, Moldavia, Maqedonia e Veriut, Rumania dhe Ukraina në stërvitjen “Saber Junction 20”, në bazat ushtarake “Grafenwoehr” dhe “Hohenfels” në Gjermani”.

“Saber Junction 20” është një stërvitje vjetore e cila zhvillohet nga Komanda e 7-të për të vlerësuar gatishmërinë e Brigadës 173 të Ajrit të Ushtrisë Amerikane në Evropë, në ekzekutimin e operacioneve tokësore të unifikuara në një mjedis të përbashkët, të kombinuar dhe për të promovuar ndërveprimin midis



aleatëve ushtarakë pjesëmarrës dhe vendeve partnere.

“Stërvitja së bashku me aleatët dhe partnerët tanë është një mision themelor i brigadës sonë. Sa më familjar të jemi me integrimin në sisteme të ndryshme, aq më të përgatitur do të jemi të fitojmë luftime tokësore kundra armikut për ruajtjen e sigurisë.” tha kolo-

neli amerikan Kenneth Burgess, komandant i Brigades Ajrore 173. “Formati i ri i “Saber Junction 20” lejon parashutistët tanë të punojnë gjatë gjithë procesit, të provojnë atë plan dhe më pas ta ekzekutojnë atë,” tha Burgess. “Ne patëm mundësinë të stërviteshim në MV-22 Osprey të Marines Corps të SHBA, një platformë e re për ne që siguronte

transport ajror në distanca të gjata për infiltrimin tonë të sulmit ajror në zonën e trajnimit,” tha Burgess.

“Pesë etapat në stërvitjen “Sabre Junction 20”, krijuan një bashkëpunim midis forcave pjesmarrese dhe ritrajnim. Kjo lehtësoi inovacionin dhe kreativitetin nga ana e të gjithëve forcave të përfshira,” tha komandanti Sgt. Majori Wendell Franklin, komandant i Grupit të Operacioneve JMRC.

“Duke pasur një forcë të gatshme, kjo na lejon neve dhe partnerëve tanë të jemi të sigurt se Shtetet e Bashkuara janë këtu për të qëndruar dhe se ne jemi të përkushtuar ndaj aleatëve dhe partnerëve”, tha Kapiteni Ryan Lee, Komandant i Batalioni i 2-të, Regjimenti 503, Skuadra Luftarake e Brigadës Ajrore 173. “Rregullat dhe përgjegjësitë e Brigades 173-të të stacionuar në Evropë na lejojnë t’u përgjigjemi shpejt operacioneve të paparashikuara. Ne kemi aftësinë për të masovuar dhe ndërtuar me shpejtësi fuqine luftarake në të gjithë Mesdheun, si dhe disa zona të tjera me interes për kombin”, tha kapiteni Ryan Lee.

Stërvitja ilustroi aftësinë për të ndërtuar dhe mundësuar gatishmërinë në kohë reale pasi kjo bashkoi njësi të shumta ushtarake amerikane dhe forca shumëkombëshe nën drejtimin e Qendrës së Përbashkët të Gatishmërisë Shumëkombëshe në Zonën e Trajnimit “Hohenfels”.

Për të mbështetur këtë stërvitje, automjetet ushtarake kanë përdorur gjithashtu rrugët publike për të konvojuar nga bazat ushtarake “Grafenwoehr” në “Hohenfels” në seri, në datat 5-12 gusht, si gjatë ditës ashtu edhe në mbrëmje. Për shkak të madhësisë dhe peshës së tyre, këto automjete ushtarake lëvizin ngadalë dhe kanë shikueshmëri të kufizuar. Drejtuesit e mjeteve këshillohen të kenë kujdes kur ngasin makinat pranë autokolonave ushtarake. Ekipet vëzhguan, stërviten dhe pjesëmarrësit e stërvitjes gjatë fazave të planifikimit, përgatitjes dhe ekzekutimit të operacioneve të simuluar luftarake. Brigada Ajrore 173-të gjithashtu ka rritur ndërveprimin me njësitë e tjera ushtarake amerikane gjatë stërvitjes.

U diplomuan në Turqi në Akademitë e Forcës Tokësore, Ajrore dhe Detare

## 9 kadetë kthehen të shërbejnë në Forcat e Armatosura Shqiptare

Midis 630 kolegëve të tyre nga 17 vende të botës, kadetët shqiptarë përfunduan studimet “bachelor” dhe ato të përgatitjes ushtarake në Akademinë e Forcës Tokësore, Ajrore dhe Detare dhe do të kthehen të shërbejnë në Forcat e Armatosura të RSH

Në Akademinë e Forcës Tokësore në Ankara, Turqi, është zhvilluar ceremonia e diplomimit të oficerëve të Forcës Tokësore, Forcës Ajrore dhe Forcës Detare, ku u diplomuan dhe 9 kadetë të Forcave të Armatosura të RSH, përkrah 630 kolegëve të tyre nga 17 vende të botës.

Kadetët shqiptarë përfunduan studimet “bachelor” dhe ato të përgatitjes ushtarake në Akademinë e Forcës Tokësore, Ajrore dhe Detare dhe do të kthehen të shërbejnë në Forcat e Armatosura të RSH.

Në ceremoninë e dorëzimit të diplomave të studentëve shqiptarë në Akademinë e Forcës Tokësore, në Ankara ishin të pranishëm: presidenti i Republikës së Turqisë, z. Recep Tayyip Erdogan, kryetari i Parlamentit të Turqisë, z. Mustafa Sentop, ministri i Mbrojtjes, z. Hulusi Akar, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA turke, gjeneral Yasar Guler, rektori i Universitetit të Mbrojtjes Kombëtare, prof. dr. Erhan Afyoncu, zëvendësatashu ushtarak i Shqipërisë, në Turqi, nënkolonel Majlinda Sallaku, etj.

Kadetëve shqiptarë, të cilët mbaruan akademinë me rezultatet më të larta, përkatësisht Mario Meni i Forcës Tokësore, Rodilen Allkanjari i Forcës Detare dhe Juxhin Marku i Forcës Ajrore, iu dorëzua diploma nga zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Muhsin Dere, i cili i ka falënderuar ata për rezultatet e larta të arritura, në Akademinë e Forcës Tokësore. Forcat e Armatosura të RSH, vijojnë të shtohen me të rinj të arsimuar në akademitë më prestigjioze të botës.





**M**e rastin e 100 vjetorit të Luftës së Vlorës, Presidenti i Republikës Ilir Meta, duke theksuar rëndësinë historike dhe atdhetare të Luftës së Vlorës si dhe shëmbullin e paharruar e frymëzues të saj, sidomos për brezat e rinj, në një ceremoni solemne organizuar në Muzeun Historik Kombëtar, i ka dhënë titullin “Mjeshtër i Madh”, historianit ushtarak Prof. As. Dr. Bernard Zotaj. Presidenti Meta theksoi se:

“Prof. As. Dr. Bernard Zotaj është historian ushtarak, kryetar i Shoqatës së Historianëve Ushtarakë të Republikës së Shqipërisë, i cili i ka kushtuar një pjesë të rëndësishme të studimeve të tij Luftës së Vlorës, luftëtarëve të saj dhe artit ushtarak të aplikuar në të. Gjatë karrierës së tij 40-vjeçare, Prof. As. Dr. Zotaj ka dhënë mësim në shkollat ushtarake dhe ka publikuar në vijimësi hulumtime mbi historinë ushtarake. Për kontributin e tij në fushën e historisë ushtarake nderoj sot Prof. As. Dr. Bernard Zotaj me Titullin e lartë “Mjeshtër i Madh”.

Në nderim të sakrificave të luftëtarëve të Luftës së Vlorës të vitit 1920, dhe në vlerësim të punës së jashtëzakonshme të historianëve e studiuesve tanë për të pasqyruar këtë luftë heroike, Presidenti Meta ka vlerësuar me tituj të lartë nderi edhe disa figura të tjera të historiografisë si: Prof. Muin Çami, Prof. Dr. Bardhosh Gaçe dhe dhe njëkohësisht tri luftëtarë të shquar të Luftës së Vlorës: Dr. Ali Mihali, Ali Spahiu (Malindi) dhe arbëreshin Xhovani Valenca.

Prof. Muin Çami i përket plejadës së historianëve më në zë të Shqipërisë. Ndër të parët historianë që ka shkruar për Luftën e Vlorës. Studiues dhe hulumtues i njohur si edhe një nga historianët që ka dhënë një ndihmesë të madhe në ngritjen e Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë. Prandaj nuk kishte vend më të bukur për ta nderuar atë me

# Historianit ushtarak prof. ass. dr. Bernard Zotaj, i jepet titulli “Mjeshtër i Madh”



Titullin e lartë ‘Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut’.

Një personalitet tjetër është Prof. Dr. Bardhosh Gaçe, te cilit ju dha titulli ‘Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut’. Prof. Gaçe është studiues dhe profesor në Universitetin e Vlorës “Ismail Qemali”. Është një nga autorët që ka lënë gjurmë në përshkrimin e figurave kryesore të Luftës së Vlorës të vitit 1920. Prof. Gaçe është autor i shumë veprave studimore, etnokulturore dhe antologjike. Shumë nga librat e tij të botuar lidhen me baladat, me legjendat dhe me historinë e Labërisë së tij.

Ali Spahiu (Malindi) është një nga figurat e shquara intelektuale shqiptare, me një veprimtari të

dendur atdhetare në shërbim të Shqipërisë për më shumë se gjysmë shekulli. I lindur në Malind të Skraparit, ai ndoqi studimet në Gjimnazin ‘Zosimea’ të Janinës ku u njoh e miqësua me vëllezërit Frashëri, për të vazhduar studimet e larta në Shkencat Politike-Administrative në Stamboll. Përkushtimi i tij ndaj atdheut e shoqëroi në të gjitha detyrat që mbuloi si Kryetar Bashkie i Vlorës, si sekretar i prefekturës dhe nën/prefekt i Beratit. Ky përkushtim doli akoma më shumë në pah gjatë Luftës së Vlorës, kur iu përgjigj Komitetit ‘Mbrotjtja Kombëtare’ për mobilizimin e luftëtarëve në Berat, Skrapar e Lushnje. Edhe pse i moshuar, si komandant i çetës së luftëtarëve të krahinës së tij, mori pjesë në frontin

e luftës, ku luftoi me trimëri kundër pushtuesve italianë. Për kontributin e tij të veçantë në Luftën e Vlorës dhe për çështjen shqiptare Presidenti Meta i akordoi 'Dekoratën e Artë të Shqiponjës'.

Dr. Ali Mihali ishte mjek ushtarak i lindur në Prishtinë, i rritur e edukuar me ndjenja atdhetare që në fëmijëri. Me ardhjen në qytetin e Vlorës në vitin 1911, ai ia kushtoi gjithë jetën e tij çështjes kombëtare, duke u përfshirë në lëvizjen kombëtare në Vlorë si mjek i kryengritjeve Vlorë-Mallakastër 1912, si mjek pranë qeverisë së Ismail Qemalit në vitet 1912-1914, për të vazhduar me ngritjen e spitalit të Vlorës në vitin 1914, drejtor i të cilit shërbeu për 20 vite rresht. Në vitin 1920, ai u vu në shërbim të Komitetit 'Mbrojtja Kombëtare' në spitalin e Kotës, së bashku me Dr. Shezai Çomo, për mjekimin e të plagosurve të luftës së Vlorës. Për kontributin e tij të shquar në Luftën e Vlorës, për humanizmin e trimërinë i'u akordua titulli i lartë 'Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut'.

Arbëreshi Xhovani Valenca është një figurë e rëndësishme dhe unike në Luftën e Vlorës 1920, sepse kreu një akt të pashembullt e heroik duke braktisur vullnetarisht radhët e ushtrisë pushtuese italiane në Shqipëri, duke u bashkuar me kryengritësve shqiptarë në Luftën e Vlorës dhe duke u dorëzuar atyre depot me municione.

Pas dëbimit të ushtrisë italiane nga vendi ynë, ai qëndroi në qytetin e Vlorës, ku solli dhe familjen e tij. Fashistët italianë e konsideruan si tradhëtar dhe organizuan vrasjen e tij në Vlorë në vitin 1927. Giovanni Valenza mbetet një figurë e shquar dhe e pavdekshme në epopenë e Luftës së Vlorës 1920. Për kontributin e tij të çmuar gjatë Luftës së Vlorës i'u akordua Titulli i lartë 'Kalorës i Urdhërit të Flamurit'.

Në fjalën e Tij përshëndetëse Presidenti i Republikës, duke iu drejtuar të rinjve studentë, akade-

mikëve, historianëve dhe të afërmeve dhe familjarëve të pranishëm në ceremoninë solemne të zhvilluar në Muzeun Historik Kombëtar, u shpreh: "Jam i lumtur që ndodhemi sot në Muzeun Historik Kombëtar, për të përkujtuar me krenari 100-vjetorin e epopesë së Luftës së Vlorës të vitit 1920. Jemi këtu në Muzeun Historik Kombëtar ku është ekspozuar historia jonë kombëtare, histori e cila pa mundin dhe kontributin e historianëve tanë të nderuar do të ishte e harruar, prandaj vlerësimi dhe mirënjohja në këtë përkujtim të 100-vjetorit të Luftës së Vlorës,



është edhe një nder i merituar për punën e bërë prej tyre ndër dekada. Pasqyrimi që i kanë bërë historianët tanë betejave dhe përlëshjeve me armikun, kanë skalitur portretin e Luftës së Vlorës, të atdhetarëve, të kapedenëve të çetave dhe të

luftëtarëve të Vlorës, Tepelenës, Himarës, Gjirokastrës, Beratit, Mallakastrës, Korçës, Devollit dhe gjithë trevave të kombit tonë, deri edhe të diasporës sonë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në vende të tjera evropiane.

Ky pasqyrim na jep të plotë këtë epope të fitimtarëve, që nuk lejoi copëtimin e trojeve shqiptare. Na tregon për një ngjarje historike të rëndësisë së jashtëzakonshme kombëtare, vendimtare për ekzistencën e shtetit tonë, por edhe për mbrojtjen e identitetit tonë kombëtar. Një ngjarje ku shqiptarët u ngritën në këmbë kundër pushtuesit të huaj, vetëm të bazuar në forcat e tyre, pa u ndihmuar ushtarakisht nga askush.

Evropa shkruajn' e thonë,  
Bëhet dyfek në Vlorë,  
Shqipëtarët luftojnë,  
Me një mbret dyzet milionë...

Jam i lumtur që bashkë me të ftuarit e tjerë në këtë ceremoni, kemi edhe një grup të rinjsh e të rejtash, që besoj se, në vizitën e sotme në Muze, kanë mësuar disa gjëra më shumë për historinë e Luftës së Vlorës nga historianët tanë.

Është thelbësore që historinë t'jua mësojmë brezave të rinj, duke mbajtur të gjallë të ardhmen e atdheut. Nuk mund të lejojmë, që e shkuara të lihet në harresë, apo siç na ka mësuar Ismail Qemali se: 'Një fëmijë që fle rritet, por një komb që fle vdes'.

Shqipëria duhet të jetë gjithmonë zgjuar në mbrojtje të lirisë, pasi ajo nuk fitohet një herë e përgjithmonë, por duhet mbrojtur në çdo kohë nga të gjithë.

Histori do të thotë "të kërkosh në të kaluarën", ndaj unë nxis të gjithë historianët tanë të nderuar të vazhdojnë me hulumtimet e tyre, të kërkojnë edhe më shumë në të kaluarën krenare të popullit shqiptar për të mbajtur të gjallë historinë dhe të ardhmen e kombit tonë, duke hedhur më shumë dritë mbi të vërtetat e patjetërsueshme të historisë sonë të lavdishme, që do ndihmojnë brezat e sotëm e të ardhshëm të ndërtojnë një të ardhme më të mirë, më të ndritur dhe me më shumë dashuri për atdheun tonë.

**A**gjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) i ka drejtuar në mbydhje të javës që kaloi, ditën e shtunë, datë 22 gusht, dy shkresa respektive 61 bashkive, 12 prefekteve dhe Policisë së Shtetit lidhur me situatën e zjarreve në vend.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) u kërkon bashkive që të marrin masa të plota për parandalimin dhe minimizimin e dëmeve nga zjarret. Po ashtu iu kërkon edhe prefektëve të përdorin të gjitha kapacitetet operacionale në nivel qarku, për të përballuar këto situata.

“Pushteti vendor të japë informacion në kohë reale për shfaqjen e vatrave të zjarrit. Bashkitë të zhvillojnë trajnime detyruese për punonjësit lidhur me situatat e zjarreve. Bashkitë të mbajnë në gatishmëri dhe të përdorin të gjitha kapacitetet zjarrfikëse. Në bazë të ligjit, Bashkitë, vullnetarët dhe vetë qytetarët, janë kapacitetet për shuarjen e vatrave të zjarrit.”, thuhet në shkresën për bashkitë dhe prefekturat.

Shkresën tjetër AKMC ia ka nisur Policisë së Shtetit, ku kërkohet që të vihen para përgjegjesisë zjarrvënësit.

“Të merren masa për zbulimin e autorëve të zjarreve, qofshin ato me dashje apo dhe nga pakujdesia. Zjarrvënësit të ndëshkohen sipas përcaktimeve të Kodit Penal. Zbulimi i autorëve ul numrin dhe madhësinë e zjarreve. Ndëshkimi i autorëve ndërgjegjëson qytetarët se zjarrëvënia është krim. Kërkohet koordinim me pushtetin lokal dhe kryepleqtë për identifikimin e autorëve. Të ndiqen me prioritet zjarrvëniet duke informuar publikun për autorët e tyre.”, - thekson AKMC në shkresën për Policinë e Shtetit.

Gjate kesaj periudhe ka patur zjarre ne shume zona te vendit ka jane angazhuar efektive dhe helikopterët e Forcave të Armatosura, nuk ka pasur dëme në njerëz, por fatkeqësisht shumë pemë janë djegur, si ne: në zonën e Kasharit,

# Merrni masa për parandalimin e zjarreve, të ndëshkohet përgjegjësit

Gjatë kësaj periudhe ka patur zjarre në shumë zona të vendit ku janë angazhuar efektive dhe helikopterë të Forcave të Armatosura.



pranë fshatit Kus në Tiranë; në Portëz të Bashkisë së Fierit; në vendin e quajtur “Godull”, masivi pyjor Seman, në bashkinë Fierm, ku nga flakët, është përfshirë një kodër

me ullinj dhe shkurre; ne fshatin Fullqet të Bashkisë Klos; në zonën e Salarisë në Tepelenë, në Picrragë të Fushë- Krujës, në qarqet Lezhë, Elbasan, Vlorë.

## Për shuarjen e zjarreve u përdorën pajisjet e dhuruara nga Ambasada e SHBA-së

**P**ajisjet për fikjen e zjarreve, të dhuruara nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në qershor të 2019-ës nëpërmjet programit të Ndhmës Humanitare të Komandës Europiane, u përdorën së fundmi nga forcat shqiptare të ndihmës së parë për të shuar zjarret në të gjithë vendin. Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në Tiranë njofton se, pajisjet përfshinin: kontejnerë uji për helikopterë, të cilët mund të shkarrojnë mbi 2500 litra ujë direkt në një zjarr pyjor, kamera për pamje termale, të cilat u mundësojnë zjarrfikësve shqiptarë të shquajnë viktimat të bllokuar në flakë ose të fshehur nga tymi, si dhe veshje dhe pajisje mbrojtëse e rezistente ndaj zjarrit, për të rritur mbrojtjen dhe sigurinë e zjarrfikësve dhe punonjësve të ndihmës së parë. “Dhurimi i pajisjeve të ndihmës humanitare është shembulli i fundit i bashkëpunimit të palëkundur dhe të qëndrueshëm midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë”, thuhet në njoftimin e Ambasadës së SHBA-së në Tiranë.





**H**elikopterët e Forcave të Armatosura kanë qenë këto ditë në krye të detyrës duke shuar vatrat e zjarreve në vend. Ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka ka publikuar një video, nga një operacion i shuarjes së një vatre zjarre përmes ndërhyrjes nga ajri. Ministria Xhaçka ka përshëndetur dhe vlerësuar sot punën e efektivëve të Forcave të Armatosura, teksa ka publikuar një video nga një operacion i shuarjes së një vatre zjarre përmes ndërhyrjes nga ajri. “Respekt për punën e palodhur të çdo efektiv të Forcës së Armatosur, që çdo ditë janë në shërbim të komunitetit, përmes operacioneve në ndihmë të qytetarëve në tokë e në mbrojtje të pasurisë kombëtare në ajër”, -është shprehur Xhaçka.

Keshtu një vatër zjarri është aktivizuar pasditen e ditës së hënë në zonën e Kasharit, pranë fshatit Kus në Tiranë. Flakët kanë përpirë pemët në këtë zonë prej më shumë se dy orësh, ndërkohë që mësohet se zjarrfikësit kanë mbërritur në vendin e ngjarjes. Pas dy orësh, zjarri është shuar dhe situata është normalizuar. Gjithashtu mësohet se për të shuar flakët në këtë zonë të Kasharit, është dashur edhe ndërhyrje nga ajri.

Helikopteri i Forcave të Armatosura, i specializuar për zjarret, ka sjellë ujë të majftueshëm në këtë zonë, për të normalizuar situatën. Nga ngjarja nuk ka pasur dëme në njerëz, por fatkeqësisht shumë pemë janë djegur dhe gjelbërimi, në një zonë të madhe është zhdukur krejtësisht.

Ndërkohë po në pasditen e ditës së hënë një vatër zjarri ka rënë në Portëz të Bashkisë së Fierit ku nga flakët, është përfshirë një kodër me ullinj dhe shkurre. Në vendngjarje kanë shkuar 2 zjarrfikëse, por edhe banorët e zonës kanë punuar me shuarjen e flakëve të zjarrit. Terreni i vështirë dhe flakët u favorizuan edhe nga era.

Kurse ditën e martë zjarret nga pakujdesia janë shfaqur në fshatin Fullqet të Bashkisë Klos. Një zjarr

## Xhaçka: Respekt për punën e palodhur të çdo efektiv

“Efektiv të Forcës së Armatosur, çdo ditë janë në shërbim të komunitetit, përmes operacioneve në ndihmë të qytetarëve në tokë e në mbrojtje të pasurisë kombëtare në ajër”



i rënë në një parcelë me barë të thatë për pak rrezikoi të shkonte tek disa banesa të fshatit. Ndërhyrja e menjëhershme e forcave emergjente në bashkëpunim me banorët ka bërë të mundur neu-

tralizimin e tij e më pas fikej. Për fat të mirë nuk ka patur të lënduar në njerëz, ndërsa zjarri dyshohet të jetë shkaktuar nga pakujdesia e kalimtarëve që mund të kenë hedhur aty ndonjë cigare të ndezur.


## Zjarri në Mallakastër dhe Roskovec

### Helikopteri “Cougar” angazhohet në shuarjen e zjarrit

**H**elikopteri Cougar i Forcës Ajrore nisi ditën e shtunë, më 29 gusht 2020, operacionin për shuarjen e zjarrit në zonën ndërmjet Patosit, Mallakastrës dhe Roskovecit.

Pylli midis këtyre tre zonave prej disa ditësh ishte nën pushtetin e flakëve.

Pavarësisht ndërhyrjeve nga zjarrfikësit zjarri nuk është shuar për shkak të terrenit tepër të thyer. Forcat zjarrfikëse të Patosit dhe Fierit kanë qenë afër zonës, ku po digjeshin sipërfaqe të mëdha me pyje, në përpjekje për të shuar flakët. Zjarri vijoi të përparojë edhe në drejtim të



zonës së Lofkendit në Mallakastër dhe në pyllin me pisha të Vloshit. Janë djegur disa hektarë me bimë të ndryshme dhe pisha. Helikopteri i Forcës Ajrore i pajisur me botin e ujit, ka arritur të izolojë flakët.



**Shqipëri-Mali i Zi: Komision për shenjat në kufirit shtetëror**

# Helikopteri “Cougar” vendos shënja dalluese në liqenin e Shkodrës

**P**eshkatarët shqiptarë dhe malazezë, por edhe policitë kufitare të të dy vendeve do ta kenë më të lehtë të orientohen dhe të dallojnë vijën kufitare gjatë lundrimit në liqenin e Shkodrës. Sipas njoftimit të Forcave Ajrore shqiptare, përgjatë ditës së enjte, date 20 gusht 2020, në Liqenin e Shkodrës nisi operacioni për vendosjen e bovave përgjatë kufirit ndërshtetëror liqenor me Malin e Zi, ku në ditën e parë, helikopteri “Cougar” i Forcës Ajrore shqiptare realizoi me sukses uljen nga ajri të tre bovave. Komisioni i përbashkët për rindërtimin dhe riparimin e shenjave në vijën e kufirit shtetëror Shqipëri-Mali i Zi, ku bëjnë pjesë Shërbimi Hidrografik i Forcës Detare, Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake dhe Policia Kufitare, vendosën në mirëkuptim të plotë me palën malazeze 6 bova (shenja të reja dalluese në liqen). Vendosja e bovave u krye fizikisht nga një helikopter “Cougar” i Forcës Ajrore. Kufiri mes Shqipërisë dhe

“ Sipas marrëveshjes mes dy qeverive, pala shqiptare është përgjegjëse për instalimin dhe mirëmbajtjen e 11 bovave, ndërsa pala malazeze për 10 të tilla

Malit të zi në liqenin e Shkodrës përcaktohet nga 21 bova, të cilat për shkak të kushteve atmosferike dhe mungesës së mirëmbajtjes ishin dëmtuar dhe nuk ekzistonin prej vitesh.

Pas katër ditësh, pra në datë 24 gusht, Forcat Ajrore kishin vendosur në liqenin e Shkodrës 6 bova, 3 prej të cilave me ndriçues natën për të bërë më të dallueshëm kufirin shqiptaro-malazez. Kjo do u shërbejë peshkatarëve të dyja vendeve dhe policive kufitare. Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka thotë se bovat në liqenin e Shkodrës ishin dëmtuar prej kohësh dhe nuk funksionin, prandaj në mirëkuptim me palën malazeze u vendosën shenjat e reja dalluese. “Peshkatarët shqiptarë dhe

malazezë por edhe policitë kufitare të të dy vendeve do ta kenë më të lehtë të orientohen dhe të dallojnë vijën kufitare gjatë lundrimit në liqenin e Shkodrës. Helikopterët e Forcës Ajrore, në mirëkuptim të plotë me palën malazeze lëshuan 6 bova të reja (shenja dalluese në liqen), ndër të cilat 3 me sinjal ndriçues për natën, të cilat ishin dëmtuar dhe nuk funksiononin prej vitesh”.

Sipas marrëveshjes mes dy qeverive, pala shqiptare është përgjegjëse për instalimin dhe mirëmbajtjen e 11 bovave, ndërsa pala malazeze për 10 të tilla. Dy vitet e fundit pala jonë ka bërë rivendosjen e 8 shenjave të reja ujore në kufirin me Malin e Zi në liqenin e Shkodrës, ndër të cilat 3 me sinjal ndriçues për natën.

**M**e rastin e festimit të Festës Kombëtare të 100-vjetorit të Luftës së Vlorës, në Akademinë e Forcave të Armatosura u zhvillua me 11 gusht 2020 një takim bashkëpunues me akademikët e njohur prof. Shaban Sinani në cilësinë e sekretarit shkencor të Akademisë së Shkencave dhe prof. Pëllumb Xhufi nga Akademia e Studimeve Albanologjike. Perfaqësuesit e AFA të drejtuar nga dekani i Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, kolonel profesor Agim Sula diskutuan me akademikët e njohur mbi programin e aktiviteteve të përbashkëta që do të organizohen me këtë rast. Fokusi kryesor i diskutimeve u përqëndrua në angazhimet e përbashkëta mbi zhvillimin e konferencës shkencore historike “100-vjetori i luftës Kombëtare të Vlorës”, i cili do të mbahet pjesa e parë në teatrin “Petro Marko” në Vlorë, ndërsa pjesa e

## Takim midis akademikëve për 100-Vjetorin e Luftës së Vlorës



dytë në Universitetin e Vlorës “Is-mail Qemali”, si dhe për realizimin e koncertit festiv nga banda frymore e Forcave të Armatosura. AFA në

këtë konferencë do të angazhohet duke trajtuar nga këndvështrimi i historiografisë ushtarake aspekte të luftës së Vlorës.

## Batalioni Xhenier-Kompania EOD

**E**fektivët e Kompanisë EOD të Batalionit Xhenier në Komandën Mbështetëse përfunduan me sukses operacionin për evidentimin e 11 predhave luftarake të kalibrave 100 dhe 55 mm të gjetura në vendbazimin ushtarak në afërsi të portit të qytetit të Sarandës. Predhat të cilat përkisnin Luftës II Botërore janë gjetur në të çarat e disa prej shkëmbinjve të këtij vendbazimi. Nga evidentimi i llojit të municioneve dhe rrezikshmërisë që paraqesnin ato, specialistët EOD dolën në konkluzionin që nga 11 predhat e gjetura, vetëm një predhë e kalibrit 100 mm u konsiderua e pa lëvizshme e cila përbënte rrezik jo vetëm për vendbazimin ushtarak, por dhe për banesat afër tij.

Për këtë arsye kjo predhë u asgjësua në vend duke zbatuar protokollin tepër rigoroz të sigurimit të zonës, rrethimit të saj, vendosja e shiritit dhe largimi i personelit të pacertifikuar në një rreze prej 500 m. Ndërsa 10

## Eleminohen 11 predha luftarake afër portit të Sarandës



predhat e tjera të kalibrave 100 dhe 55 mm u transportuan dhe u magazinuan në depot e Batalionit

Xhenier dhe pas procedurave standarde do të asgjësohen në poligonin e miratuar për këtë qëllim.



## Shpëtohet jahti turistik me 2 persona në Kepin e Gjuhëzës-Vlorë

Koordinimi i veprimeve nga salla e Qendrës Operacionale Ndërinstitucionale Detare (QNOD) me forcat e Kapitenerisë së Vlorës dhe Policisë, bëri të mundur shpëtimin ditën e martë, datë 18 gusht 2020, të një jahti turistik me 2 persona në bord që po lundronte nga porti i Orikumit me destinacion Himarën.

Mjeti turistik i tipit jaht me emrin "AISHA 2479" i cili ishte nisur nga porti i Orikumit me 2 persona në bord në orën 06:00 dt. 18.08.2020 me destinacion Himarën gjatë kthimit për në Vlorë kishte pësuar defekt në afërsi të Kepit të Gjuhëzës dhe kërkonte ndihmë.

"Në orën 19:45 u nis mjeti i policisë BP-05 në drejtim të mjetit në rrezik. Në orën 20:17 u nis dhe anija e RB P-112 nga Sazani, sepse mjeti i policisë nuk po e lokalizonte dot jahtin në rrezik. Në orën 20:55 anija P-112 u takua me jahtin AISHA 2479 në afërsi



të shpellës së Haxhi Alisë në koordinatat 40°26'06 N dhe 19°17'05 E dhe filluan rimorkimin drejt portit të Vlorës. Në orën 22:10 anija e RB P-112 me jahtin AISHA 2479 u akostuan në molin zero në portin e Vlorës", çka bëri që operacioni të përfundojë me sukses si rrjedhojë e një bashkëpunimi dhe koordinimi veprimesh nga salla e Qendrës Operacionale Ndërinstitucionale Detare

(QNOD) dhe mjeteve në terren.

Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) është një institucion ndërdikasterial që ka për detyrë të sigurojë vëzhgimin e hapësirës detare shqiptare, për të realizuar organizimin, planëzimin, bashkërendimin dhe drejtimin e operacioneve në det, në përputhje me legjislacionin detar kombëtar dhe ndërkombëtar.

## Komandës Mbështetëse në zonën Kuz Baba, Vlorë

Në zbatim të urdhërit të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, për dërgimin e një ekipi EOD, për çaktivizimin, heqjen dhe asgjësimin e municioneve të gjetura në zonën Kuz Baba, Vlorë, gjatë punës së ujësjellesit e kanalizimeve të zonës, ekipi EOD i Komandës Mbështetëse mori masat e nevojshme për zbatimin e detyrës.

Pasi mori kontakt me Drejtorinë e Policisë, Vlorë dhe me zbatuesin e projektit në zonën e punimeve për kalimin e tubacionit, vijoi puna për pastrimin e zonës nga municionet e hasura, të cilat i përkisnin Luftës së Dytë Botërore (LIIB).

Pesë predhat e gjetura të kalibrut të madh (100 mm) u transportuan menjëherë në Drejtorinë e Policisë Vlorë, duke kryer edhe

## Ekipi i EOD eleminon pesë predha nga Lufta e Dytë Botërore



krehjen e zonës përreth, për municione të tjera të mundëshme. Për arsye se projekti i ujësjellesit vazhdon, u komunikua me përfaqësuesit e firmës zbatuese që në rast kon-

statimi të prezencës së municioneve të tjera në ditët në vijim, të njoftojnë menjëherë nëpërmjet Drejtorisë së Policisë, Vlorë. Zona ku u krye operacioni ishte me bimësi.

## Zjarret: Roli i prefektit të qarkut dhe kryetarëve të bashkive

*Sigurojnë funksionimin e sistemit të monitorimit, mbajnë në gatishmëri sistemet e mbrojtjes nga zjarri, dhe informojnë në kohë komunitetin dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile*

**P**refekti i qarkut ka rol parësor në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në nivel qarku. Përveç detyrave të përcaktuara në ligjin për prefektin e qarkut, prefekti i qarkut ka dhe këto detyra: të kthejë buxhetin e vitit pasardhës të bashkive brenda territorit administrativ të tij, në rast se nuk janë planifikuar fondet buxhetore për marrjen e masave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, sipas parashikimeve të nenit 65 të këtij ligji; kryen vlerësimin e risqeve në territorin e qarkut përkatës, duke hartuar dhe miratuar dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel qarku, i cili i dërgohet Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për qëllim analizimi dhe planifikimi; koordinon veprimtarinë e organeve, institucioneve dhe strukturave që veprojnë në nivel qarku, me qëllim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile dhe pas ezaurimit të të gjitha kapaciteteve brenda qarkut për përballimin e emergjencës civile ose fatkeqësisë, i kërkon ndihmë për ndërhyrje Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile; bashkëpunon me bashkitë për realizimin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në qark, si dhe për informimin e publikut e të komunitetit të rrezikuar nga fatkeqësitë në lidhje me to; harton, miraton dhe përditëson Planin për Emergjencat Civile në



qark dhe e dërgon në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për qëllim analizimi dhe planifikimi; grumbullon dhe përpunon të dhënat e nevojshme nga bashkitë dhe strukturat e tjera që veprojnë në nivel qarku, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe informon në mënyrë të vazhdueshme Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile; siguron funksionimin e sistemit të monitorimit, paralajmërimit të her-

shëm, njoftimit dhe alarmit në territorin e qarkut dhe informon në kohë komunitetin e rrezikuar, prefektët e qarqeve fqinje, si dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për fatkeqësitë në territorin e qarkut; merr masat e nevojshme për përballimin dhe lehtësimin e pasojave nga fatkeqësitë; koordinon shpërndarjen e asistencës ndërkombëtare në rastet e fatkeqësive në nivel qarku; përcakton prioritetet për nevojat e

Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, investimet emergjente të nevojshme në nivel qarku, me qëllim parandalimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin nga fatkeqësitë; krijon bazën e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë në nivel qarku, të cilën e mirëmban dhe e përditëson, si edhe shkëmben informacione me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe, sipas rastit, me prefektët e qarqeve fqinje; koordinon forcat operacionale në nivel qarku në rastet e fatkeqësive dhe cakton drejtuesin e operacionit në nivel qarku; bashkëpunon me bashkitë e qarkut dhe me prefektët e qarqeve fqinje, në zbatim të detyrave që lidhen me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, me qëllim bashkimin e kapaciteteve të tyre për trajtimin e çështjeve të përbashkëta në këtë fushë; angazhon kapacitetet brenda qarkut për përballimin e situatave të krijuara nga fatkeqësitë, si edhe qytetarët. Në rast emergjence civile apo fatkeqësie, ka për detyrë të realizojë përhapjen dhe shkëmbimin e informacionit me AKMC-në, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe prefektët e qarqeve të tjera të prekura ose të rrezikuara, si dhe të promovojë e të koordinojë marrjen e masave të nevojshme për përballimin e situatës, monitorimin dhe zbatimin e shërbimeve urgjente, aktivizimin e institucioneve dhe administratave për ndërhyrje specifike; kontrollon zbatimin e masave të marra nga bashkitë e qarkut për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile; i drejton kërkesë për mbështetje AKMC-së, sipas kërkesës së bërë nga bashkitë.

Në çdo qark, nën drejtimin e prefektit të qarkut, krijohet dhe funksionon komisioni i mbrojtjes civile. Në çdo bashki, nën drejtimin e kryetarit të bashkisë, krijohet dhe funksionon komisioni i mbrojtjes civile. Përbërja, funksionimi dhe detyrat e komisioneve, miratohen me urdhër të prefektit/kryetarit të bashkisë.

Kurse bashkite kanë këto detyra: kryejnë vlerësimin e risqeve në territorin e tyre, duke hartuar dhe miratuar dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë, të cilin ia dërgojnë prefektit të qarkut dhe

Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, për qëllime analizimi dhe planifikimi; informojnë publikun dhe komunitetin e rrezikuar, bazuar në dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë; hartojnë dhe rishikojnë strategjinë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë; hartojnë, miratojnë dhe përditësojnë planin vendor për emergjencat civile dhe ia dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe prefektit të qarkut, për qëllime analizimi dhe planifikimi. organizojnë veprimtari trajnuese në fushën e mbrojtjes civile për punonjësit dhe banorët në territorin e tyre; sigurojnë funksionimin e sistemit të monitorimit, të paralajmërimit

kryejnë investime parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese nga fatkeqësitë dhe informojnë për këto investime në mënyrë të vazhdueshme prefektin e qarkut, si dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, caktojnë drejtuesin e operacionit në nivel bashkie për përballimin e fatkeqësisë në territorin e saj; kryejnë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë në territorin e tyre, vlerësimin e nevojave për përballimin e tyre, si dhe dëmshpërblejnë shtetasit për fatkeqësitë e ndodhura në territorin e tyre; bashkëpunojnë me bashkitë fqinje në zbatim të detyrave që lidhen me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, me



të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit në territorin e tyre dhe informojnë në kohë komunitetin e rrezikuar, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe prefektin e qarkut për fatkeqësitë në territorin e qarkut; sigurojnë, administrojnë dhe përditësojnë të dhënat e nevojshme për shtetasit dhe për subjektet private, të mundshme për t'u planifikuar dhe angazhuar në parandalimin dhe përballimin e fatkeqësive; krijojnë bazën e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë për territorin e bashkisë, të cilën e mirëmbajnë dhe e përditësojnë, si edhe shkëmbejnë informacione me prefektin e qarkut dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;

qëllim bashkimin e kapaciteteve të tyre për trajtimin e çështjeve të përbashkëta në këtë fushë. mbajnë në gatishmëri sistemet e mbrojtjes nga zjarri, kalueshmërinë e pandërprerë të rrugëve rurale, vendet e strehimit, si dhe mbledhin dhe administrojnë rezervat ushqimore për njerëzit dhe gjënë e gjallë. Aktivizojnë kapacitetet e subjekteve publike e private brenda territorit administrativ të tyre, bashkëpunojnë dhe asistojnë bashkitë fqinje dhe marrin çdo masë tjetër të nevojshme për përballimin dhe lehtësimin e fatkeqësive. Mbajnë në gatishmëri infrastrukturën e ujitjes, të kullimit, të mbrojtjes nga përmbytja dhe digat e rezervuarëve në administrim të tyre.



Drejtuesi model në zemrat dhe mendjet tona

# Ndahet nga jeta komandanti i QBO, kolonel Neshet Shena

**P**as një sëmundje të rëndë, më 13 gusht 2020, është ndarë nga jeta komandanti i Qendrës së Bashkuar Operacionale, kolonel Neshet Shena. Kolonel Shena u lind më 25 maj 1963 në Progonat të Tepelenës në një familje me ndjenja të theksuara patriotike e lirisdashëse. Nesheti pasi kreu shkollën e mesme në vendlindje me rezultate të shkëlqyera, me dëshirën e madhe për të qenë pjesë e Forcave të Armatosura kreu me sukses të gjitha nivelet e arsimit ushtarak, që nga Shkolla e Bashkuar e Oficerëve në specialitetin e Ndërlidhjes, akademinë dyvjeçare të Shtabit të Përgjithshëm, Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes dhe një sërë kursesh e trajnimesh të tjera brenda e jashtë vendit, të cilat e formuan atë me të gjitha karakteristikat më të mira të një kuadroje ushtarak.

Për më shumë se 35 vjet karrierë si ushtarak aktiv, Nesheti kreu me nder një sërë detyrash të rëndësishme duke filluar nga komandant tuge, kompanie, batalioni në Brigadën e Ndërlidhjes në Tiranë, drejtor ndërlidhje në Komandën e Forcës së Bashkuar në Durrës, e deri shef sektori e drejtor i Ndërlidhjes në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, drejtor i Inspektimit në Ministrinë e Mbrojtjes, drejtor i Agjencisë së Informacionit dhe Sigurisë së Mbrojtjes, përfaqësues i lartë i FA shqiptare në Komandën e NATO,

“Do mbetesh ushtaraku i shkëlqyer, njeriu i përsosur fjalëpak e punëshumë, profesionisti korrekt, drejtuesi model në zemrat dhe mendjet tona!



ACT në Norfolk të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe së fundi detyrën e komandantit të Qendrës së Bashkuar Operacionale.

Në kryerjen e të gjitha këtyre detyrave Nesheti u shqua për

përkushtimin dhe devotshmërinë ndaj interesave të larta të atdheut; detyra, nderi, atdheu për të ishin gjithçka. Ai ishte mbi të gjitha një kuadër ushtarak me integritet, i vendosur dhe i pa lëkundër në

kryerjen e detyrave, por ishte edhe një shok dhe mik shumë i mirë me të gjithë komunitetin e ushtarakëve dhe civilëve në Forcat e Armatosura.

Përveçse një ushtarak e profesionistë i zoti, Nesheti ishte edhe një prind shembullor për dy djemtë e tij Kreshnikun e Erindin dhe bashkëshorti i denjë për bashkëshorten e tij Meritën, një mik dhe shok i rrallë për të gjithë ata që punuan dhe e njohën nga afër.

Për punën e tij shëmbullore në Forcat e Armatosura, Nesheti ishte vlerësuar me një sërë medaljesh nga autoritetet më të larta të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave Armatosura.

Kohët e fundit shëndeti i tij u keqësua, ku me gjithë interesimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA, duke e dërguar për kurim edhe jashtë vendit, që e pamundur për ta shpëtuar nga vdekja e parakohshme, shkaktuar nga leucemia akute. Me vdekjen e Neshetit Forcat e Armatosura humbën një kuadër profesionist të shkëlqyer, familja njeriun më të dashur e të pazëvendësueshëm.

Lamtumirë Kolonel Shenaj!

Do mbetesh ushtaraku i shkëlqyer, njeriu i përsosur fjalëpak e punëshumë, profesionisti korrekt, drejtuesi model në zemrat dhe mendjet tona!

U prehsh i qetë!

## Ministrja Olta Xhaçka: Mirënjohje për kontributin njerëzor e profesional të kolonel Neshet Shenës

Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, me anë të një statusi në "Facebook" ka kujtuar Neshet Shenën, kolonelin që u nda nga jeta pas një sëmundje të rëndë. Xhaçka shprehet se Shena do të mbahet mend për faktin se dha kontribut shumë të çmuar për 35 vjet në Forcat e Armatosura, ndërsa shtoi se do të kujtohet kontributi i tij i madh njerëzor e profesional.

"Pas një beteje të vështirë me një sëmundje të rëndë, kolonel Neshet Shena, komandanti i Qendrës së Bashkuar Operacionale, u nda nga jeta duke lënë në hidherim familjen dhe të gjithë ata që e njohën dhe punuan me të, në 35 vite të karrierës në Forcat e Armatosura. Mirënjohje pa kufi për kontributin njerëzor e profesional të një prej oficerëve më të përkushtuar në FA. Ngushëllimet më të ndjera bashkëshortes e dy djemve. U prehsh në paqe, kolonel Shena!" shkruan ministrja Xhaçka.



### Presidenti Ilir Meta:

## Kolonel Neshet Shena do mbetet shembulli frymëzues i ushtarakut

Presidenti i Republikës Ilir Meta ka shprehur trishtim për ndarjen nga jeta parkohe të Komandantit të Qendrës së Bashkuar Operacionale, Kolonel Neshet Shena Metya shkruan se Kolonel Shena do të mbetet shembull frymëzues i ushtarakut profesionist dhe drejtuesit model në radhët e Forcave tona të Armatosura. "I trishtë lajmi për ndarjen e parakohshme nga jeta të Komandantit të Qendrës së Bashkuar Operacionale, Kolonel Neshet Shena. Me një karrierë

të gjatë, të spikatur e të vlerësuar, Kolonel Shena do të mbetet shembull frymëzues i ushtarakut profesionist dhe drejtuesit model në radhët e Forcave tona të Armatosura, njeri me vlera dhe integritet të lartë qytetar. Ngushëllimet më të ndjera bashkëshortes Rita, fëmijëve Kreshnik dhe Nerid, miqve, kolegëve dhe komunitetit të ushtarakëve për këtë humbje të madhe. Lamtumirë Kolone! U prehsh në paqe!", shkruan Presidenti Meta.





## Nekrologji-Portret

# Neshet Shena, pionieri model i një epoke

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

### Figurë e ndritur e oficerit shembullor

Pas një sëmundje të rëndë më 13 gusht 2020 u nda nga gjiri familjes dhe të dashurve të tij, miqve e shokëve të shumtë, kolegëve të karrierës ushtarake komandant i Qendrës së Bashkuar Operacionale të FA, Kolonel Neshet Shena. Ai u bë një figurë e ndritur e oficerit shembullor dhe do mbetet model karakteri, auto-

riteti, serioziteti, përkushtimi ndaj detyrës, model i fjalës së ëmbël dhe dashurisë për vartësit e shokët, model për të gjithë ushtarakët, model i një epoke që përmbushi me nder misionin fisnik të mbrojtjes.

Neshet Shena do të ngelet përherë një emër i dashur, i nderuar e i respektuar për vlerat dhe virtytet, për punën e djersën e derdhur që nga nivelet e ulta të komandimit dhe drejtimit e deri në nivelet më të larta operative e strategjike të mendimit të

gjerë e të thellë në funksion të mbrojtjes. Emri dhe mendimi i tij ka ngelur i spikatur kudo ku punoi e kontribuoi për çështjen e mbrojtjes shqiptare. Ndarja e tij nga jeta është një humbje e thellë për të gjithë. Neshet Shena ju përkushtua karrierës ushtarake, duke filluar që oficer i thjeshtë, kaloi të gjitha gradat ushtarake duke filluar nga kapiten deri në kolonel. Ai spikati që në rininë e tij, në vitet e para si kuadër ushtarak me portretin e një kuadri të devotshëm duke u



kthyer në simbol të ndërlidhësit në ushtrinë shqiptare në rritje e në konsolidim. Më pas arriti në majat më të larta të hierarkisë ushtarake, duke filluar nga shef shtabi batalioni, komandant batalioni, shef operativ, komandant qendre, shef sektori në drejtorinë e Ndërlidhëjs në MM, përgjegjës sektori informacioni në Shtabin e Përgjithshëm, drejtor në MM, drejtor i Përgjithshëm i AISM dhe komandant i Qendrës së Bashkuar Operacionale të FA.

Ka qenë njeri korrekt, model e për t'u marrë shembull në marrëdhëniet me vartësit e kolegët. Komandant Nesheti do të ngelet në kujtesën tonë një ushtarak shembullor dhe njerëzor, një komandant korrekt, njohës teorik e praktik, mjaft i mirë i aparaturave të ndërlidhjes e deri në nivelet më të larta operative-strategjike të mendimit ushtarak. Ai u shua më 13 gusht 2020 për të jetuar gjatë në memorien e Forocve të Armatosura.

### **Mori me vete "dëftesën" e zgjuarsisë natyrale**

Neshet Sali Shena ka lindur më 25 maj 1963 në Progonat të Kurveleshit, ku kreu edhe arsimimin 8-vjeçar. Ai u mëkua,

qysh në fëmijërinë e hereshme me traditat e familjes, të fisit, të fshatit, mori me vete "dëftesën" e zgjuarsisë natyrale, dhuratë e genit dhe e krahinës. Më tej përfundoi shkollën e mesme bujqësore në Tepelenë në vitin 1982. Motivi që shtyu të ndiqte rrugën e karrierës ushtarake ishte tradita familjare dhe jehona që kishin në atë kohë shkollat ushtarake shqiptare, si shkolla elitare të vendit. Ai mësoi me vullnet të hekurt mori kulturë të gjerë, në lëndët egzak të ato shoqërore e sidomos ato ushtarake, duke qenë i shkëlqyer në mësim, i shëndetshëm e i shkathët, i zgjuar nga natyra e me shumë vullnet për të mësuar. Në shkollë ushtarake u rrit dhe fuqizua me frymën e komunitetit, me tiparet të ndershmërisë, drejtësisë, besnikërisë, të jetuarit në komunitet, me rregull e disiplinë të fortë e të ndërgjegjshme ushtarake. Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve e kreu me sukses të plotë në vitin 1985, në specialitetin ndërlidhje me rezultate shumë të mira.

Në fakt origjina e historisë së fshatit të tij është e lashtë, por më shumë ajo njihet nëpërmjet gojëdhënave, sesa përmes librave. Progonati vendlindja e tij, një mirë bëmat e burrave të lashtë,

duke pasur dy armë tradicionale, kërrabën dhe pushkën.

Progonati dhe burrat e tij kanë jetuar e punuar me pulsën e kombit, janë pjesëmarrës në të gjitha luftërat e epopetë e përpjekjeve për liri, përparim e progres, në luftërat e viteve 1912-1914 në çetën e Progonatit, më vonë pjesëmarrës aktiv në Luftën e Vlorës 1920 dhe në vitin 1924 ka qenë Fanolist. Lufta e madhe Antifashiste Nacionalçlirimtare i rreshtoi progonatasit në anën e lëvizjes partizane. Periudha e pasçlirimit ishte e vrullshme në përputhje me reformat në Shqipëri për një jetë më të mirë.

### **Drejt një arsimimi profesional dhe elitar ushtarak**

Pas përfundimit të Shkollës së Bashkuar, për punë dhe rezultate të dukshme në të gjitha drejtimet e natyrës ushtarake ai vijoi në vëzhdimësi dhe përfunduar Kursin e Themelor të Oficerit të Shtabit në vitin 2002, Kursin e Komandantit të Shtabit të Përgjithshëm në vitin 2006, Kursin e Lartë të Oficerit në vitin 2010 dhe Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes në vitin 2015.

Neshet Shena u trajnuar në



mjaft kurse ndërkombëtare të NATO-s, jashtë vendit si në kursin për ndërlidhjen në vitin 1989, në kurs funksional për procedurat e komunikimit në NATO, në programin mbi sigurinë, stabilitetin, tranzicionin dhe rindërtimin në vitin 2008, në kursin funksional për procedurat e komunikimit me NATO në vitin 2010, në kursin ndërkombëtar i menaxhimit të mbrojtjes në vitin 2011 dhe në seminarin e lartë ekzekutiv në vitin 2014.

Neshet Shena ka pasur një karrierë brilante. Jeta nuk e përkëdheli oficerin e ri të por-sadalë nga bankat e shkollës dhe në fakt ai ja krijoi vetes premisat e një karriere të suksesshme. Në shtator 1985, Neshetin e emërojnë komandant të togës të ndërlidhejs dhe shpejt edhe në atë të komandantit të kompanisë. Kuadro bashkëkohës të Neshetit e përshkruanin atë me shprehje se Nesheti nuk mund ta imagjinoje në vend tjetër, veçse gjithmonë në pozicion, në poligon të ndërlidhjes, gjithmonë kërkues dhe eksperimentues. Kabineti dhe poligoni ishin shtëpia e tij. Ishte kjo arsyeja që në vitet 1993 emërohet në detyrën e komandantit të batalionit të ndërlidhjes në brigadën e Ndërlidhejs në Tiranë. Pasta në vite do të kryente detyra si shef operativ, komandant qendre, shef sektori në drejtorinë e Ndërlidhejs në MM, përgjegjës sektori informacioni në Shtabin e Përgjithshëm, drejtor në MM, drejtor i përgjithshëm i AISM dhe komandant i Qendrës së Bashkuar Operacionale të FA.

### **Pedagogu për akademistin Neshet Shena**

Nesheti ishte një njeri me vlera të larta njerëzore, intelektuale, por edhe me humor të veçantë të krahinës nga vinte. Ai ishte një shok e koleg, një njeri i veçantë e zemërgjerë.

Në kujtesën time akademist Nesheti do mbetet ushtarak profesionist, i mençur, i qetë, i prirur për

të bërë vetëm të mira dhe shumë i komunikueshëm. Në KLO në vitin 2010 e patëm përgjegjës të kursit dhe çdo gjë gjatë periudhës një vjeçare ishte në vendin e vet, që nga serioziteti në mësim, përgatitja e grupit, realizimin i detyrave kursore, korrektësia me të cilën ai ja përcillte grupit, por dhe pedagogëve të akademisë.

Ushtrisë shqiptare gjithmonë nuk i kanë munguar ushtarët model, por ushtarakët dhe qytetarë si Nesheti do të jenë gjithmonë e më të rrallë. Unë pedagogu i tij, Neshet Shenën e kam njohur si një ndër ushtarakët më të përgatitur, me një staturë prej njeriu të ndershëm dhe punëtor me një komunikim mjaft qytetar.

Gjatë periudhës së studimeve kam vrejtur se ai ishte një shok i mirë, një koleg korrekt, një ndërlidhës i zoti, një profesionist i talentuar. Ai nga sa kam ndjekur në veprimtarinë e FA ka dhënë një kontribut të veçantë në modernizimin e sistemeve të ndërlidhjes.

Në memorien time në konceptin tim Neshet Shena ishte dhe do të mbetet mik i mirë dhe i vyer, koleg dhe bashkëpunues i shkëlqyer, i kulturuar dhe posedues i virtytit. Mbi të gjitha ishte mirënjohës dhe korrekt, si me kolegun ashtu dhe me vartësin e eprorin. Ishte model i njeriut të qytetar. Ai ishte një kontribues pa diskutim i ndryshimeve madhore të sistemeve të komunikimit në FA. Kolonel Nesheti ishte një nga oficerët pionierë të modernizimit të SNI-ve të FA-se dhe një oficer model për tu ndjekur nga më të rinjtë.

Emëruesi i përbashkët i tij, në çdo pozicion e në detyrë gjatë karrierës së tij ushtarake ishte shoku i mirë bashkëpunues, profesionisti i talentuar, drejtuesi i shkëlqyer dhe mbi të gjitha karakteri i tij i fortë.

### **Vlerësime për kolonelin...**

Presidenti i Republikës dhe

Komandanti i përgjithshëm i FA do të shprehej për Kolonel Shena se kishte një karrierë të gjatë, të spikatur e të vlerësuar, do të mbetet shembull frymëzues i ushtarakut profesionist dhe drejtuesit model në radhët e Forcave tona të Armatosura, njeri me vlera dhe integritet të lartë qytetar. Ngushëllimet më të ndjera bashkëshortes Rita, fëmijëve Kreshnik dhe Nerid, miqve, kolegëve dhe komunitetit të ushtarakëve për këtë humbje të madhe.

Ndërsa ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka ka theksuar se kolonel Neshet Shena, komandanti i Qendrës së Bashkuar Operacionale, në 35 vite të karrierës në Forcat e Armatosura, ka kontribut njerëzor e profesional, si një prej oficerëve më të përkushtuar në FA.

Petro Koçi, zëvendësministri i Mbrojtjes do të jepte këtë vlerësim për kolonel Shenën si ushtaraku i shkëlqyer, njeriu i përsosur fjalëpak e punëshumë, profesionisti korrekt, drejtuesi model në zemrat dhe mendjet tona. Bëmë çdo përpjekje ta shpëtonim nga kthetrat e leucemisë akute por fati nuk na ndihoi, sepse parajsa u takon burrave si Neshet Shenaj.

Mirënjohje dhe respekt të përjetshëm kujtimit të tij, një prej kolonelëve ndërlidhës, një nga kontribuesit kryesorë në modernizimin e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe të Informacionit të Forcave të Armatosura. Në këto momente dhimbjeje për të gjithë ish-ushtarakët dhe ushtarakët, shokët e miqtë e tij, si dhe veçanërisht humbjes së madhe të familjes së tij, ngushëllimet për humbjen e njeriut të mirë, fisnikut Neshet Shena shprehim lamtumirën dhe prehjen në paqe për një legjendë të paepur për të bërë një ushtri të konsoliduar, që bëri emër dhe krijoi traditë duke bërë gjithçka të mirë për të përfaqësuar denjësisht emrin e ushtarakut të FA.

# Urdhër i ministres së Mbrojtjes Olta Xhaçka, Nr.925 datë 3 Gusht 2020 Politikat dhe procedurat e rekrutimit të kandidatëve për oficerë të rinj në FA

QKMBMM të FA bashkëpunon me QPR-në dhe AFA-në për publikimin e njoftimeve në faqen zyrtare të MM, organet e shtypit, rrjetet sociale dhe median audio-vizive, për mundësitë e ofruara për të drejtat e studimit për rekrutimin e kandidatëve për oficerë.

**M**inistrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, mbështetur në pikën 4, të nenit 102 të Kushtetutës, ose Republikës së Shqipërisë, në gërmën "f", të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr.64/2014 "Për pushtetin dhe autoritetin e drejtimit dhe komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe në nenin 113, të ligjit nr.44/2015, datë 30.4.2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", ka firmosur urdhërin me nr.925 datë 3 gusht 2020, për miratimin e dokumentit "Politikat dhe procedurat e rekrutimit të kandidatëve për oficerë të rinj në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë". Urdhëri i ministres së Mbrojtjes nr.1014, datë 22.5.2017 për miratimin e dokumentit "Politikat dhe procedurat e rekrutimit të kandidatëve për oficerë të rinj në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me urdhërin e ministres së Mbrojtjes nr.1014/1, datë 29.12.2017, shfuqizohet. Përgjigjet për zbatimin e këtij urdhëri: komandantët e Forcave, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, komandanti i Komandës Mbeshtetëse, komandantët

e njësjive dhe reparteve të varësisë të drejtpërdrejtë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA, Qendra e Personel Rekrutimit, Shtabi i Përgjithshëm i FA, drejtorja e personelit të SHPFA si dhe Drejtorja e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Sherbimeve. Zbatimi i urdhërit të mësipërm bëhet nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe Sekretari i Ministrisë së Mbrojtjes.

Politikat e rekrutimit të kandidatëve për oficerë në Forcat e Armatosura përmban parimet, kërkesat dhe standardet për rekrutimin dhe plotësimin e strukturave të FA me oficerë të rinj, në funksion të misionit të mbrojtjes së vendit dhe të përbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni kombëtar dhe angazhimet në kuadrin e NATO-s, BE-se dhe OKB-së.

Qëllimi i këtij dokumenti është përcaktimi i drejtiveve kryesore, i vizionit dhe parimeve për rekrutimin e kandidatëve për oficerë, përcaktimi i metodologjisë së kërkimit dhe kriterëve të përzgjedhjes së tyre, si dhe i detyrave dhe përgjegjësisë të strukturave për drejtimin dhe menaxhimin e procesit.

Strukturat që përfshihen në procesin e rekrutimit të kandidatëve për oficerë në FA janë: Drejtorja e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Sherbimeve (DMBNJSH), Drejtorja e Personelit në SHP (J-1), Qendra e Personel Rekrutimit (QPR), drejtorja e Logjistikes në Shtabin të Përgjithshëm (J-4), Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS)/Akademia e Forcave të Armatosura (AFA), Agjensia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM), Policia Ushtarake (PU), Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut të FA, Njësia Mjekësore Ushtarake e Forcave të Armatosura (NJMU), Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të FA (BMSHP), Inspektori i Shendetësisë në SHPFA dhe Qendra e Automatizimit dhe e Mbrojtjes Kiberne-





tike/Kriptografike ne ASNI.

Secila nga strukturat e mësipërme ka specifikisht detyrat e veta. Keshtu p.sh. Qendra e Kultures, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut te FA bashkëpunon me QPR-në dhe AFA-në për publikimin e njoftimeve në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, në organet e shtypit, në rrjetet sociale dhe në median audio-vizive, për mundësitë e ofruara për të drejtat e studimit për rekrutimin e kandidatëve për oficerë.

Kurse Agjensia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM) dhe Policia Ushtarake (PU) sipas listës së kandidatëve të dërguar nga QPR-ja/AFA-ja, në bashkëpunim me njëra -tjetrën dhe me struktura të tjera bëjnë kontrollin e plotësimin të kushtit të sigurisë të kandidatëve për oficerë. Policia ushtarake, gjithashtu, përgjigjet edhe për mbajtjen e rregullit, disiplinës dhe sigurimin e procesit të konkurimit. Agjensia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM) dhe Policia Ushtarake (PU) të paktën 60 ditë para fillimi të studimeve, l dërgojnë QPR-së/AFA-së, një përgjigje për plotësimin e kushtit të sigurisë të kandidatëve të përgjedhur për oficerë. Përgjigjia për plotësimin e kushtit të sigurisë duhet të jetë në termat plotëson kushtin e sigurisë, ose nuk plotëson kushtin e sigurisë.

Detyrë të rëndësishme në procesin e rekrutimit të kandidatëve për oficerë te rinj ka edhe Inspektori i Shëndetësisë në SHPPA i cili përpara fillimit të procesit të përzgjedhjes (testimit), nëpërmjet një përfaqesuesi, vlerëson raportet mjekësore për aftësi për studime të lëshuara nga mjeku i familjes dhe ekzaminimet biokimike dhe radiologjike te kryera në Qendrat Shëndetësore të Banimit.

Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve (DMBNJSH) përgjigjet për hartimin e politikave, procedurës dhe kritereve të rekrutimit të kandidatëve për oficerë duke bashkëpunuar me J-1, monitorimin e zbatimit të politikës, procedurës dhe kritereve për përzgjedhjen e kandidatëve për oficerë të rinj, bashkëpunim me Drejtorinë e Personelit ne SHP te FA per percaktimin e nevojve, paraqitjen e nevojave dhe kërkesave për mundësitë e arsimimit të personelit tonë në institucionet arsimore ushtarake të vendeve të tjera, nëpërmjet Drejtorisë së Politikave të NATO-s dhe BE-së, njoftimin e Shtabit të Përgjithshëm te FA për të drejtat e studimit që ofrojnë vendet e tjera për arsimin e personelit tonë në institucionet arsimore ushtarake, fillimin e procedurave për

rekrutimin e kandidatëve për oficerë te rinj, monitorimin e procesit, zhvillimin dhe ndjekjen e procedurave te miratimit të kandidateve nga ministri, konfirmimin e kandidateve te miratuar vendeve partnere që kanë ofruar të drejtat e studimit, përgatitjen e projekt-urdhërit për dërgimin me studime jashtë ose fillimin e Kursit të Përgatitjes së Oficerëve në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë në AFA.

Politika e rekrutimit dhe procedurat mbështesin realizimin e objektivave të përcaktuara nga Strategjia e Menaxhimit te Burimeve Njerëzore (SMBNJ) 2020-2024 në fushën e rekrutimit te oficerëve, për një periudhë afatmesme. Zbatimi i saj është një proces kompleks dhe mund të kërkojë rishikimin e saj ne varësi nga rrethanat dhe objektivat e përcaktuara. Ajo mban parasysht modelin e oficerit te ardhshëm të Forcave të Armatosura Shqiptare, nevojat dhe burimet njerezore, materiale dhe financiare të mundshme.

Për zbatimin e kësaj politike është i nevojshëm planifikimi i nevojave të rekrutimit të kandidateve për oficerë, të paktën për një periudhë 2 vjecare, duke specifikuar burimet e rekrutimit dhe mundësitë e arsimimit, zhvillimin e marketingut me qëllim sigurimin e burimeve dhe cilësinë e nevojshme, komunikimi i brendshëm me synim nxitjen e ushtareve/detareve dhe nënoficereve aktive për të vazhduar karrierën ne FA, vendosja e kontaktit me institucionet arsimore te arsimit të mesëm e të lartë për promovimin e vlerave te FA-së dhe për të inkurajuar të rinjtë për tu bërë pjesë e Forcave të Armatosura.

Rekrutimi i kandidateve për oficerë në FA do të jetë i larmishëm. Në raport me legjislacionin në fuqi burimet e rekrutimit do të jenë: shtetasit shqiptarë që kanë kryer arsimin e mesëm dhe te lartë brenda, ose jashtë shtetit, si dhe shtetasit shqiptarë që janë në vitin e fundit të arsimit të mesëm të lartë. Kjo kategori do të rekrutohet për nevojat e studimeve në Akademitë Ushtarake të vendeve të NATO-s dhe ato partnere, duke u bazuar ne marrëveshjet e bashkëpunimit dypalëshe ne fushën e arsimit ushtarak. Shtetasit shqiptarë që kanë kryer arsimin e lartë (minimum bachelor) brenda, ose jashtë vendit, të njohur dhe të ekuivaluar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë. Kjo kategori do të rekrutohet për plotësimin e nevojave të FA-se me specialiste të kategorieve të veçanta si: jurist, ekonomist, financier, informatikë, topografi,

etj. Ky burim është i hapur edhe për ushtare/detare dhe nënoficeret aktive të Forcave te Armatosura, të cilët kanë kryer arsimin e lartë dhe kanë demonstruar ndershmëri, kurajo, përkushtim dhe aftësi të lartë profesionale në shërbimin aktiv. Shtetasit shqiptarë që kanë kryer arsimin e mesëm të lartë brenda dhe jashtë vendit. Kjo kategori do të rekrutohet për ndjekjen e studimeve Bachelor në Akademin e Forcave të Armatosura.

Pranimi për ndjekjen e studimeve në institucionet e larta arsimore, brenda dhe jashtë vendit, do të bëhet me konkurim dhe sipas nevojave të FA, ku kandidatet do të nënshtrohen testeve në disiplina të ndryshme. Nevojat e rekrutimit nga J-1 në muajin shtator të çdo viti, në bashkëpunim me forcat dhe strukturat e varësisë, për një periudhë 2 vjecare. Në përcaktimin e nevojave për rekrutim mbahen në konsideratë mundësitë e arsimimit brenda dhe jashtë vendit. Nevojat e rekrutimit pas miratimit nga SHSHP-ja, i dergohen DMBNJSH-se ne Ministrine e Mbrojtjes, J1 ne SHP, QPR-se dhe KDS-se/AFA-se. QPR-ja dhe KDS-ja/AFA-ja mbi bazën e planit te miratuar nga SHSHP-ja programojnë punën për rekrutimin e kandidateve për oficerë, në bashkëpunim dhe koordinim me institucionet dhe strukturat e tjera. Publikimi i njoftimit do të bëhet nga Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Ministrisë së Mbrojtjes në bashkëpunim me DMBNJSH-në, AFA-në dhe QPR-në, në faqen e internetit te MM-se, në organet e shtypit, në median auto-vizive ,ose rrjetet sociale.

Njoftimi përmban mënyrën e aplikimit dhe afatet, dokumentet që duhet të paraqesin aplikantet ne fazën e parë të procesit dhe në fazën finale, kriteret për aplikimin në formatin pdf, formatin e aplikimit në word, testimet që do të zhvillohen, informacione të tjera të dobishme për kandidatet, etj.

Kurse kriteret e përgjithshme të rekrutimit për studime ushtarake brenda dhe jashtë vendit janë: të jetë shtetas shqiptar, të mos jetë dënues nga gjykata për vepra penale, te mos jetë në ndjekje penale, te mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata, të mos ketë problem me deportimin, të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe alkoolit për të cilat duhet të paraqesin testet e kryera, të ketë kryer arsimin përkatës, të plotësojë kriteret e moshës, të ketë gjatësi trupore 165 cm për meshkujt dhe 160 cm për femrat, etj.

## Politikat e privatësisë dhe mbrojtja e të dhënave personale

**K**y dokument ka për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale mbi mënyrën e grumbullimit, përpunimit, përhapjes, ruajtjes së privatësisë dhe masave të sigurisë, për të dhënat e përpunuara nga faqja jonë "web", procese të cilat realizohen në përputhje të plotë me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe nënligjor, për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky dokument ka për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale mbi mënyrën e grumbullimit, përpunimit, përhapjes, ruajtjes së privatësisë dhe masave të sigurisë, për të dhënat e përpunuara nga faqja jonë "web", procese të cilat realizohen në përputhje të plotë me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe nënligjor, për mbrojtjen e të dhënave personale.

Baza ligjore: Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Rekomandimi i komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, nr. 2, datë 11.05.2020 "Për publikimin e 'politikave të privatësisë' në faqet zyrtare të internetit nga institucionet e administratës shtetërore". Ligjin Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Ligjin Nr. 9918 datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike dhe postare" si dhe aktet e tjera nënligjore në plotësim. Udhëzimin nr. 47 datë 14.09.2018 të komisionerit "Për përcaktimin e



Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura, si pjesë e administratës shtetërore janë subjekt përpunues i të dhënave personale, konform legjislacionit në fuqi

rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjekte përpunuese të mëdha. Rregullorja "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, miratuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, nr. 1369, datë 25.08.2015. Udhëzimin të ndërlydhjes dhe teknologjisë së informacionit", të miratuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, nr. 770, datë 12.05.2015.

Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura, si pjesë e administratës shtetërore janë subjekt përpunues i madh i të dhënave personale, në kuptim të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Ato kanë si detyrim plotësimin e të gjitha parashikimeve të mësipërme ligjore në kryerjen e grumbullimit, përpunimit të të dhënave personale duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti, të drejtën e ruajtjes së privatësisë.

Kontrolluesi Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura grumbullojnë dhe përpunojnë të dhënave personale, në mënyrë të drejtë, sipas kërkesave të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008, "Për

mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, duke u fokusuar në:

Grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave personale, për qëllime specifike, të përcaktuara qartë sipas ligjit. Mbrojtjen e interesit jetik të subjektit të të dhënave gjatë grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave, duke mos tejkualar qëllimin e përpunimit. Përmbyshjen e detyrimit ligjor të kontrolluesit në saktësinë e të dhënave, përditësimin, fshirjen dhe korrigjimin e të dhënave të pasakta, në lidhje me qëllimin e grumbullimit apo përpunimit të tyre. Ndjekjen e interesave legjitime të kontrolluesit ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat, përveç kur këto interesa cenojnë privatësinë e subjektit të të dhënave personale. Mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave të subjekteve për aq kohë sa i vlejnë qëllimit për të cilin ato janë grumbulluar apo përpunuar më tej.

Përpunimi i të dhënave personale bëhet: për të mbrojtur interesat jetike të subjektit të të dhënave; për përmbyshjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit; për mbrojtjen e interesave jetësore të subjektit të të dhënave; për kryerjen e një detyre ligjore me interes



dhënat personale të subjekteve përpunohen në mënyrë manuale dhe elektronike, në zbatueshmëri të plotë me masat e sigurisë fizike të informacionit dhe sigurisë elektronike nga skedarët spiun, të përcaktuara në rregullore dhe udhëzime të veçanta. Kontrolluesit, përpunuesit e tjerë të të dhënave personale, janë të kufizuar dhe kontro-lluar nga kontrolluesi kryesor i përpunimit të të dhënave personale.

publik ose ushtrimin e një kompetence të kontrolluesit ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat; për përmbushjen e një kontrate, për të cilën subjekti i të dhënave personale është palë kontraktuese, apo për ndryshime të një kontrate me propozimin e subjektit të të dhënave. Të dhënat personale që grumbullohen dhe përpunohen nga kontrolluesit, janë të dhëna sensitive dhe të dhëna të përbashkëta. Për të dhëna sensitive ekziston detyrimi i veçantë për kontrolluesin (përpunuesin) që të marrë pëlqimin me shkrim të subjektit të të dhënave personale.

Subjekti kontrollues kryen transferim ndërkombëtar të të dhënave personale, me pëlqim të subjekteve të të dhënave personale në vende me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes të të dhënave personale, bazuar në parashikimet e nenit 8 dhe 9 të Ligjit nr. 9887/2008 dhe aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij. Me pëlqim të subjekteve të të dhënave personale, transferohen të dhëna në shtete që nuk sigurojnë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, por që autorizohet nga akte ndërkombëtare, të ratifikuara nga RSH dhe që janë të zbatueshme në mënyrë të drejt-përdrejtë si dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit, të lidhura nga Ministria e Mbrojtjes, me kusht që këto të dhëna të trajtohen dhe të ruhen, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Subjekti i të dhënave personale ka të drejtë që të njihet në çdo

kohë me të dhënat e tij personale të grumbulluara dhe të përpunuara, nga kontrolluesi. Subjekti i të dhënave personale informohet nga kontrolluesi për kategoritë e të dhënave personale që përpunohen, qëllimin, mënyrën si dhe çdo informacion tjetër për të siguruar një përpunim të drejtë.

Subjekti i të dhënave personale ka të drejtë të kërkojë akses mbi të dhënat e tij, kur informohet se të dhënat e tij po përpunohen; të kërkojë bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, me kërkesë, pa pagesë, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë grumbulluar dhe përpunuar në kundërshtim me dispozitat e ligjit; të informohet nga kontrolluesi brenda 30 ditëve, për kryerjen ose jo të të bllokimit, korrigjimit ose fshirjes, duke u dhënë shpjegimet përkatëse, të kundërshtojë, në çdo kohë, mbështetur në ligj, përpunimin e të dhënave rreth tij, sipas shkronjave "d" dhe "dh" të nenit 6, të ligjit nr. 9887/2008, përveç kur parashikohen ndryshime me ligj; të ankohet në rast se pretendon që i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale, ose të njoftojë komisionerin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij. Subjekti kontrollues është i ndërgjegjshëm për rëndësinë dhe sensitivitetin e të dhënave personale, me staf të përkushtuar, të trajnuar në njohjen e kuadrit ligjor dhe i certifikuar për këtë qëllim. Të

Në momentin e aplikimit, aplikantëve ju bëhet e ditur, afati i ruajtjes së të dhënave personale.

Të dhënat personale të aplikantëve që nuk shpallen fitues, ruhen deri në përfundimin e afatit të përcaktuar, më pas shkatërrohen (asgjësohen) dhe fshihen nga sistemi.

Çdo person që vepron nën autoritetin e kontrolluesit, përpunon të dhëna personale, nënshkruan një deklaratë kofidencialiteti, me anë të së cilës angazhohet se do të zbatojë kërkesat e ligjit dhe të kësaj politike për ruajtjen e privatësisë, dhe sigurinë e të dhënave personale gjatë ushtrimit të detyrës dhe pas mbarimit të saj. Subjekti kontrollues identifikon adresat dhe numrat e kontakti të subjekteve të të dhënave, për qëllime të caktuara apo të ndonjë ankese nga ana e tyre. Subjekti kontrollues i mundëson subjektin të të dhënave personale të drejtën e refuzimit me shkrim të pëlqimit të dhënë, në çdo kohë.

Subjekti kontrollues kërkon miratimin (pëlqimin) nga subjekti i të dhënave personale që ky i fundit ka marrë dijeni dhe jep pëlqimin për përpunimin e të dhënave sipas përcaktimeve në politikën e privatësisë. Subjekti kontrollues ruajnë privatësinë e të dhënave personale, përditësimin e politikës së privatësisë herë pas herë, duke njoftuar edhe subjektet e të dhënave për ndryshimet e realizuara.





**N**ë Aeroportin e Gjakovës Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) mbajti më 14 gusht 2020 ceremonia e përfundimit të trajnimit tre mujor „Komando – Bereta”. Në ceremoni morën pjesë, Ministri i Mbrojtjes Anton Quni, zv. ministria Sadika Kofrc, komandanti i FSK-së, gjeneralletjenant Rrahman Rama, drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në MM, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, komandanti i Forcave Tokësore gjeneral brigade Fadil Hadergjonaj, si dhe oficerë dhe nënoficerë të FSK-së.

Fillimisht, pjesëtarët që përfunduan trajnimin Komando-Bereta, demonstruan shkathtësitë e tyre, në tri disiplina si: Artet Marciale, Qitje me tranzicion dhe Neutralizim të objektivit me rëndësi të lartë, të cilat u përcollën me vëmendje nga të gjithë mysafirët.

Me këtë rast, ministri Quni, përgëzoi stafin dhe të gjithë pjesëtarët e trajnimit, duke u shprehur se: “Ju kemi përcjellë gjatë tërë kohës dhe jemi të njoftuar se jeni përballur me kushte të rënda atmosferike, me marshime të gjata, ky është programi i trajnimit nëpër të cilat duhet të kalojnë njësitë elite. Ju nesër do të merrni detyra, FSK-ja në përgjithësi do të ketë detyra të reja si brenda ashtu edhe jashtë vendit, gjithnjë në shërbim të stabilitetit dhe paqes. Ju do të jeni të parët që do të përballemi me rrezikun dhe ju do të jeni të fundit që do të tërhiqeni. Ju jeni forca elite



PËRFUNDON TRAJNIMI TRE MUJOR “KOMANDO-BERETA”

## Ju jeni forca goditëse dhe forca mbrojtëse e FSK-së

FSK-ja do të ketë detyra të reja si brenda ashtu edhe jashtë vendit, gjithnjë në shërbim të stabilitetit dhe paqes

goditëse e FSK-së dhe ju jeni po ashtu edhe forca mbrojtëse e FSK-së. Kjo nuk mbaron me kaq ne dëshirojmë të ju shohim në misione paqeruajtëse krahas për krahas me ushtarë të miqve tanë ndërkombëtarë, të cilët po na përkrahin me programe dhe projekte të ndryshme, që ne të bindim komunitetin ndërkombëtar se nuk jemi rrezik për rajonin, por përkundrazi jemi faktor i paqes dhe sigurisë”. Ministri Quni përmbylli fjalën e tij duke ju uruar sukses të reja të gjithë ushtarëve si njësi dhe secilit personalisht në realizimin e detyrave.

Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjeneral Rrahman Rama, në fjalën e tij u shpreh i kënaqur me realizimin e këtij trajnimi dhe me rezultatet e treguara të pjesëtarëve të FSK-së. Ai, pos tjerash tha: „Ne jemi ata që përcaktojmë se si do të duket ushtria e jonë. Ne jemi ata që duke vendosur standarde të

larta në të gjitha fushat, shtojmë rrugën për gjeneratat e reja, dhe bëhemi shembull se si duhet të ecim përpara. Me këtë trajnim, Ju jeni bërë shembull shumë i mirë i kësaj. Gjatë këtij trajnimi, ju treguat performancë, angazhim dhe përkushtim të lartë. Dhe kështu keni vendosur standard jashtëzakonisht të lartë për gjeneratat e ardhshme.

Unë ju përgëzoj për këtë. Me lejoni që të falënderoj dhe përgëzoj edhe oficerët dhe nënoficerët që e mundësuan këtë trajnim. Profesionalizmi që treguar gjatë këtij trajnimi mjaft të vështirë dhe kompleks, tregon që FSK ka avancuar shumë, dhe është e aftë të koncepton, dizajnon dhe kryen trajnime edhe më komplekse”. Në fund të ceremonisë, për kursantët të cilët përfunduan me sukses trajnimin dhe instruktorët të cilët mundësuan realizimin, u ndanë certifikatat dhe “Beretat e Gjelbërta”.

# MM dhe FSK: Bashkëpunim me partnerin strategjik SHBA-në

**M**inistri i Mbrojtjes Anton Quni i shoqëruar nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i Përgjithshëm i MM-së, Faruk Geci, pritën në një vizitë pune, kryetaren e Kuvendit të Kosovës, znj. Vjosa Osmani të shoqëruar nga stafi i saj. Ministri Quni pasi i uroi mirëseardhje kryeparlamentares Osmani, e njoftoi atë me aktivitetet që po zhvillohen në Ministri të Mbrojtjes, me procesin e transformimit të FSK-së, arritjet e deritashme si dhe me sfidat.

Ministri Quni, me këtë rast, foli për punën që është bërë, deri më tash, në hartimin e dokumenteve nënligjore, pas aprovimit të ligjeve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, me mision të ri, për të gjitha fushat dhe nivelet që garantojnë funksionalizim institucional dhe ligjor të FSK-së. Ministri Quni, gjithashtu e njoftoi kryeparlamentaren Osmani edhe me bashkëpunimin e mirë që ka Ministria dhe FSK-ja me partnerin strategjik SHBA-të, bashkëpunimet bilateral, bashkëpunimin me KFOR-in, bashkëpunimin e mirë me ekipin e NALT-it, që është prezentë në Ministri dhe Forcë, duke vlerësuar se është rritur besueshmëria me partnerët ndërkombëtar.

Ministri Quni, gjithashtu theksoi se në kuadër plotësimi të infrastrukturës ligjore dhe të dokumenteve të rëndësishme të fushës së sigurisë, është prioritet procedimi i Strategjisë së Sigurisë së Kosovës e cila i hap rrugë procedimit të Strategjisë së Mbrojtjes.

Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, në fjalën e tij, foli për planin e transformimit të FSK-së, duke theksuar rezultatet e arritura deri më tash përballë gjendjes së rënduar nga

Një oficer ndërlidhës do jetë në Kuvendin e Kosovës, me qëllim lehtësimin e komunikimit në mes Ministrisë dhe FSK-së, me Parlamentin



pandemia, se ju kemi përshtatur kësaj gjendje, dhe nuk kemi ngecje në realizimin e detyrave të planifikuara. Ai, po ashtu, foli edhe për rezultatet e mira që kanë arritur kadetët tanë, në Akademitë më të njohura në botë, si: në West Point-SHBA, Mbretëri të Bashkuar, Gjermani, Kroaci, Turqi, Maqedoni, etj.

Gjeneral Rama, e njoftoi znj. Osmani, dhe për angazhimet dhe kontributin e FSK-së, në menaxhimin e situatës me pandeminë COVID 19, brenda për brenda FSK-së, duke mos dëmtuar operacionalitetin e saj, si dhe angazhimet për të mbështetur institucionet mjekësore në logjistikë, transport edhe me kapacitete tjera shtesë.

Nga ana e saj, kryeparlamentarja Osmani, duke e falënderuar për pritjen e ngrohtë, vlerësoi lartë arritjet e FSK-së, duke shtuar se Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja janë dy institucionet që vlerësohen lartë në Parlamentin e Kosovës, për shkak të punës dhe së mirë dhe vlerësimit të lartë që kanë për Juve. Ajo vlerësoi lartë angazhimin dhe kontributin e FSK-së, në menaxhimin e situatës së pandemisë në ndihmë të qytetarëve dhe institucioneve të

Kosovës. Zonja Osmani premtoi se aty ku ka nevojë FSK-ja, do ta ketë mbështetjen e përhershme dhe pa rezervë të Kuvendit të Kosovës.

Gjatë takimit u bisedua edhe për incidentin e Karaqevës së Kamenicës, për veprimtarinë e xhandarmerisë serbe e cila i ka revoltuar banorët lokal, ku u vlerësua se në raste të tilla duhet të ketë informim më të shpejtë, transparencë dhe koordinim me të mirë në mes të institucioneve shtetërore dhe atyre të pranisë ndërkombëtare dhe detyrimet të institucioneve në situata të tilla. Me vlerësimin e dyanshëm në takim u vendos për dërgimin e një oficeri ndërlidhës në Kuvendin e Kosovës, me qëllim të lehtësimit të komunikimit në mes Ministrisë dhe FSK-së, me Parlamentin. Në kuadër të vizitës, kryeparlamentarja Osmani, qëndroi edhe në Qendrën Operative të Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së, ku nga Shefi i Stafit të Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Jeton Dreshaj, u njoftua me angazhimet operacionale të FSK-së.



RREGULLORE

## “Organizimi dhe shërbimi mjekësor në FSK”

Rregullorja “Per Organizimin dhe shërbimi mjekësor në Forcën e Sigurisë së Kosovës” është firmosur nga ministri i Mbrojtjes, z.Anton Quni, më 10 korrik 2020

**M**inistri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës, z.Anton Quni ka firmosur me 10 korrik 2020, rregullohen “Per Organizimin dhe shërbimi mjekësor në FSK” e cila për qëllim organizimin e shërbimeve mjekësore në FSK, përcaktimin e rregullave dhe procedurave për ofrimin e shërbimeve mjekësore dhe për kujdesjen shëndetësore për personelin e Ministrisë së Mbrojtjes, pjesëtarët e FSK-së, si dhe për anëtarët e ngushtë të familjes së pjesëtarit, përderisa ai/ajo gjendet në mision jashtë vendit. Kjo rregullore zbatohet ndaj të gjithë personelit të MM-së, personelit të FSK-së, si dhe ndaj anëtarëve të ngushtë të familjes së pjesëtarit, përderisa ai/ajo gjendet në mision jashtë vendit.

### Struktura organizative mjekësore

Ja struktura organizative mjekësore në MM dhe FSK: Departamenti Mjekësor në MM; Zyra për Çështje Mjekësore në SHPFK; Regjimenti i Mjekësisë; dhe Qendra Mjekësore e FSK-së. Departamenti Mjekësor ka për detyrë që të hartojë dhe të monitorojë politikën dhe planet për kujdesin shëndetësor, të marrë pjesë në negociimin e memorandumëve/marrëveshjeve me institucionet mjekësore brenda dhe jashtë vendit, si dhe detyra të tjera të përcaktuara me rregulloren (QRK) përkatëse për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të punës në Ministrinë e Mbrojtjes, si dhe detyra të tjera bazuar në ligjet përkatëse në fuqi. Zyra për Çështje Mjekësore zbërthen politikën mjekësore në

plane, përgatitë udhëzimet për realizimin e shërbimit mjekësor në FSK dhe planifikon zhvillimin dhe modernizimin e sistemit mjekësor në FSK. Regjimenti i Mjekësisë është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve mjekësore për të gjithë pjesëtarët e FSK-së, mjekësi parandaluese, dhe të mbështesë forcën në operacione si brenda dhe jashtë vendit. Qendra Mjekësore e Forcës ka për detyrë të ofrojë shërbime mjekësore specialistike, diagnostike, si dhe ekzaminimin sistematik mjekësor.

### Shërbimet mjekësore

Shërbimet mjekësore konsistojnë në: ruajtjen e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve; tra-

jitimin e të sëmurëve dhe të lënduarve; evakuimin e të sëmurëve dhe të lënduarve; regjistrimin dhe raportimin mjekësor; furnizimin me material mjekësor; bashkërendimin e resurseve njerëzore dhe rajnimit e personelit mjekësor dhe jomjekësor.

### Ofrimi i shërbimeve mjekësore

Forca e Sigurisë e Kosovës, aty ku është e mundur, brenda burimeve të veta, ofron shërbime dhe kujdes shëndetësor për të gjithë personelin e saj dhe personelin e MM-së. FSK-ja ofron shërbime dhe kujdes shëndetësor për anëtarët e ngushtë të familjes së pjesëtarit, përderisa ai/ajo gjendet në mision jashtë vendit. Në rastet kur shërbimet nuk janë



# FSK: Zhvillohet stërvitja fushore "Kompania në mbrojtje"

**M**inistri i Mbrojtjes Anton Quni së bashku me gjeneralmajor Enver Cikaqin dhe stafin e tij, ka ndjekur nga afër zhvillimin e stërvitjes fushore "Kompania në mbrojtje" të realizuar nga kompania A3 e regjimentit të tretë të forcave tokësore të FSK-së që u realizua në zonën e Qiqavicës. Në vazhdim ministri Quni vizitoi edhe pjesëtarët gjatë demonstrimit praktik të trajnimit "Komando-Bereta", që është duke u realizuar në zonën e fshatit Ceceli të komunës së Vushtrrisë. Për zhvillimin, objektivat e synuar të stërvitjes dhe trajnimit përkatës si dhe kapacitetet njerëzore e teknike të angazhuara, ministrin Quni e njoftoi komandanti i komandës së Forcave Tokësore (KFT) gjeneral Fadil

Hadërgjonaj. Nga ana e tij, ministri Quni, përgëzoi KFT-në duke vlerësuar lart angazhimin edhe në këtë kohë të përballjes me krizën pandemike, në trajnime e stërvitje të niveleve e formateve të tilla, duke treguar nivel të lartë, disiplinë e profesionalizmi për arritjen e aftësive taktike operuese për



realizimin e misionit dhe detyrave specifike të komandës së forcave tokësore dhe FSK-së në përgjithësi. "Unë kam marrë raportet e përditshme të punës dhe angazhimit tuaj dhe jam i vetëdijshëm për sfidat dhe vështirësitë nëpër të cilat keni kaluar gjatë kësaj periudhe, por me moral të lartë, kalitje fizike dhe shkathtësitë e duhura profesionale keni arritur t'i përballoni me sukses",- tha ndër të tjera ministri Quni.

Trajnimi "Komando-Bereta" është duke vijuar dhe është trajnim në kuadër të planit vjetor të trajnimeve, sipas planit të tranzicionit për ngritjen e aftësive dhe kapaciteteve operacionale për mbrojtjen territoriale të vendit.

të mundshme, ose kur kërkesa është jashtë fushës të cilën e mbulon shërbimi mjekësor i FSK-së, pjesëtarët duhet të dërgohen në sistemin e kujdesit shëndetësor kombëtar. Kur kujdesi shëndetësor kombëtar nuk ofron shërbimin përkatës mjekësor, trajtimi mjekësor i pjesëtarit të FSK-së dhe personelit të MM-së bëhet jashtë vendit, mbi bazën e marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka MM. Në rastet kur shërbimet përkatëse shëndetësore nuk mbulohen as me marrëveshje bashkëpunimi, pjesëtarët e FSK-së dërgohen për shërim në institucionet e specializuara brenda dhe jashtë vendit, përmes programeve të Ministrisë së Shëndetësisë. Për zbatim të paragrafëve e këtij neni, është përgjegjës Bordi i veçantë Mjekësor, i caktuar nga ministri i Mbrojtjes, përbërë nga 3 anëtarë dhe kryesohet nga Drejtori i Departamentit të Mjekësisë në MM. Dy anëtarë të tjerë janë nga fusha e mjekësisë së FSK-së që rekomandohen nga KOMFSK. Për ekzekutimin e vendimeve të Bordit zbatohen procedurat administrative sipas rregullave në fuqi.

## Kontrolli i obliguar mjekësor

Ekzaminimet e detyrueshme mjekësore për pjesëtarët e FSK-së bazuar në kriterin e moshës janë: Nga moshë 18 deri 30 vjeçare çdo 3 vite; Nga moshë 31 deri 40 vjeçare çdo 2 vite; Nga moshë 41 e lart çdo 1 vit. Pjesëtarët e FSK-së janë të obliguar t'i nënshtrohen kontrollit të rregullt dhe të planifikuar mjekësor, në përmbushje të standardeve për mbajtjen e gjendjes së kërkuar mjekësore për shërbim në FSK. Kontrollat e obligueshme mjekësore për pjesëtarët e FSK-së bëhen edhe në rastet si: Para dërgimit në arsimim/shkollim në rast se kërkohet nga shteti ofrues; Para dërgimit dhe pas kthimit nga misioni jashtë vendit. Kontrolli i detyrueshëm mjekësor bëhet menjëherë pas kthimit nga misioni jashtë vendit. Në raste specifike, në çdo kohë, sipas urdhrat të KOMFSK-së bëhet ekzaminimi i përgjithshëm mjekësor për pjesëtarët e FSK-së. Raportet e kontrolleve mjekësore sipas këtij neni, i dërgohen Bordit Mjekësor të FSK-së.

## Librezat dhe dosjet mjekësore

Pjesëtari i FSK-së duhet të pajiset me librezë shëndetësore dhe me librezë të vaksinimit. Dosja mjekësore e pjesëtarit të FSK-së ruhet një kopje në njësi dhe një kopje në Regjimentin Mjekësor. Raporti përfundimtar i pjesëtarit i lëshuar nga Bordi Mjekësor i FSK-së, dorëzohet në dosjen e personelit dhe me të njëjtin njoftohet edhe pjesëtari.

## Kujdesi shëndetësor për familjen e pjesëtarit

FSK-ja ofron kujdes shëndetësor për anëtarët e ngushtë të familjes së pjesëtarit të FSK-së, përderisa ai/ajo gjendet në mision jashtë vendit. Familjarit të pjesëtarit të FSK-së i cili gjendet jashtë vendit, të drejtat e kujdesit shëndetësor i takojnë siç janë të përcaktuara në paragrafët e kësaj rregulloreje. Procedurat e realizimit të këtyre të drejtave do të jenë të njëjtat të caktuar me këtë rregullore.

# Sfida jonë-investimi në mbrojtje dhe modernizimi i ushtrisë

**E**shtë organizuar më 18 gusht 2020, në stadiumin ushtarak në parkun e qytetit të Shkupit, manifestimi me rastin e 28-vjetorit të themelimit të Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në këtë aktivitet morën pjesë Presidenti dhe Komandanti Suprem i Forcave të Armatosura, Stevo Pendarovski, Ministria e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralletenant Vasko Gjurchinovski, krerët më të lartë të Armatës maqedonase, etj. Në manifestimin e 28-vjetorit të themelimit të ARM-së, por edhe në vitin e parë si anëtare e plotë e NATO-s, krerët e shtetit theksuan se në arritjen e këtij qëllimi strategjik kanë pasur mbështetjen e vazhdueshme të vendeve anëtare të NATO-s, në mesin e tyre me theks të posaçëm, të SHBA-së.

Presidenti dhe Komandanti Suprem i Forcave të Armatosura, Stevo Pendarovski, në fjalimin e tij tha se këtë vit si anëtare i 30-të i NATO-s, duhet të mbanin lart besimin e qytetarëve. Presidenti Pendarovski, theksoi se anëtarësimi i plotë në NATO nuk do të ishte i mundur pa përpjekjet e vazhdueshme dhe qëndrimin profesional të të gjithë anëtarëve të Ushtrisë, pa njerëzit që janë gjithmonë forca kryesore dinamike e procesit të integritimit. Anëtarësia jonë është rezultat i një reforme të plotë të mbrojtjes, angazhimit personal të grave dhe burrave të guximshëm në forcat tona të armatosura dhe pjesëmarrjen e tyre në misione të rrezikshme paqeruajtëse në të gjithë botën. Në të njëjtën kohë, ai theksoi se përgjegjësia e Anëtarësimit në NATO ngre në një nivel shumë më të lartë përgjegjësinë e Ushtrisë. Që nga marsi i këtij viti, uniforma dhe emri ynë janë pjesë përbërëse e kësaj aleance globale. Prandaj, ne duhet të vazhdojmë të investojmë në mbrojtje, modernizimin dhe pajisjen e Ushtrisë, dhe për këtë ju gjithmonë do të keni mbështetjen time personale”.

Ministria e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska vlerësoi punën e pjesëtarëve të ARM-së në kontributin gjatë menaxhimit të krizës së



Anëtarësimi në NATO ka pasur mbështetjen e vendeve anëtare të NATO-s, në menyre të veçantë, të SHBA-së

Pandemisë me CoVid-19. “Por, kriza Co-Vid tregoi se sa është afërsia ndërmjet ushtarëve tanë, armatës dhe qytetarëve. Ishim gjithkund ku kishte nevojë, në rajonet e rrezi kuara, para karantinës, bëmë transportin, mbajtëm rendin, siguruam kufijtë dhe i ndihmuam policisë, duke iu ardhur në ndihmë edhe punonjësve shëndetësor. Prandaj, u shpërblyem me besimin ndaj nesh për këtë përkushtim ndaj popullit tonë”, pohoi Radmilla Shekerinska.

Në fjalën e tij, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, duke theksuar se ky është viti i parë që ne festojmë ditëlindjen e tij si anëtare e plotë e NATO-s, për të cilin ne jemi veçanërisht krenarë, shprehu mirënjohje dhe respekt për të gjithë, ish-dhe aktivë ushtarakë dhe civilë nga Ushtria dhe Ministria e Mbrojtjes, i cili përmes punës së palodhur kontribuoi në ndërtimin, zhvillimin dhe integritimin e Ushtrisë në NATO. Duke iu drejtuar anëtarëve të Ushtrisë, gjenerali Gjurchinovski tha: “Sot, me krenari mund të them që kemi arritur shumë, por kemi akoma shumë për të bërë. Ne

kemi siguruar kushtet e duhura të dinjitetit të punës për të gjithë ju, në mënyrë që të mund të punoni edhe më të përqendruar në arritjen e qëllimeve tona, të cilat janë gjithmonë në shërbim të qytetarëve”. “Ne jemi të vetmit me besimin dhe mbështetjen më të madhe të qytetarëve në vendin tonë vazhdimisht, për të cilin unë jam veçanërisht krenar për të gjithë ju. “Besimi dhe mbështetja për ne është një njohje dhe njohje e qytetarëve për angazhimin dhe profesionalizmin tonë, bazuar në moralin dhe etikën në punën tonë, por edhe një detyrim për të vazhduar në rrugën e duhur”, tha gjeneralletenant Vasko Gjurchinovski, Presidenti Pendarovski dha çmimin më të lartë ushtarak “Urdhri i Meritës Ushtarake” për rezultatet e arritura në punën e batalionit të ndihmës mjekësore ushtarake, batalionin e tretë këmbësonisë të Brigadës së Parë të Këmbësonisë, si dhe Zyrën për Bashkëpunim në Mbrojtjen e Shteteve të Bashkuara. ndihmë dhe mbështetje e vazhdueshme në procesin e forcimit të kapaciteteve të Ushtrisë.



## Një Ukrainë e pavarur është thelbësore për sigurinë euro-atlantike

Përgatiti: MSC.MIMOZA GOLIKJA

V eprimet agresive të Rusisë kundër Ukrainës kanë minuar seriozisht sigurinë Euro-Atlantike. Ukraina është angazhuar në mënyrë konstruktive drejt një zgjidhjeje. Por çelësi për normalizimin e marrëdhënieve midis NATO-s, Rusisë dhe Ukrainës mbetet njohja nga ana e Rusisë për sovranitetin, pavarësinë dhe integritetin territorial të Ukrainës. Lehtësimi i sanksioneve në mungesë të lëvizjeve të rëndësishme do të dëmtonte besueshmërinë e Perëndimit dhe rrezikon destabilizimin e mëtejshëm. Kanë kaluar gjashtë vjet nga koha kur Rusia aneksoi ilegalisht Krimenë, një pjesë integrale e territorit të Ukrainës. Kjo ishte hera e parë që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore që një vend në Evropë u përpoq të ndryshojë kufijtë me forcë. Kjo shkelje e rëndë e ligjit ndërkombëtar u pasua nga destabilizimi i Ukrainës lindore nga Rusia, ku ajo ka mbështetur militantët në luftë me forcat ukrainase dhe dërgoi trupat e veta. Si përgjigje, NATO ka mbështetur fuqimisht sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës. Ajo filloi përfundimin më të madh të mbrojtjes së saj kolektive që nga fundi i Luftës së Ftohtë. Ajo pezulloi bashkëpunimin me Rusinë, ndërsa mbeti e hapur për dialog. Kombet perëndimore vendosën gjithashtu sanksione ndaj Moskës. Florian Encke që punon në Divizionin e Çështjeve Politike dhe Politikës së Sigurisë të NATO-s, në marrëdhëniet me Ukrai-

nën shpreh pikpamjet e tij lidhur me këtë. Referuar materialit të tij po sjellim shkrimin për lexuesin e shtypit ushtarak.

### A është kjo ende gasja e duhur?

Ka zëra në Perëndim që mbrojnë për një pragmatizëm të ri në trajtimin e Moskës. Disa mund ta bëjnë këtë për shkak të interesit për t'u rikthyer në marrëdhënie normale biznesi me Rusinë. Disa mund të jenë të motivuar nga një shqetësim i kuptueshëm për rreziqet e paraqitura nga aktiviteti ushtarak i përforcuar. Të tjerët mund të besojnë se kompromiset janë të domosdoshëm sepse Rusia është e nevojshme për të zgjidhur shumë sfida dhe kriza të tjera që përballen me sigurinë globale.

Por a mund të tejkalojnë këto objektiva nevojën për të mbështetur sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës?

Vizita e Këshillit të Atlantikut të Veriut në Ukrainë më 30 dhe 31 tetor 2019, tregoi mbështetjen e palëkundur të NATO-s dhe të gjithë aleatëve për Ukrainën.

Aleatët e NATO-s kanë qenë shumë të qartë se ata vazhdojnë të besojnë se një partneritet me Rusinë, bazuar në respektimin e ligjit dhe angazhimeve ndërkombëtare, do të kishte vlerë strategjike. Por ata nuk mund dhe nuk do të bëjnë kompromis me parimet mbi të cilat mbështetet Aleanca dhe siguria në Evropë dhe Amerikën e Veriut. Rusia u pajtua vullnetarisht në urdhrin e sigurisë, bazuar në rregulla, që ka shërbyer si dhe themelin e sigurisë në Evropë.

Ky urdher -i cili ka përfshirë midis dokumenteve të tjerë Aktin Final të Helsinkit, Kartën e Parisit dhe Aktin Themelues të NATO-Rusisë - synon të përfitojë nga të gjitha vendet në Evropë, bazuar në parimin e barazisë sovrane dhe individueshmërinë e sigurisë. Nuk është as armiqësor ndaj Rusisë dhe as i vjetëruar.

Dëshira e dukshme e Rusisë për të ndjekur interesat e saj të sigurisë përmes një përcaktimi të sferave të ndikimit midis fuqive të mëdha është krejtësisht e papranueshme. Do të mbante rreziqe të jashtëzakonshme për sigurinë evropiane. Sovraniteti dhe integriteti i Ukrainës është në zemër të rendit evropian të bazuar në rregulla. Interesat e saj të sigurisë duhet të merren plotësisht në konsideratë.

### Beteja e Ukrainës për pavarësi

Sfidat e sigurisë të paraqitura nga pohimi i Rusisë janë kristalizuar në betejën e Ukrainës për pavarësi. Për shekuj me radhë, ukrainasit e gjetën veten nën sundimin e fuqive të jashtme. Një shumicë dërrmuese e qytetarëve të saj mbështetën pavarësinë në një referendum në dhjetor 1991 (92.3 përqind votuan në favor me pjesëmarrjen e 84 përqind). Pavarësia u njoh ndërkombëtarisht menjëherë pas, përfshirë edhe nga njohja e Rusisë.

Ukraina, e cila kishte trashëguar arsenalin e tretë më të madh bërthamor në botë, u bashkua me Traktatin e Mospërhapjes, si një shtet jo-bërthamor në 1994. Në mbështetje të kësaj, Rusia, së bashku me Shtetet e Bashkuara dhe Mbretërinë e Bashkuar - më vonë u





bashkua Kina dhe Franca - i dha garanci të sigurisë Ukrainës, si pjesë e Memorandumit të Budapestit. Kjo përfshinte respektimin e pavarësisë, sovranitetit dhe kufijve ekzistues të Ukrainës.

Në 1995, Rusia dhe Ukraina ranë dakord reciprokisht të ndanin Flotën Sovjetike të Detit të Zi ndërmjet tyre. Kjo u pasua nga një marrëveshje për praninë e vazhdueshme të Flotës Ruse në Krimë të Ukrainës. Në vitin 1997, Rusia dhe Ukraina nënshkruan pastaj një Traktat mbi Miqësinë, të quajtur në atë kohë "Traktati i Madh". Nënshkrimi i Aktit Themelues të NATO-Rusisë dhe Kartës NATO-Ukrainë për një partneritet të veçantë në të njëjtin vit shton më tej kontekstin historik. Dukej që sovraniteti dhe pavarësia e Ukrainës ishin ngulitur me sukses në një kornizë ndërkombëtare, bazuar në respektimin e ligjit ndërkombëtar.

Për disa kohë, Ukraina kërkoi letra me vlerë shtesë duke ndjekur një "politikë multi-vektoriale". Pas ndjekjes së qëllimit të anëtarësimit në NATO pas 2002, u prezantua një "status jo bllok" kur Viktor Janukoviç u bë President në vitin 2010. Së bashku me Presidentin Rus, Dmitry Medvedev, ai nënshkroi Traktatin e Kharkiv në Prill 2010, i cili zgjati praninë e marinës ruse në Krimë deri në vitin 2042, në këmbim të furnizimeve më të lira të gazit rus. Lulëzimi i korrupsionit i dha Moskës mundësi të mëtejshme për të ndikuar në shtetin ukrainas gjatë këtyre viteve. Ndërkohë, për të kënaqur pjesët e mëdha pro-perëndimore të shoqërisë ukrainase, Yanukovych vazhdoi të ndjekë zyrtarisht integrimin më të thellë me Bashkimin Evropian.

"Politika multi-vektoriale" filloi të shembet si një shtëpi letre kur Rusia

detyroi Ukrainën të braktiste Marrëveshjen e Asociimit me Bashkimin Evropian në 2013, duke vendosur barriera tregtare kundër Ukrainës, në veçanti, më vonë edhe duke i ofruar Ukrainës një kredi si karrota. Protestat masive në Sheshin Maidan të Kyiv filluan kur Yanukovych ra dakord, gjë që shënoi fillimin e përfundimit të presidencës së tij. Duke e inkurajuar atë të përdorë forcë kundër protestuesve paqësorë, Moska kontribuoi më tej për rënien e tij.

Përmes pushtimit të saj ushtarak në Krimë, Rusia më pas u përpoq të rimarrë iniciativën. Presidenti rus Vladimir Putin shfrytëzoi rastin për të marrë nën kontroll gadishullin strategjik të rëndësishëm dhe për të rritur popullaritetin e tij në vend. Siç zbuloi Putin në një dokumentar një vit më vonë, vendimi u mor në rrethin e tij të brendshëm menjëherë pas fluturimit të Yanukovych për në Rusi. Realitetet politike në gadishull, nuk luanin asnjë rol. Asnjë forcë kryesore politike në Krimë, e cila kishte një status autonomie brenda Ukrainës, nuk kishte mbrojtur pavarësinë ose bashkimin me Rusinë. Asnjë kërcënim për popullatën që fliste rusisht nuk ekzistonte.

Viktimat e veprimeve të Rusisë ishin tërësia territoriale e Ukrainës dhe rendi i bazuar në rregulla euro-atlantike. Politika e Ukrainës për të adresuar dilemën e saj të sigurisë duke akomoduar interesat ruse, duke mbajtur kartën evropiane, ishte shembur. Serioziteti i kërcënimit rus për Ukrainën u bë edhe më i dukshëm me veprimet e saj agresive në Ukrainën lindore. Këto veprime treguan se objektivat e Moskës tejkaluan disa pretendime të mundshme territoriale. Asgjë më pak se sovraniteti dhe pavarësia e Ukrainës nuk ka qenë

në diskutim në luftën në Donbas, e cila tashmë ka marrë më shumë se 13,000 jetë.

Në fillim, Kremli mund të ketë parë një mundësi për të prishur shtetin ukrainas duke përhapur një koncept të "Novorossiya" ("Rusia e Re") në lidhje me rajonet jugore dhe lindore të Ukrainës. Kur kjo dështoi, Rusia e zgjati konfliktin në Donbas për të destabilizuar Ukrainën, si dhe për të minuar perspektivën e qeverisë në Kyiv dhe Ukrainën për integrimin evropian dhe euro-atlantik. Ironikisht, veprimet agresive të Rusisë ishin ndoshta arsyeja pse mbështetja popullore në Ukrainë për anëtarësimin në BE dhe NATO u ngjiti në nivele të pashembullta gjatë kësaj kohe.

### Sanksionet e synuara

Në përgjigje të veprimeve agresive të Rusisë kundër Ukrainës, vendet perëndimore vendosën sanksione ndaj Moskës. Edhe pse sanksionet janë zgjatur shumë herë, disa vazhdojnë t'i kritikojnë ato. Akuzat se ato janë jolegjitime apo joefektive janë megjithatë të pabaza.

Sanksionet janë një kundërmasë legjitime kundër shkeljeve të ligjit ndërkombëtar nga ana e Rusisë, duke shmangur çdo përshkallëzim të mëtejshëm ushtarak. Ato u krijuan me kujdes për të synuar anëtarët e elitës ruse përgjegjës për veprimet që dëmtojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës. Ato gjithashtu krijojnë stres në zhvillimin afatgjatë të Rusisë në sektorin e naftës, gazit dhe bankave, në veçanti, për të bërë presion drejtmitur për të ndryshuar kursin. Ato nuk e synojnë drejtpërdrejt popullatën ruse. Kjo

është qartësisht një përgjigje e matur. Për krahasim, mund të argumentohet se kundër-sanksionet ruse, siç është ndalimi total i importeve të ushqimit nga Bashkimi Evropian, kanë pasur implikime më të menjëhershme tek njerëzit e zakonshëm nga të dy palët.

Ekzistojnë dëshmi pozitive që sanksionet kanë pasur efekt. Me shumë pak përjashtime, shtetet i janë përmbajtur Rezolutës 68/262 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, e cila në mars 2014 u bëri thirrje të gjitha shteteve, organizatave ndërkombëtare dhe agjencive të specializuara që të mos njohin ndonjë ndryshim të statusit të Krimesë. Dhe sanksionet ekonomike janë një mjet i domosdoshëm për ta mbajtur Rusinë përgjegjëse ndaj angazhimeve të saj nën Marrëveshjet e Minsk, të cilat po përpiqet t'i shmangë. Lehtësimi i sanksioneve në mungesë të lëvizjeve të rëndësishme nga ana e Rusisë do të dëmtonte seriozisht besueshmërinë e Perëndimit. Ajo nuk do të kontribuonte në zgjidhjen e konfliktit, por rrezikon të destabilizojë Ukrainën edhe më tej.

### **Ndërhyrja e Rusisë**

Rusia është palë në Marrëveshjet e Minsk dhe si e tillë ajo mban përgjegjësi të konsiderueshme për zbatimin e tyre. Pa mbështetjen ruse, të ashtuquajturat "republika të njerëzve" në Donetsk dhe Luhansk, do të shembeshin shpejt. Ato përbëjnë pengesën kryesore për një zgjidhje. Dihet që "përfaqësuesit" e tyre nuk kanë asnjë qëllim që të riintegohen në Ukrainë.

Moska ka qenë këmbëngulëse në përpjekjet e saj për të megjulluar përfshirjen e saj të drejtpërdrejtë në konflikt duke detyruar Ukrainën në marrëdhënie të drejtpërdrejta zyrtare me përfaqësuesit e saj dhe të riintegrojë zonat e diskutuara në Ukrainë me status të veçantë. Ndërsa "statusi i veçantë" përmendet në Marrëveshjet e Minskut, një marrëveshje që do të dëmtonte sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës do të ishte në kundërshtim me qëllimin e tyre. Përkundër kësaj, Kremli është këmbëngulës në refuzimin e tij madje të diskutojë çdo perspektivë të rivendosjes së kontrollit të Ukrainës mbi pjesën e saj të kufirit.

Pika 10 e Paketës së Masave ("Minsk II") - e cila parashikon tërheqjen e formacioneve të armatosura të huaja, pajisjet ushtarake si dhe mercenarët nga territori i Ukrainës nuk diskutohet as pasi Rusia vazhdon të mohojë praninë e saj në Donbas dhe dërgimi i saj i vazhdueshëm i armëve dhe pajisjeve militantëve. Shkeljet e armëpushimit, përfshirë edhe me armët e rënda të ndaluara, vazhdojnë. Misioni Special i Monitorimit i OSBE-së vazhdon të jetë i kufizuar shumë nga militantët e mbështetur nga Rusia.

Për më tepër, ndërsa Rusia po bën presion ndaj Ukrainës që të vazhdojë me rrugën politike të Marrëveshjeve të Minskut, ajo po promovon integrimin de-fakto të "republikave" të njohura në Federatën Ruse, veçanërisht duke futur Rublën Ruse dhe duke shpërndarë masivisht Pasaportat ruse për popullsinë vendase.

### **Durim dhe mbështetje strategjike**

"Aleatët kanë kërkuar vazhdimisht zbatimin e plotë nga të gjitha palët të marrëveshjes, ndërsa Ukraina me siguri ka ene punë për të bërë nën Marrëveshjet e Minskut, Kyiv ka bërë përpjekje marramendëse drejt zbatimit të tyre". Në përputhje me angazhimin e Presidentit Poroshenko, u miratua legjislacioni mbi "statusin special" dhe amnistinë, është gati të zbatohet pasi të lejojë situata e sigurisë. Diskutimet filluan për perspektivën e zgjedhjeve lokale në Donbas.

Presidenti Zelensky gjithashtu e ka bërë paqen në Lindje një përparësi dhe ka marrë përsipër përgjegjësinë. Në fjalimin e tij inaugurues në maj 2019, ai deklaroi: "Ne nuk jemi ata që e filluam këtë luftë. Por ne jemi ata që duhet ta përfundojmë." Që atëherë, ai ka bërë përpjekje për t'u përqëndruar në faktorin njerëzor dhe për të rikthyer zemrat dhe mendjet e njerëzve në zonën e konfliktit. Ai ra dakord për shkëputjen e trupave në tre zona pilot. Megjithë rezistencën e madhe publike në Ukrainë, në tetor 2019, ai pranoi të ashtuquajturën "formula Steinmeier", e propozuar nga Presidenti gjerman Frank-Walter Steinmeier përsëri në vitin 2016 kur ai ishte ministër i Jashtëm, i cili parashikon zbatimin e "statusit special" në

zona të caktuara të Donbas pas zgjedhjeve lokale atje nën legjislacionin ukrainas dhe monitorimin ndërkombëtar.

Eshtë e qartë, lufta për pavarësi mbetet detyra kombëtare e Ukrainës. Varet nga ukrainasit të vendosin se si të rivendosin integritetin territorial pa dëmtuar sovranitetin dhe pavarësinë. Ukrainasit kanë nevojë dhe duhet të jenë në gjendje të vendosin të ardhmen e tyre. Ata e kanë sqaruar se dëshirojnë të jetojnë në një vend të prosperuar dhe paqësor, të ankoruar fort midis demokracive evropiane të përkushtuara ndaj vlerave të përbashkëta. Në të ardhmen, shumica e sheh vendin në Bashkimin Evropian dhe NATO.

Lufta për pavarësinë e Ukrainës ka një dimension të brendshëm, i cili nuk është më pak i rëndësishëm se ai i jashtëm. Për dekada të tëra, mungesa e reformave strukturore, korrupsioni, interesat e vendosura dhe sundimi i dobët i ligjit kanë dobësuar perspektivën e Ukrainës për zhvillim dhe rezistencë ndaj sulmeve hibride. Ato janë gjithashtu rezultat i mungesës së orientimit strategjik të udhëheqjes së saj për shumë vite.

Disa ende mund të besojnë se Ukraina mund të ketë një "funksionurë" midis Rusisë dhe Perëndimit. Por pas ngjarjeve në Ukrainë dhe gjetkë, çelësi për normalizimin e marrëdhënieve midis NATO-s, Rusisë dhe Ukrainës mbetet njohja pa ekuivoke e Rusisë për sovranitetin, pavarësinë dhe integritetin territorial të Ukrainës. Çelësi për zgjidhjen e konfliktit në Ukrainën lindore qëndron te Moska.

Përtej kësaj, fakti që Rusia ka zgjeruar sjelljen e saj agresive në zona të tjera të botës dhe filloi një seri sulmesh hibride ndaj vendeve perëndimore, lë pak vend për çdo normalizim të marrëdhënieve NATO-Rusi. Që kjo të ndodhë, do të kërkohej një ndryshim i qartë, konstruktiv në veprimet e Rusisë që tregon përputhjen me ligjin ndërkombëtar dhe detyrimet dhe përgjegjësitë e saj ndërkombëtare. Eshtë e qartë, kjo duhet të fillojë me një ndryshim në sjelljen e Rusisë përballë Ukrainës. Durimi strategjik do të jetë i nevojshëm, derisa Moska të jetë e gatshme të mbështesë një zgjidhje të qëndrueshme.

Ukraina vazhdon të ketë nevojë për mbështetje perëndimore.

# 1925-2020

## 95 vjetori i Flotës Detare shqiptare

**M**e shpalljen e pavarësisë më 28 nëntor 1912, u bënë përpjekjet e para për organizimin e FD shqiptare nga qeveria e Ismail Qemalit, por fillimi i Luftes së Parë Botërore e ndërpreu këtë angazhim.

Në vitin 1925, organizimi i ushtrisë synoi të bëhej mbi bazën e statusit të Shqipërisë hartuar më 07.03.1925. Mbi bazën e këtij statusi u krijua Komanda e Përgjithshme e Fuqive Ushtarake. Më 25 dhjetor 1925, mbërrinjë nga Italia dy anije 190 tonësh, të cilat u emërtuan me emrat domethënës "Shqipëria" dhe "Skenderbeg". Këto anije u pajisën me efektiva marinarësh duke kryer detyra në interes të luftës kundër kontrabandës në brigjet shqiptare.

Më 1928, u krijua Komanda e Marinës dhe më konkretisht më 24.06.1928, kur u mblodhën rekrutët e parë për këtë armë. Më 1934, u blenë po nga Italia edhe dy anije të tjera të lehta, të cilat u emërtuan "Saranda" dhe "Durrësi". Gjatë periudhës së Luftes së Dytë Botërore pothuajse u shkatërrua gjithçka nga këto anije. Çlirimi i Shqipërisë e gjeti Flotën Shqiptare në gjendje të mjerueshme me pothuajse të gjitha anijet e mbytura në portet e bregdetit shqiptar. Në prill 1945, u krijua Kantieri Detar Durrës për riparimin e varkave ekzistuese, nxjerrjen e anijeve të mbytura gjatë luftës dhe përgatitjen e tyre për qëllime ushtarake. Më 15 gusht 1945, u bë përrurimi i hedhjes në ujë të dy motoskafeve trofe, me numër MS 10 dhe MS 12. Këto motoskafe u armatosën me mitraloz të lehtë dhe filluan patrullimin për ruajtjen e ujërave bregdetare në Vlorë e Sarandë.

Në këtë periudhë u punua me një vizion të qartë për zhvillimin dhe perspektivën e Forcave Detare, duke



Forca Detare Shqiptare ka për qëllim sigurimi dhe ruajtja e sovranitetit të hapësirës detare të Shqipërisë dhe zbatimin e ushtrimit të ligjshmërisë në det.

shfrytëzuar edhe konjunkturat politike të kohës. Kështu mund të përmendim vitet '53-'54, që shënuan fillimin e një etape të re zhvillimi të FD me pajisjen e tyre me silurhedhëse e më vonë me minaheqëse, gjuajtës detar dhe anije ndihmuese të llojeve të ndryshme. Më 14 shkurt 1954, u krijua Skuadrilja e Katrave Silurues me vendbazim në ishullin e Sazanit, kjo shënon edhe fillimin e një stadi të ri zhvillimi të FD. Zhvillimi i modernizimi i flotës filloi me ritme të shpejta, sidomos pas vitit 1957. Më 21 shtator 1958, filloi aktivitetin një nga njësitë më speciale e më të rëndësishme të FD shqiptare, Njësia e Nendeteseve, në përbërje të së cilës ishin 4 nëndetëse të prodhuara në ish-Bashkimi Sovjetik.

Në gusht të vitit 1961, u hap Shkolla e Marines në Vlorë e cila me pas u quajt Shkolla e Trupes e Detarise, e cila ka luajtur një rol të madh në përgatitjen dhe furnizimin e Flotes Luftarake Detare me kuadro oficerë. Periudha e viteve 1961-1980, shënoi zhvillimin e mëtejshëm të Forcave Detare, krijimin e disa reparteve të KS, kompletimin me anije luftarake moderne të kohës. U krijua Shërbimi Hidrografik, si organizim sigurimi lundrimordetar e të veprimeve luftarake, i cili përgatiti e ngriti një varg faro-fenerësh në gjithë bregdetin, u modernizuan mjaft pika sinjalvrotuese dhe u pajisën me një rrjet të gjerë radiolokatorësh. Periudha e viteve 1980-1980, mund të konsiderohet si periudha e vijueshmërisë

së lundrimeve, mbijetesës, drejtimin dhe sigurimin e gatishmërisë teknike të anijeve mbiujëse e nënujësë. Një kontribut të madh në këtë drejtim ka dhënë edhe Kantieri Detar i Riparimit të Anijeve në Pashaliman.

Mbas viteve '90, për FD shtrohej detyra e ristrukturimit, rikonceptimit të reparteve të saj për një integrim të natyrshëm me strukturat e NATO dhe BEP-it. Në këtë periudhë vlen për t'u theksuar, mbështetja që dhanë kuadrot dhe efektivat e FD për proceset demokratike në vend, fal pjekurisë politike, shpirtit atdhetar e demokrat. U rrit në mënyrë të ndjeshme, bashkëpunimi me flotat e vendeve perëndimore e veçanërisht me ato të NATO, ku u zhvilluan me sukses mjaft stërvitje të përbashkëta, si "SAREX-1", "SAREX-2", "MAREX-1", "MAREX-2" etj, në të cilat kuadrot tanë treguan një nivel të lartë profesional, nivel i cili u vlerësua nga të huajt.

Ngjarjet tronditëse të marsit 1997, shkaktuan në repartet e FD dëme shumë të mëdha. Gjysma e dytë e vitit 1997 dhe viti 1998, shënon një etape ringritjeje dhe riorganizimi të reparteve të FD pas shkatërrimit total. Pas një pune këmbëngulëse dhe përkushtimi maksimal të kuadrove e efektiveve të FD, u bë e mundur ringritja dhe funksionimi i Distrikteve Detare të Durrësit e Vlorë, si dhe Bazat Ndihmuese, Sarandë e Shengjin. Vlen për t'u përmendur në këtë proces ringritjeje, ndihma e partnerëve



tanë perëndimorë si: SHBA, Italia, Turqia, Greqia, Gjermania, etj. Mbas vitit 1997, u synua ringritja e FD me anije të cilat gjatë ngjarjeve të marsit u strehuan në Itali, dhe që fal marrëveshjes së përbashkët të të dy shteteve, pas riparimit u rikthyen në Shqipëri. Në mars të vitit 1998, me ndihmën e qeverisë së SHBA, FD u pajisën me 5 motovodeta, të cilat u bënë protagoniste të operacioneve SAR në vitet e ardhshme. Më 1998, si rezultat i kohës së gjatë të përdorimit dolën jashtë strukturave luftarake të FD, të 4 nendetese e saj pas një veprimtarie 40-vjeçare.

Në vitin 2002, me kontributin e qeverisë italiane pas miratimit të ligjit të Rojës Bregdetare shqiptare, nr. 8875 datë. 04.04.2002, FD u pajisën dhe me 6 motovodeta nga Italia, të cilat së bashku me anijet amerikane u futën në strukturat e



Rojës Bregdetare. Në gusht 2002, 14 anije të FD morën pjesë në operacionin e gjerë antitrafik "PUNA", në bashkëpunim me organet e rendit, antikontrabandës, peshkimit, etj, i cili u realizua me sukses dhe bëri të mundur bllokimin e këtij trafiku.

Më 12 shtator 2005, në rajonin e Gjirit të Vlores u zhvillua stërvitja më e madhe e përbashkët detare "Cooperative Engagement" me pjesëmarrjen e flotave të 14 vendeve të ndryshme të botës. Forca Detare morën pjesë me 19 anije të tipeve të ndryshme. Në shkurt 2007, filloi puna për zbatimin e Sistemit të integruar të Vëzhgimit, projekt që u zbatua nga firma prestigjioze "Lockheed-Martin".

Në qershor të vitit 2007, Forcat Detare kaluan në strukturën e re, Brigadë Detare me dy Flotilje (FDV E

FDJ) dhe një Batalioni Logjistik. Gjatë këtij viti, nga efektivat e FD u ndërmorën mbi 10 operacione kërkim-shpëtimi dhe disa stërvitje brenda e jashtë vendit në bashkëpunim me flotat partnere të NATO. Në nëntor 2007, u nënshkrua marrëveshja me Holondë, (Kantieri "DAMEN SHIPYARD), për pajisjen e FD me 4 anije patrulluese. Më 4 dhjetor 2007, në paradën e zhvilluar me rastin e përvjetorit të krijimit të FA Shqiptare, FD u përfaqësua denjësisht me 2 kuadrate, (një me kuadro, një me detarë). Më datë 07.02.2008, në Ministrinë e Mbrojtjes u zhvillua ceremonia e nënshkrimit të Memorandumit Taktik të Mirëkuptimit për pjesëmarrjen e Shqiperise në operacionin "Active Endeavour", (TMOU). Ky memorandum përcakton detyrat dhe mënyrat e pjesëmarrjes së vendit tonë në operacionet "Active Endeavour", në

kuadrin e NATO, që përfshin kryesisht shkëmbimin reciprok të informacionit mbi situatën detare në zonat gjeografike ku shtrihet ky operacion, komunikimet, pajisjet e nevojshme si dhe bashkëveprimin e mëtejshëm midis palëve në këto fusha. Nga data 1-5 mars 2028, 5 anije të Grupit të 2-të Detar të NATO (SNMG2), me qendër në Napoli zhvilluan një vizitë portuale në vendin tonë.

Qëllimi i kësaj vizite ishte forcimi i bashkëpunimit dhe rritja e mirëkuptimit midis vendit tonë dhe strukturave të NATO. Grupi i 2-të i anijeve përbëhet nga: TCG SALIHREIS TCG SALIHREIS (Turqi), anije flamurtare, HMS SOMERSET (Britani e Madhe Britani), ITS EURO (Itali), FGS NIEDERSACHSEN (Gjermani) dhe HS HYDRA (Greqi). Misioni i Grupit të 2-të të anijeve është kryerja e operacioneve

të ndryshme në Detin Mesdhe. Gjatë kësaj vizite, ekuipazhet e anijeve të NATO vizituan vende të rëndësishme historike dhe kulturore në Durrës, Krujë, Berat, etj, si dhe zhvilluan aktivitete sportive me repartet e BrD dhe strukturat e Policise së Sigurise Portuale. Në datën 5 shtator 2008, në Kalatën Nr. 5 të Portit të Durrësit u zhvillua ceremonia e përvjetorit të anijes "Iliria" (P-131), e cila mbërriti në Shqipëri në kuadër të zbatimit të kontratës me Kompaninë Holandeze "DAMES SHIPYARD". Në këtë ceremoni morën pjesë autoritete të larta politike dhe ushtarake, komandantë të reparteve të ndryshme, atashe ushtarakë të akredituar në vendin tonë, shefa të Misioneve të Huaja ushtarake në vend, etj.

Mbas një pune njëvjeçare, në muajin nëntor 2008, u zhvilluan provat finale për marrjen në dorëzim të Sistemit të Integruar të Vëzhgimit Detar (SIVHD), të instaluar nga specialistët e kompanisë "Lockheed Martin".

Detyrat e Forcave Detare janë: të sigurojë në çdo kohë, aftësi operacionale dhe gatishmëri luftarake, me kapacitetet e nevojshme për t'ju përgjigjur kërcënimeve dhe rreziqeve në realizimin e misionit kushtetues; të sigurojë dhe të mbrojë hapësirën detare territoriale dhe bregdetin shqiptar, duke kryer operacione të përbashkëta me strukturat e FA dhe të NATO në drejtimet e kërcënuara; monitorimi dhe kontrolli i trafikut detar në ujërat territoriale dhe vijën bregdetare; organizimi dhe realizimi i operacioneve të kërkim-shpëtim (SAR) dhe operacioneve humanitare në ndihmë të popullsisë në bashkëpunim me strukturat e FA; të ruajë dhe të mbrojë mjedisin detar për zbatimin e ligjshmërisë në det; sigurimi i kushteve hidrolundimore dhe sinjalistikës detare për një lundrim të parrezikshëm në hapësirën detare të RSH; të ruajë dhe mbrojë mjedisin detar nga ndotjet dhe të ushtrojë kontrollin e kalimit të paligjshëm të mallrave dhe njerëzve dhe të marrë pjesë në përbashkëpunim me organizmat shtetërore të specializuara në këtë drejtim.

## Kontributi i At Shtjefën Gjeçovit për sigurinë publike në Luftën e Vlorës


PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

**Një jetë në shërbim të kombit- diellin atdhetar nuk e shuan as errësia dhe as plumbi**

Shtjefën Gjeçovi (Mëhill Gjeçi) ishte lindur më 12 korrik 1874, në Janjevë të Kosovës në një familje katolike. Babai i tij Mat Gjeçi-Kryeziu (kishte marrë llagapin nga vendlidja e tij në Kryezi të Pukës) dhe nëna Prenda, ja vunë emrin Mëhill, por e thirrën Hilë. Trualli atdhetar dhe të parët të zgjuar prej natyre e bënë Mëhillin një fëmijë tepër të zgjuar. Duke e parë këtë gjendje famullitari francezkan i Janjevës, u mori leje prindërve, dhe e mori një ditë për dore Shtjefënin 10 vjeçar dhe u nis bashkë me të për në Kolejiin francezkan që ndodhej në Shkodër. Kur i veshën zhgunin e murrmë, të fratit ju duk vetja më i rritur dhe më i burrëruar. Arsimitin francezkan e mori në Troshan (1884-1888). Më 16.8.1888 u nis në kuvendin e Fojnicës për vitin e rishtarisë dhe vijoi studimet më tej në Derventë dhe Banja Luka, por ndoqi mësimet edhe në Kreshevë. Në këtë periudhë Bonjë-Hercegovina, ishte trualli ku përgatiteshin një pjesë e konsiderueshme e francezkanëve shqiptarë, në të njëjtin vend ku u arsimua edhe Gjergj Fishta. Studimet e tij vijuan deri në vitin 1896 kur edhe kthehet në atdhe dhe meshon për herë të parë në Troshan, vit që ndërron emrin dhe në rregjistrat francezkanë quhet: Shtjefën Kostandin Gjeçovi. Shërben si famullitar në Rubik; në verën e 1897 në Pejë, ku emërohet famullitar në Zllakuqan, vendi që në korrik hap shkollën e parë. Nga 1899 deri më 1905 shërben në famullinë e Laç-Sebastes, ku rihap shkollën shqipe në Laç. Lidh shoqëri të ngushtë me Konicën dhe përmes tij siguronte materiale mësimore për nxënësit. Në fund të dhjetorit 1905 punësohet mësues Kroaci (Borgo-Erizzo), ku zëvendëson Pashk Bardhin, por dorëhiqet dhe pas disa muajsh është aktiv dhe merr pjesë në Kuvendin e Bajrakut të Kurbinit. Në gusht 1906 gjendet në Durrës dhe pas disa muajsh nga tetori 1906 deri më 1907, ngarkohet me kolegjet francezkanë në Shkodër. Në maj 1907 caktohet në Gomsiqe, ku çeli edhe shkollën e parë në këtë fshat. Bashkë me Dom Nikollë Kaçorrin kontribuon për kuvendet e Kurbinit, përshëndet punimet e Kongresit të gjuhës shqipe të Manastirit, (14.11. deri më 22.11.1908), për standardizimin e alfabetit të gjuhës shqip. Prushi atdhetar e rreshton krahas forcave më përparimtare të kohës si kundërshtar i pushtimit, bashkëpunues në futjen e armëve nga tregjet e huaja, kundër fushatave ndëshkuese radhitet me çetat komite. Përjeton me gëzim pavarësinë e 28 nëntorit 1912 në Vlorë. Më tej është pjesëmarrës me krerët e Pukës, Mirditës, Zadrimës e Lezhës, në kuvendin e 7 korrikut 1913 në Lezhë. Vitet që pasuan emërohet në Troshan (1915) dhe pas një viti më 1916 në Theth, Shalë e Shosh, ku kolera kishte pllakosur zinë e pandemisë dhe vdekja ishte fare pranë jetëve njerëzore. Në kohën e pushtimit austrohungarez punon në Prekal dhe shtëpia ku u vendos banohej edhe nga komanda lokale austrohungareze. Në shtator 1917 jep mësim fëmijëve shqiptarë në dhomën-shkollë ku banonte, për 26 nxënës-djem paradi të dhe 11 nxënës mbasdite, mësimdhënie që e kërcënuan

*[Kushtuar Mëhill Gjeçi-Kryeziu/At Shtjefën Kostandin Gjeçovi veprimtar i lëvizjes kombëtare shqiptare, frat francezkan, etnolog, arkeolog, poet e shkrimtar i spikatur, filozof, përhapës i shkollave shqipe në Shqipëri-në e këtij Drinit dhe matanë Drinit, "Mësues i popullit", inisiator për unifikimin e gegërishtes me toskërishten, mbrojtës i paepur i sigurisë së qytetarëve të Vlorës përgjatë Luftës Kombëtare të Vlorës të 1920-ës dhe figurë me përmasa të madha kombëtare. Mëhill Gjeçi-Kryeziu është quajtur për 22 vjet, nga lindja e tij më 12.7.1874 deri më 29.6.1896, kur e ka ndryshuar emrin në Shtjefën Kostandin Gjeçovi, pasi përfundoi studimet e larta teologjike në Kreshevë të Dalmacisë dhe në rregjistrat francezkan zhduket emri Hilë Gjeçi dhe zëvendësohet me Shtjefën Konstantin Gjeçovi. Faik Konica e ka cilësuar Gjeçovin si, "njeri nga njerëzit më të lartë që ka pasur Shqipëria", ndërsa albanologu austriak Norbert Jokli e ka quajtur, "punëtor i palodhur në fushën e letrave shqipe". Gjeçovi bashkëpunoi me revistat e kohës: "Populli", "Hylli i dritës", "Albania", "Brezi i ri", ku ne e gjejmë me pseudonimet "Komnen Kanina", "Lkeni i Hasit", "Zana e Prezës", "A.Sh.K.Gj.", "O.F.M.", dhe nga ana tjetër la rreth 10.000 faqe dorëshkrime. Ai ishte si një "makinë intelektuale" enciklopedike, i cili njihje tetë gjuhë të huaja dhe që konsiderohet "Instituti shkencor gjeçovian"]*

me ndalim veprimtarie si mësues, duke e kushtëzuar furnizimin material me fenë. Pranvera e vitit 1920 e gjen Shtjefën Gjeçovin në kishën katolike të Vlorës, ku takohet shpesh te Dom Mark Vasa, që kishte marrë mërinë e autoriteteve italiane. Bëhet njësh me patriotët më të zjarrtë të krahinës së Vlorës dhe merr pjesë në takimet për çlirimin e Vlorës nga pushtuesit italianë. Gazetat "Politika", "Mbrojtja kombëtare", "Drita" e cilësojnë Shtjefën Gjeçovin si "luftëtar i Njëzetës", si mbrojtës të komunitetit vlonjat në periudhën e luftës, si hulmues dhe njohës të traditave të Labërisë dhe të përbashkëtat zakonore të të gjithë shqiptarëve. Pjesëmarrës në të gjithë aktivitetet e komisionit organizator të fitores së Luftës së Vlorës. Më 7.6.1923 emërohet sekretar i Provincës Francezkanë. Pas një viti më 1924 gjendet në krahinën e Elbasanit, ku gjatë verës bashkë me Simon Shuteriqin zbulon të kishën e Shënkollit të qytetit të Elbasanit këmbanë e Sopotit të Bërzeshit, që datonte që nga koha e Gjergj Aranitit. Më 1926 emërohet në famullinë e Zymit të Hasit të Thatë, ku aktivitetin e zhvillonon edhe në Pejë, Gjakovë e Prizren. Dora gjakatare ngrihet kundër Shtjefën Gjeçovit 55 vjeçar, në vendin e quajtur Kodër Rrezina më 14.10.1929, duke i marrë jetën qarqe antishqiptare, por që nuk mundën që vrisnin idealet e tij patriotike atdhetare të shqiptarizms dhe përhapjes së kulturës kombëtare shqiptare. "E keqja", që kishte bëra Gjeçovi është se për gjashtë muajt e fundit të jetës kishte punuar në Zym nga prilli deri më 14 tetor, ku u mësonte gjuhën shqipe fëmijëve dhe të rriturve, pa marrë parasysh se cilit besim i takonin. Një pëllëmbë për mësuesin serb të mbretërisë serbo-kroate sllovene paguhej me plumb. Mësuesi



i Kombit Shtjefën Gjeçovi është varrosur në Shëngjergj afër Zymit të Hasit. Në Zym gjendet edhe qendra memoriale e ndërtuar në nder të tij.

### **Shtjefën Gjeçovi - shpirti atdhetar i sigurisë publike në Luftën e Vlorës**

Shqiptarët dinë ta lexojnë mirë lirinë, pavarësinë, sovranitetin sikurse dinë t'ja dedikojnë sovranitetin burrave të mëdhenj të kombit. Këta burra çuditërisht kanë qenë në kohën dhe momentin e duhur për të luftuar me trimëri, me mençuri dhe me vendosmëri për të shpalosur fuqinë popullore kombëtare në situatat më deçizive të rivendosjes së pavarësisë dhe sovranitetit. 1920-ta ishte prova e së vërtetës, ku një ndër figurat më të ndritura të kombit, atdhetari, frati françeskan dhe mësuesi i apasionuar u gjend dhe ju gjet Vlorës në situatë rreziku e kërcënimi, duke u bërë mbrojtje e sigurisë publike brenda në qytet vlonjatëve në periudhën gjatë Luftës së Vlorës, duke shpëtuar dhjetra e qindra vlonjatë nga syrgjynosja dhe burgimi, kësaj vale të ashpër të pushtuesve italianë. Lufta kombëtare e Vlorës (5.6.1920-3.9.1920) pati një pjesëmarrje të gjerë të popullit të bashkuar në një mision kombëtar atdhetar. Por në këtë luftë nuk mund të lëmë pa përmendur komunitetet fetare që u treguan kaq dinjtozë dhe kaq atdhetarë në çastet më të rënda të rrezikut të pavarësisë të bërë njësh me ndërgegjen kombëtare dhe të tillë ishin si: At Shtjefën Gjeçovi, Osman Muka Myftiu i Vlorës, Hoxhë Rushiti i Kaninës, Mulla Muhameti nga Kanina, Mulla Halimi nga Gorishti, Baba Ahmet Turani i teqesë së Turanit Tepelenë, Baba Xhaferi i Përmetit, At Isai nga Vlora dhe Dom Mark Vasa katoliku patriot që u internua në ishullin e Sazanit nga italianët. At Shtjefën Gjeçovi pjesë e elitës së mençurisë të burrave që ju gjenden kombit në kohë të vështira. Nga komunitetet fetare nën siglën "pa Atdhe nuk ka fe" u bë devizë shpëtimi gjatë luftës ku shqiptarët u përbashkuar në unitet mendimi e veprimi, që "cështja e Vlorës të zgjidhej me armë", nën përbetimin: "O Shqipëri o gur e hi!". Lushnja dhe Vlora ishin një shtëpi me dy oxhaqe. Njeri (Kongresi i Lushnjës), hartoi platformën politike të mëvetësisë dhe shtetit unitar dhe i dyti (Vlora), materializoi në praktikë atë që vendosi Lushnja, prandaj madhështia e të dy ngjarjeve nuk mund të ndahen, sepse sollën rrezultatit e prishëm: "Pavarësinë e dytë të Shqipërisë". Përmbledhjen më të bukur të Luftës së Vlorës ja ka bërë populli në vargje: "Në Beun kur u mëlodhë./ Dymbëdhjetë komisionë./ Osmën Haxhiu ka folë./ Çetat rrinë e dëgjojnë./ O djem do vemi në Vlorë./ Dyfekë e flamur në dorë./ O ju djem trima stërralli./ Na thërret Smail Qemali./ Atje tek dergjet tek varri./ Nga varri i tij në Kaninë./ Na e dërgon porosinë./ Hidhni në det Italinë!". Është një fakt domethënës historik se komunitetet fetare kanë qenë e janë bashkuar në idealin e shqiptarizmes në luftë e në paqe. Prandaj nderimi për Gjeçovin, Osman Haxhiun, "Komisionin" e KMK-së, dëshmorët, luftëtarët, prijësat emër për emër është nderim për këto figura të pashmangëshme historike, që vullën dhe fjalën e fundit duhet ta thonë vetëm historianët seriozë. Edhe pse në një shekull në hapësirën shqiptare kaq komplekse me shumë ndryshime, zhvillime, ngritje e ulje, rrëmuja e rrokopuja, ëndrra e zhgënjimet, për një gjë duhet unitet kombëtar: për shqiptarizmin!

### **Në Vlorën e përflakur dhe përzhitur nga lufta riceli ëndërra e lirisë**

Shtjefën Gjeçovi, i ndodhur në Vlorë përgjatë luftës së Vlorës, do të shkruante: "burrat e dheut që e liruën Vlorën me një trimni të pashoqe..." dhe zonjat e saj që "ku të jetë puna e patriotizmit i gjen në çdo të rasë gati..." (DPASH, F 58.V.1920, Dosja 21, faqe 68,69).

Udhëheqja e luftës, prijësat e çetave dhe luftëtarët dhe komunitetet fetare pritën fundin e luftës dhe zbatimin e marrëveshjes. Në radhën e parë të organizatorëve brenda qytetit të Vlorës ishte edhe Shtjefën Gjeçovi, një mbështetës i fuqishëm i lirit të Vlorës me platformën: "secili në shtëpi të vet". Shtjefën Gjeçovi kishte marrë në mbrojtje në mënyrë të qetë e të mençur mjaft qytetarë vlonjatë e sidomos fëmijë, gra e të pafajshëm vlonjatë që në fundqeshorin e 1920-tës ishin bërë pre e represionit të egër të italianëve. Kishte qenë ky represion hakmarrës që e kishte detyruar KMK-në t'ju drejtohej me nota proteste pushtuesve italianë dhe kopje të saj edhe Fuqive të Mëdha: Anglisë, ShBA-së dhe Francës. (DPASH, F "L. Vlorës", Dosja 1, dok, nr.51254). Zbatimi i marrëveshjes së 2 gushtit 1920 parashikonte kthimin në shtëpi të të gjithë ushtarakeve italianë të zënë rob prej shqiptarëve dhe të syrgjynosurve tanë robër, që vinin nga Gryka e Xhenemit në Sazan. Të burgosurit pritëshin me gëzim nga pala shqiptare dhe me mospërfillje nga italianët

për të tyre. Zemrat vlonjate prisnin nga Sazani të dashurit e tyre dhe bashkë me ta dhe Shtjefën Gjeçovi që i gëzonte zemra për çdo jetë të shpëtuar sikurse ndjeu hidhërim të madh kur me ardhjen e të burgosurve shqiptarë mungonin mbi 70 veta, për të cilën italianët nuk folën kurrë, por u "rregjistruan" në të humburit e luftës, edhe pse ata janë dëshmorë të përgjithshëm të rracës shqiptare. Sa herë përkujtohet Lufta e Vlorës, kujtohen dhe 3460 robërit shqiptarë e italianë të të dy kampeve ndërluftuese, por edhe shtatëdhjetë shqiptarët e zhdukur në Sazan, në anijet italiane ose edhe përtej tyre. Në fakt se sa të "humbur" ishin ata e dinin mirë miqtë e vërtetë të Shtjefën Gjeçovit të kthyer më 17 gusht 1920, që në fakt ishin elita vlonjate (e gjetur nga pushtuesit në Vlorë përgjatë luftës), e burgosur në Sazan si mësuesi Jani Minga, poeti ynë kombëtar Ali Asllani, Dom Mark Vasa, Ibrahim Shyti, Ahmet Nure, Naum Priti, Muço Sharra, Hasan Sharra, Ali Mihali, Hasim Kokoshi, Haxhi Murati, Ali Kreshpani, Mehmet Radhima, Avokatët Taip Peshkëpia, Behxhet Shpati dhe Asaf Çipi, etj. Autori Esat Dauti në kujtimet e tij thotë, që në shtëpinë e Çelo Bajramit në Drashovicë u shtrua një dreqë për nder të burrave të liruar nga gryka e Xhenemit, ku përshëndetën O. Haxhiu dhe S. Koleka. (B. Gaçe, O. Haxhiu, Tiranë, 2020, f.125). Ata ishin pararoja e 1460 shqiptarë të izoluar në Grykën e Xhenemit në Sazan ndërsa 300 robër të tjerë ishin në anijet luftarake italiane. Robërit shqiptarë do të shkëmbeheshin me 1700 oficerë e ushtarë italianë që mbaheshin robër në kampin e Vajzës në Vlorë. Por nëse nga robërit italianë u kthyen të plotë dhe të shëndetshëm, robërit shqiptarë i kthyen të sflitur, të dërrmuar, një pjesë të sëmure e mbi të gjitha shtatëdhjetë shqiptarë nuk u kthyen fare. Njëzetëekatër të burgosurit e parë që erdhën me një motovedetë italiane në mëngjesin e datës 17 gushtit 1920, në skelën e Vlorës, duheshin për të provuar se marrëveshja do të zbatohet e përkuptë nën drejtimin e kapiten Ferid Frashëri dhe toger Tosun Selenica të Xhandarmërisë shqiptare, të ngarkuar nga qeveria e Tiranës. Shtjefën Gjeçovi ishte mikëpritësi i të syrgjynosurve sikurse çdo zemër shqiptare, por që misioni i tij kapërceu gjithnjë kufirin e fratit (të komunitetit besimtar katolik) dhe udhëhoqi sigurinë publike qytetare nën petkun e drejtuesit famulltar të komunitetit që përfaqësonte edhe pse në gjithë qënien e tij rronte një shpirt i paepur atdhetar: Në luftën e '20-tës Shtjefën Gjeçovi në atë periudhë 46 vjeçar, dijetar dhe shenjtur i famshëm, në lidhje me Luftën Kombëtare të Vlorës thoshte: "Filluan Luftën të pëshketun në shpresë të ndihmës së Perëndisë e të bashkimit vël-lazëror, e pa të sosë a me mbetë të gjithë në lam të luftës ose me shpërthe dyert e hekurta e ledhet e çelika të armiqëve", ndërkohë që miku i tij ministri pa protokol S. Koleka thoshte: "Në fushat dhe kodrat e Vlorës u los fati jo vetëm i Vlorës, po mund të themi dhe i gjithë Shqipërisë. Ju o ushtarë, pa armë, pa fishekë, po tarmatosur vetëm me dëshirën e vdekjes për nderin e Atdheut, zut luftë për të shpëtuar në mos Atdheun, të paktën nderin e Atdheut". Tashmë është e dokumentuar se, fetarët në Luftën e Vlorës kanë kontribuar, për ruajtjen e qetësisë shpirtërore, për sigurinë njerëzore, për mbështetje të vazhdueshme materiale dhe për mobilizim për ta parë atdheun të lirë nga pushtimi.

### **Shtjefën Gjeçovi në komisionin organizator të festimeve të Luftës së Vlorës**

Në ditët që pasuan, kur ende nuk ishin shuar krismat dhe tymi i barotit, filluan parapërgatitjet për festimet e bashkimit të Vlorës me Tiranën zyrtare. Më 26 gusht 1920 përfaqësuesit e qytetit u mblodhën në kishën e qytetit, ku në komisionin organizativ ishte edhe At Shtjefën Gjeçovi, krahas kryekatundarit Ali Asllani, Jani Minga, Dom Mark Vasa, Sadik Sorra, Musa Jonuzi, Pandeli Strati,





ishte edhe Shtjefën Gjeçovi, Dom Mark Vasa, Osman Muka Myftiu i Vlorës, Hoxhë Rushiti i Kaninës, Mulla Muhameti nga Kanina etj. Më 5.9.1920, në sallën e Prefekturës, KMK-ja mori katër vendime të rëndësishme: "a). ngriti një komision për ndihma për "bonjakët e të vrarëve" dhe të plagosurve të luftës, b). të bëhen kërkime për eshtrat e Selam Musait dhe shehitëve të tjerë të Qafës së Koçiu, c). të përpilohen listat e shehitëve dhe të plagosurve në llogoret e luftës si dhe të të internuarve në ujëdhesën e Sazanit, d). KMK-ja të kthehet në shoqëri patriotike". (Hamza Isai, Një jetë në shërbim të kombit, Tiranë, 2000, f. 76). Figurën magjike të At Shtjefën Gjeçovit, që mjeshtërisht e me oratori fjalësh derdhte nga goja e tij nguleshin si gurë themeli në shpirtat njerëzore dhe përbalhtë çdo bashkëbiseduesi, pasi "Gjeçovi njëfish nga "turq e të kshtenë" dhe vlerësohej prej të gjithëve si njeri i naltë, jo thjesht si fetar e si frat". Për këtë figura e tij u gdhend natyrshëm përgjatë Luftës së Vlorës.

### **Lidhjet e Gjeçovit me Vlorën të mbujtura në kohë lufte dhe pjesë e çimentuar e ndërgjegjes patriotike shqiptare**

Edhe kur Shtjefën Gjeçovi u largua nga Vlora si famulltar në Pukë, Shkodër e Prizren në vitet 1921-1924 nuk e harroi asnjëherë Vlorën e dashur të lirisë, sepse mbante një korespondencë të ngushtë dhe dërgonte letra e kartolina si me Spiro Koleka, Halim Xhelu, Myqerem Hamzaraj, Jani Minga, Qazim Kokoshi, Ibrahim Shyti, Toli Arapi dhe Dom Mark Vasa. Ndër miqtë më të ngushtë e më të njohur ka pasur Toli S. Arapi dhe Ibrahim Shyti, por edhe mjaftë ushtarakë, që luftuan në Vlorë si të dërguar të qeverisë së Tiranës. Në vitin 1923 qeveria e kohës bëri një tentativë që të shkruhej historia e Luftës së Vlorës dhe në këtë detyrë përfshinë dhe Shtjefën Gjeçovi, por nuk u finalizua, sepse në këtë periudhë, "qeveritë binin si gjethe fiku". Gjeçovi ka dy poezi që ja kushton kësaj lufte kombëtare. Brendia e krijmtarisë së tij të kësaj periudhe ishte lufta dhe fitorja, bashkimi në indipendencën e plotë shqiptare. Pas Kongresit të Lushnjës, Lufta e Vlorës mundësoi "largimin nga buza e greminës dhe shpërbërja e lukujdimit i shtetit". Vlora me luftën e saj ishte forcim i ndërgjegjes patriotike. Lufta kombëtare në Vlorë dërgoi përfundimisht dosjen e "çështjes shqiptare" në arkivë dhe të vulosej përfundimisht pavlefshmëria e Traktatit të fshehtë të Londrës. (Historia e Shqipërisë, vëllimi II, Tiranë, 1965, faqe 496.) Është kjo arsyeja që në vazhden e festimeve shqiptarët në Veri dhe sidomos në jug e festonin 3 shtatorin njëllor si 28 nëntorin për t'i treguar botës dhe brezave sovranitetin e pakufizuar. Prandaj Arben Puto, në pikëpamje të rëndësishme të shenjë e barazimit midis Kongresit të Lushnjës, Luftës së Vlorës dhe pavarësisë së Ismail Qemalit në nëntor 1912. (Arben Puto, Shqipëria politike 1912-1939, Tiranë, 2009, faqe 268). Gjeçovi ishte sy e veshë, sikurse KMK-ja më 7 qershor 1921, kur për herë të parë në historinë e Himarës u vizitua nga qeveritarët e parë shqiptarë, nga Ministri Spiro Koleka, Prefekti Qazim Koculi, kapiten Aqif Përmeti. Shtjefën Gjeçovi ishte në Vlorë me një eksperiencë 22 vjeçare në fushën e arsimit dhe të hapjes së shkollave shqipe. Ai e dinte mirë se, sentenca themelore e kohës në shtyp më 1920-tën ishte: "Të shpëtosh Vlorën do të thotë të shpëtosh Shqipërinë". Shtjefën Gjeçovi ishte në kohën dhe vendin e duhur, i dërguari i shqiptarizmit në mbrojtje të vlonjatëve. Ai u bë bashkë në Vlorë me pjesën elitare të sigurisë dhe shpëtimit të bijëve e bijave të saj nga dhuna e egër e pushtimit, sepse "në Vlonën e famurit luhej fati i gjithë Shqipërisë". Nën veladonin e atit franceskan fshihej prushi i atdhetarizmit, që në fakt bëri shumë në ditët më të egra të pushtimit për të shpëtuar bijtë e bijat Vlorës nga kthetrat e pushtuesit. Shtjefën Gjeçovi, nuk lejoi që të shtoheshin radhët e të burgosurve, të interbuarve dhe të syrgjynosurve në grykën e tmërrshme të Xhenimit në Sazan atje ku u dërgjën pothuaj për tre muajt e luftës një pjesë e ajkës së inteligjencës së Vlorës si miku i tij Ali Asllani, Jani Minga, Dom Mark Vasa etj. Gjeçovi ishte në Vlorë për të dëshmar më 1920-tën amanetin shekullor të shumë brezave, por edhe amanetin e 1912-tës, për ta bërë Shqipërinë "më vete të lirë dhe të mosvarme". Ndërkohë që ai mori pjesë edhe më 28 nëntor 1920, kur në kafenenë e Hamza Harunit, Sulejman Delvina do të merrte nga kryetari i Bashkisë Seit Qemali titullin "Qytetar nderi". S. Delvina u shpreh se, "... gjaku i derdhur në istikamet e Luftës së Vlorës, trimëria dhe burrëria e luftëtarëve të saj do të shkruhen me shkronja të arta në historinë e Shqipërisë". (B. Gaçe, O. Haxhiu, Tiranë, 2020, f.136). Po në këtë datë ditën e shenjitëruar të flamurit Jani Minga do shprehej: "Nderi i shpëtimit të Vlorës u detyrohet armëve të popullit dhe të zotënisë së tij Sulejman beut, i cili luajti rolin më të madh nga pikëpamja politike". (Gazeta "Mbrojtja Kombëtare", nr.9 datë 2.12.1920). Në dhjetra studime një konkluzion është themelor

se, Gjeçovin e thirri në Vlorë, fati tragjik i Atdheut. Gjeçovi firmosi me parinë e Vlorës dhe emri i tij ishte ndërmjet 25 firmëtarëve të datës 28 tetor 1920, që, "të neutralizohej politika personale e disa ministrave dhe organizimi i administratës publike të bëhej me njerëz të ndershëm...". Fakt është se letërkëmbimi i Shtjefën Gjeçovit ka qenë i gjerë dhe i gjithëanshëm, sidomos me Kryetarin e KMK-së Osman Haxhiun. Këtë e deklaroi edhe i biri i Osmanit, Galip Haxhia, i cili shprehej se në shtëpinë tonë ishte një dosje me letrat e 22 personaliteteve të vendit ku binte në sy letërkëmbimi me Shtjefën Gjeçovi. (B. Gaçe, O. Haxhiu, 2020, f.159). Ai përfaqësoi në Vlorë denjësisht trashëgiminë, amanetin dhe unitetin e të gjithë shqiptarëve për identitetin e të gjithë shqiptarëve në një shtet të vetëm, për t'u ndjerë të respektuar në sytë e Europës, për ta shijuar lirinë në kërthizën e qytetërimit shqiptar të Pavarësisë, për të qenë dëshmitar i një epoke të konsolidimit të shqiptarëve në shtet të pavarur brenda Lidhjes së Kombeve, aspiratë që u përmbush më 17 dhjetor të vitit 1920.

### **Gjëmim topash, mesha dhe darka që shtroi Shtjefën Gjeçovi në një vjetorin e Luftës së Vlorës**

Më 3 shtator 1921, në përvjetorin e parë të Luftës së Vlorës vërshuan telegramet e urimit në të gjitha zyrtat postare të vendit. Ishte rasti që udhëheqës, prijësa e luftëtarë të uronin për një vjetorin e fitores. Një urim ishte i vecantë ai i Luigj Gurakuqit, që e përcaktoi 3 shtatorin, "ditë fatëlumë për shpëtimin e kombit", urim që ja përcillte Ibrahim Xhindi, Spiro Koleka, Osman Haxhiu, Qazim Kokoshi, (Telegram që Gurakuqi e niste nga Shëngjini më 2.9.21). (Gazeta "Mbrojtja Kombëtare", nr.46, datë 28.11.1921). Në festimet e njëvjetorit merrte pjesë edhe profesori shqiptarofil Pitardi, që ishte bashkë me Shtjefën Gjeçovin, ku dëgjuan gjëmimet e topave në Kaninë, Babicë, Qafën e Bestrovës dhe Kuzbaba. Pitardi shkoi bashkë me Osman Haxhiun në tre veprimtari të komuniteteve fetare: në ritin muhamedan të Mulla Sulejman Demirit në xhaminë e Muradijes; në meshën e lutjeve në shqip të At Sulejman Gjeçovit në kishën katolike si dhe në meshën po në shqip të At Isait në Kishën Ortodokse. Fakt është se përpara katundarisë së Vlorës Profesor Pitardi do deklaronte: "...ky bashkim dhe kjo dashuri që shikoj në Shqipëri më bën përshtypjen më të mirë dhe më lehtëson studimet për Shqipërinë...". (Gazeta "Koha", Korçë, 13.11.1921). At Shtjefën Gjeçovi në mbrëmjen e datës 3.9.1921 shtroi një darkë zyrtare për nder të Profesor Pitardit. (Antropologu me famë botërore, Pitardi, më vonë në librin e tij "Historia e racave njerëzore", kur flet për shqiptarët, thotë: "Është e vështirë të gesh një popull, si shqiptarët, ku tiparet antropologjike të jenë më të qarta", ndërkohë që për Greqin ai pohon në këtë libër, se "ajo është pasqyrë e popujve të Ballkanit". Këtë gjykim të Pitardit mbi racën shqiptare e pranojnë dhe antropologët të tjerë, që kanë bërë matje mbi të gjallë e mbi të vdekur në Greqi e Shqipëri). Në darkën e shtruar nga Gjeçovi merrnin pjesë Profesor Pitardi, Osman Haxhiu, Jani Minga, Kristo Floqi, Qazim Kokoshi, Eshref Dano, Dom Mark Vasa, At Isai, Ibrahim Abdullai, Ibrahim Shyti, Dr. Shezai Çomo, Dr. Ali Mihalit etj. Në këtë darkë folën Shtjefën Gjeçovi, Jani Minga e Osman Haxhiu, i cili i prezantoi gjerë e gjatë mikut të huaj traditat vlonjate, përpjekjet e shumta për liri e mëvetësi dhe në fund të fjalës së tij tha: "Zoti Pitardi, fati i keq i truallit tonë ka qenë dhe është që Shqipëria ka gjitonë të liq e të pabesë...". (Mihal Peço, Kujtime, 1964, faqe 9). Edhe pse Gjeçovi ishte misionar i besimit dhe atdhetarisë, Vlora ngeli trualli u çimentua dhe u shpalo humanizmi i Shtjefën Gjeçovit. Përgjatë Luftës së Vlorës, figura e Gjeçovit u skalit me shkëlqim dhe madhërishtëm për kontributin e madh në ndihmë të sigurisë njerëzore të vlonjatëve në qytet që ishin nën pushtimin Italian. Shtjefën Gjeçovi u bë në shpëtimitar të qindara familjarëve të Vlorës, si dhe veçanërisht të grave dhe të fëmijëve të kërcënuar nga pushtuesit. Veladoni i fesë nuk e pengoi atë të kryente një mision fisnik që ishte Brenda parimeve të tij themelore për sigurinë dhe bashkëjetesën e të gjithë komuniteteve.

### **Vepra e Gjeçovit që ndriçon si pishtarë i përjetshëm!**

Kompletimi me arsimim i franceskanëve në Austri dhe Italisë e zgjeroi dritën e dijes por edhe interesimin e Gjeçovit për historinë e shqiptarëve dhe vendin e popullit të tij krahas civilizimeve të tjera ballkanikë e europianë, për fillimet e krishtëritimit, për arkeologji, etnografi, gjuhësi e letërsi. Provoi të shkruante vetë dhe të tellohej në shkencat humane, krahas detyrimeve që rrjedhin nga predikimi i Ungjillit të Krishtit. Në moshën 22 vjeçare më 1896, kur u kthye në Troshan si famulltar i ri i pajisur me dije të thella me kulturë të gjerë, por edhe energji të shumta, krahas zhguni të murrmë të

fratit fitoi aftësinë e mësimdhënies, aftësi që do ta vinte në veprim në interes të përhapjes së gjuhës dhe kulturës shqiptare. Shtjefën Gjeçovi predikoi ungjillin në Rubik, Pejë, Laç-Sebaste, Zarë, Sapë, Theth, Prekal, Vlorë, Shkodër, Gjakovë e Zym të Hasit (për kohën rrethinë e Prizrenit). Vitet që pasuan pas kapërcimit të shekujve, më 1900-ën, Gjeçovi pati angazhim të plotë në shumë fusha të kulturës dhe të arsimit. U konsolidua si shkrimtar duke shkruar në të tria gjinitë letrare. Detyra e françeskanit e çoi në shumë vendet he kudo ku shkonte mblodhi shkrime të rralla, këngë, mite, legjenda, përralla, doke e zakone popullore, por një ndër kryeveprat e tij është "Kanuni i Lekë Dukagjinit", i cilësuar pa rezerva monument i gjuhës dhe kulturës së Kombit Shqiptar. Vepra e Gjeçovit e formatuar në 1263 nene, nisi të botohej për herë të parë tek "Albania" e Konicës më 1897-1898, më mbrapa edhe në organin e shtypit të françeskanëve që nga dalja e "Hyllit të Dritës" më 1913 deri më 1924. Botimi i plotë doli më 1933, pas vdekjes së autorit me parathënie të Gjergj Fishtës; ndërkohë që titulli u përzgjedh nga Fishta që ishte një fjalëformim Lekë (malësor, sipas kumtit parak, banorët e Malësisë së Madhe) dhe Dukagjin. Më vonë "Kanuni" u përkthye pjesë-pjesë, nga mikësja e shqiptarëve dhe e Egerem Vlorës, baronesha Marie Amelie von Godin, edhe me ndihmën e etërve françeskan. Ky punim bëri të mundur që më 1936, Universiteti 600 vjeçar gjerman i Lajpcigut në Drezden t'i akordojë titullin "Doktor i shkencave in honoris causa", postum Shtjefën Gjeçovit për vlerën e Kanunit. Në gjuhën italiane, Kanuni u përkthye nga Pal Dodaj në bashkëpunim me Giuseppe Schiro dhe u botua nga Akademia e Arteve dhe Shkencave në Romë më 1941. Shtjefën Gjeçovi ka edhe një seri veprash të tjera si, "Dashnia e atdheut", drama "Agimi i qytetnisë", "Shqiptari ngadhënyjes", "Përkrenarja e Skënderbeut", "Kanuni i Lekë Dukagjinit", vepra "Trashëgime trako-ilire", "Jeta e Shën Luçisë, Shna Ndou i Pades, Atil Reguli" – përkthim i lirë i dramës me 3 akte të Pjetër Metasatasit, "Vazja e Orleanit" ose "Zhan D'Ark" mbas A.F. prej Bergamaso, punimi teologjik "Shpërblesi i botës ase Jeta e Jezu Krishtit", e shkruar në frymën e gjuhës shqipe dhe në frymën e dashurisë për Krishtërimin. Por shumica e veprave të Shtjefën Gjeçovit mbetën në dorëshkrim, si "Princa i Dibrave", "Mojs Golemi" (Dramë), "Mnera e Prezës" etj., shumica e këtyre dorëshkrimeve ruhen në Arkivin e Shtetit në Tiranë. Puna e Gjeçovit është në vazhdim e veprimtarëve të Rilindjes për të mblodhur e për të dëshmuar traditat kombëtare dhe lashtësinë historike, kulturën e tyre materiale dhe shpirtërore të shqiptarëve, duke lëvruar fjalën shqipe dhe ngritur ndërgjegjen kombëtare. Edhe vepra "Kanuja" u botua pas vrasjes së tij. Gjeçovit i janë kushtuar shkrime të shumta, si françeskani Atë Pashkë Bardhi, historiani i fretërve që e njohi nga afër, por mbi të gjitha qëndron monografia "Shtjefën Gjeçovi, Jeta, vepra" shkruar nga Ruzhdi Mata. Shtjefën Gjeçovi mbeti monument vlerash të pashterueshme, pishtar i ndriçimit të historisë, gjuhës dhe kulturës së kombit. Monumentale ka ngelur shprehja e tij: "Gjuha e një komit s'kaa t'ndalun, as nuk mund t'ndalët kurr". "Sa mund t'mëndohet dielli pa dritë, aq mund t'mëndohet komi pa gjuhë". Vlerat e gjyhes dhe kulturës qëndrojnë në themel të kombit pasi "...gjuha është një gjëa sënd qi nuk mund t'blehet, nuk shitet e nuk ndrohet; një sënd është, qi do t'ruhet si një gur i çmue, do t'ruhet si një dhântii e posaçme e Perendëis e si një trashigim i t'parvet tonë... do t'ruhet si drita e synit. Kjo dhântii... është gjuha shqype". Bashkëkohës dhe studiues të të gjitha kohrave përbashkohen në vlerësimin e figurës së Shtjefën Gjeçovit: Figurë poliedrike e historisë dhe kulturës shqiptare, që punoi fort në gjithë fushat e diturisë, që çuditi me kulturën e tij Faik Konicën, i cili e përshkruan me nderim e simpati të thellë; mrekulloi shkrimtarin e ri të shkollës letrare shkodrane, Dom Lazër Shantojën, i cili i kushtoi një portretizim të veçantë, duke e radhitur përkrah Fishtës e Harapit. Gjeçovi është klasifikuar si historian, etnograf, arkeolog, mbrojtës i flaktë i sigurisë njerëzore gjatë Luftës së Vlorës.

### **Kolonat arbërore të Kanunit të Lekë Dukagjinit të qëmtuar nga Gjeçovi**

Një ndër kontributet e jashtëzakonshme në jetë të Shtjefën Gjeçovit është padyshim "Kanuni i Lekë Dukagjinit". Vepëra e Gjeçovit të cilën e mblodhi dhe kodifikoi me sukses është ndërtuar mbi bazën e katër kolonave të mëdha që janë: "nderi, mikëpritja, sjellja dhe fisi". Kanuni i Lekë Dukagjinit i përbërë nga dymbëdhjetë libra: Kisha, Familja, Martesa, Shpi Gja e Pronë, Puna, Të dhanuat, Fjala e Gojës, Ndera, Damet, Kanuni kundër mbrapshtinëve, Kanuni i Pleqnisë, Shlirime e përjashtime. Edhe pse praktika e ligjeve të kanunit mund të datojë që në kohën e bronxit (pikëpamje e Edit Durham), disa gjykojnë se kanonet vijnë nga fiset tribale



ilire, ndërsa të tjerë gjykojnë se kanuni mbart element të epokave prehistorike indoeuropiane. Edhe pse gjithë kanuni që mblodhi dhe kodifikoi Shtjefën Gjeçovi, i atribohet Princit shqiptar Lekë Dukagjinit, rregullat e tij evoluan si rrugë për të sjellë rregulla e ligje në truallin shqiptar të gegërishtes. Shtjefën Gjeçovi, me veprën e tij ngelet ndër figurat më të mëdha të krishterimit që ju përkushtua kulturës kombëtare shqiptare, me kontribut me shpirt e zemër prej gjeniu krahas Pjetër Budit, Pjetër Bogdani, Gjon Kazazi, Gjergj Fishta, Atë Anton Harapi etj. Shtjefën Gjeçovi mbeti përjetësisht pishtar i gjallë i ndriçimit të historisë dhe kulturës së kombit të tij, të cilat u bënë për të pashaporta shpirtërore e qëndresës deri në frymën e fundit. Kur Faik Konica u njoh me dorëshkrimin e "Kanunit..." me 2000 faqe, ta hartuar nga i pavdekshmi Shtjefën Gjeçovi, i cili "kish mblodhur, radhitur dhe ndritur të gjitha sa kanë mbetur nga mendimet juridike të Shqipërisë në kohën e mesme...", Konica e mbylli shkrimin me këto fjalë: "Emri i këtij njeriu të rrallë do të vejë duke u rritur dhe një ditë famullia e Gomsiqes do të jetë një nga gurët e shënjtëruar të Shqipëtarësisë". Po kaq i nderuar e respektuar në rrethet akademike shqiptare ngelet edhe "personalisti me moshën e shtetit", Profesor Ismet Elezi me dy librat monumentale: "E drejta zakonore labe" dhe "Kanuni i Labërisë". Profesor Ismet Elezi është Gjeçovi i Labërisë, që materializoi në nene atë kanun, që rronte në popull shekujve, të njejtën punë që kishte bërë dikur Shtjefën Gjeçovi.

### **Shtjefën Gjeçovi në fokus të penave që i bëjnë nder kulturës kombëtare shqiptar**

Të marrësh penën dhe të shkruash nuk është një punë e lehtë sepse kërkohet impenjim serioz për të shprehur mendimet, ndjenjat, përjetimet, imagjinatën për tipe e karaktere, që në fakt për figura që ndritin në historinë e kombit sikurse është At Shtjefën Gjeçovi, figura e tij ta lehtëson punën. Këtu nuk hyn shumë në punë as fantasia dhe as imagjinate kur "përballë", në "prehërin" e historiografisë ke një figurë të përmasave kombëtare, Gjeçovin e madh. Nuk ka nevojë të jesh as "piktur telajoje", as "fantazist", mjafton të shfletosh e hulumtosh, të tregosh për njeriun e thjeshtë, të mundësosh depërtimin në arkiva e biblioteka, të grumbullosh e hulumtosh mbi të shkruarën që i dha dritë e mençuri shqiptarizms. Vetë jeta e Shtjefën Gjeçovit është një imazh drite dhe pune, një meteor gjithmonë i ndriçuar, një pasionant atdhetar që përhapte dritë shprese, mbrojtjeje e gëzimi, një personalitet i cili është si një shkollë mendimi e veprimi, një aktor real i përditshmërisë shqiptare, mësues i paepur i shqipes që synonte të kapërcente ndarjet dialektore duke e quajtur gjuhën pasurinë më të madhe që kishin krijuar e ruajtur shqiptarët, që mishëron përhapjen e kulturës kombëtare kudo ku flitet gjuha arbërore. Mjafton të shfletosh dhe të shfrytëzosh burimet e shkruara nga Faik Konica që botoi një shkrim në gazetën "Dielli" të Bostonit më 1930, me titull "Ca kujtime mbi At Gjeçovin", që më pas u përfshi në veprën "Kanuni i Lekë Dukagjinit", më 1933, por edhe shkrime të Moikom Zeqo, Pëllumb Xhufi, Shaban Sinani, Bardhosh Gaçe, Njazi Kazazi, Jaho Braho, Bajram Xhafa, Bilbil Dervishi, Xhemal Meçe, Ruzhdi Mata, Biblioteka Françeskane e Shkodrës, Karl Gurakuqi, Muhamet Bela, Laurant Bica, Isak Ahmeti, Tomor Osmani, Kujtim Dashi, Lazër Radi, etj., për të plotësuar figurën e plotë të atdhetarit françeskan Shtjefën Gjeçovi. Edhe pse duhet thënë se kryevepra e Gjeçovit është mesazhi njerëzor i veprës së tij, vepër e mbushur me plot atdhedashuri, që edhe pse u vra pas shpine nga qarqe thellësisht antishqiptare nuk mundën as ta shuanin dhe as ta fshinin punën e një titani të letrave shqipe dhe luftëtari të çështjes kombëtare, ndërkohë që ai la 10.000 faqe dorëshkrime. Mesazhi i veprës së tij do të flasë qartë nëpër breza. Sikurse Aristoteli që meriton nderin



e të qenit "Mësues absolut" ose "Mësuesi i parë" i perëndimit, për shqiptarët Shtjefën Gjeçovi konsiderohet si mësues absolut. "Shkrimi" që latinisht quhet "scriptum", është një art i veçantë për t'ua nxjerrë fjalën sa më të bukur, atë që gjatë gjithë jetës Gjeçovi e ngriti në art. Përtej legjendave të shkrimit "ideografik", nga kinezët, meksikanët, egjiptianët e deri amerikanët, çdo komb e kombësi i dha gjuhës së vet formatin e shenjtërisë si gjuhë "gjuhë perëndie". Kështu edhe shqipja kishte shkrimin e saj si çdo gjuhë, por edhe kaligrafinë aq të folur e përfolur shekujve, aq sa Aristoteli, ish-mësuesi i Aleksandrit të Madh thoshte: "Shpirti i njerëzve përcaktohet sipas kaligrafisë së tyre", Ndërkohë që Johan Wolfgang Gëte shkruante se "Kaligrafia përcakton edhe shumë anë të karakterit të njeriut". Prandaj edhe Shtjefën Gjeçovi mendonte se, "...gjuhën shqipe e ka qdënduar Perëndia në trurin e shqiptarëve dhe për shqiptarët", një format karakteri të qëndrueshëm dhe besues. Gjithçka e bënte për "naltësimin e atdheut, tue qitë në dritë visaret e panjoftuna të folklorës, të etnografisë, të arkeologjisë e të historisë sonë të lashtë", edhe përmes zbulimit të tumave ilire si dhe duke bërë të njohur punimet e arkeologëve të njohur si Ugolini, Marucchi, Nopçe etj. Sot emrin "Shtjefën Gjeçovi" e gjen në shumë shkolla në Shqipëri dhe në Kosovë, në emërtime rrugësh, në libra shkollë. Ai është dekoruar me Urdhrin "Për veprimtari patriotike", Urdhrin "Naim Frashëri" të kl. I., "Mësuesi i popullit", Universiteti i Lajpcigut ndër universitetet më të vjetra të botës, (themeluar më 2 dhjetor 1409 nga Frederiku I) i dha titullin "Doctor honoris causa" mw 1936; është përfshirë në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar, janë ngritur buste e memorialë, por sigurisht nderimi për këtë figurë mbarëkombëtare do të vijojë.

### Kryeziu-Djepi i kulturës që lindi burra të mëdhenj të kombit

Shtjefën Gjeçovi u lind, rrit dhe edukua në një truall me atdhetari të rrallë, por krenaria e origjinës së prindërve të tij e Kryeziut është krenari legjitime. Ligjimiteti i origjinës është frymëzues për brezat e një treve atdhetare, që krenarinë e të qenit bashkëfshatarë të Shtjefën Gjeçovit nuk e fshehin, duke e mbajtur lartë frymën e besnikërisë dhe shërbimit ndaj kombit. Kryeziu i shquar për qëndresë heroike mbarëpopullore kundër egërsisë pushtuese osmane e ka përjetuar këtë qëndresë në një lapidar. Lapidari u flet brezave të Kryeziut për traditat malësore, për qëndresën e Fletit, luftimet e Bardhetit, në pritën e Shkallës së Bushtres etj. Prandaj me të drejtë Kryeziu i luftave, mençurisë, luftës për jetën dhe ku jeta rilindet përmes fushëbetejash është mjaft i përmendur në historinë tonë kombëtare. Kryeziu është vetëm gjashtë km nga Fushë-Arrëzi, në verilindje të tij përbri burimeve të Fanit të Madh. Burimet e Fanit të Madh zbrasin përmes katër përrenjëve kryesorë: Përroi Ndërmjec, Bens, Oroshit dhe Lajthizës. Fshati përbëhet nga tri lugina të thella pjellore, aq sa dikur quhej Kosova e Vogël. Në lindje të fshatit është Kodra e Madhe, që vazhdon nga Qafa Bens deri tek Ura Bardhetit. Në verilindje shtrihet Kunorë Dardha, që lidhet me Majnë e Malit e Kodrën e Madhe, për mes Lak Hithit e Qafë Bens. Kryeziu ose "Bardhet" siç thirrej deri në mes të shek. XVII, sipas Frang Bardhit, ky fshat ishte një nga më të mëdhenjtë e Pukës, fshat që ka qenë luftë të përhershme me pushtuesit osmanë. Nga këto lufta detyroheshin të largoheshin, herë pas herë banorët e këtij fshati e vendin e disa fiseve e zinin fise të tjera. Gojëdhënat tregojnë se, fshati ka marrë emrin "Kryezi" nga fakti se sipër fshatit, në krye të tij, ishte një pyll i dendur e i zi pishash; ndërkohë që një gojëdhënë tjetër thotë se, fshati e ka marrë emrin nga Kryezezët e Mirditës, (një ndër dymbëdhjetë bajraquet e trevës veriore), të cilët janë vendosur këtu në shekullin XVII-XVIII, edhe pse sot ky fis nuk ekziston në këtë fshat. Nga mesi i shekullit XVII, në Kryezi vijnë nga lialla, nga dera e zotrinjve një burrë dhe një grua, të cilët dalgadalë ata u shumuan dhe u forcuan aq shumë, sa u bënë pronarë të mëdhenj, duke e shpallur pronë të tyre vendin që nga Ura Bardhetit, Qafë Mali, Qafë Bena, lak Hithi, Kunorë Dardha, Qafë Ballshi, Fushë Mrijaj e Kodër Nushaj. Kushdo që të vinte, pas tyre duhej që të bëhej çifçi, bujk i përkohshëm në tokat e zotërinjve, të cilëve u paguanin rreth një të tretën e prodhimeve bujqësore. Çifçinjtë filluan të vijnë nga krahina të ndryshme, për vështirësi jetese ose për t'ua larguar për arsye të gjaqeve. Herë-herë zotërinjtë binin në përlëshje me çifçit, sepse ata nuk e duronin shtypjen dhe dhunimin. Kështu, në mes të zotërinjve të Aliajve shpërtheu grindja. Në shekullin XIX zotërinjtë u fuqizun edhe më shumë dhe bënë përpjekje për të sunduar në gjithë trevën



e Pukës dhe lballës. Më 1911 malësorët e Kryeziut u bashkuan me Bajram Deklanin dhe luftuan rreth tre muaj kundër osmanëve, në atë që quhet "Kryengritja antiosmane e Qafë Malit" duke e bërë rrugën Shkodër-Prizren të pakalueshme tek Ura Bardhetit. Kryeziat ishin mbështetës aktiv të lëvizjeve patriotike për pavarësi, liri e demokraci si dhe në mbrojtje të kufive të Shqipërisë e deri te Revolucioni i Qershorit 1924. Kryeziu u bë streha e patriotëve dhe luftëtarëve të mëdhenj si Isa Boletini, Hasan Prishtina, Bajram Curri, Shote e Azem Galica etj. Më 1912 kryezezët i shkuan në ndihmë Shkodrës, që luftonte kundër ushtrive serbo-malazeze, por edhe më vonë fshati pati një orientim të qartë në drejtimin e duhur të historisë. Aktualisht Kryeziu është përzgjedhur në projektin e qeverisë shqiptare të 100 fshatrave me perspektivë zhvillimi turistike për bukuritë e luginës, mozaikun piktoresk natyror, për trashëgimitë e pasura natyrore dhe humane, relievin e larmishëm kodrinor e malor, për klimën e bekuar malore shëruese, resurset e pafundme medicinale aromatike e ujor, objektet monumentale natyrore ujvara, gjelbrim, histori e traditë, performacë gjithëvjetoare për zhvillimin e turizmit të gjelbër, të bardhë, kulturor, sportiv, kurativ, agroturizëm etj., kisha e Kodër Gegës, xhamija Arifaj, objektet e lashtësisë mesjetare si Rruga antike Adriatik-Dardani; mullinj të blojes në Gegaj, Fercoj, Lajthizë, Arifaj. Frang Bardhi më 1637 ka celebruar meshë për banorët e zonës në kishën e Shna Prenës që është shumë e hershme. Kryezi është vendi i bashkëjetesës së dymbëdhjetë fiseve me dy besime, katolik e mysliman me bashkëjetesë fetare e fisnore nëpër shekuj, e trashëgueshme në breza. Djemtë e vajzat e Kryeziut ecën në gjurmët e Shtjefën Gjeçovit për shkollim, arsimim e prosperitet duke u dalluar e cilësuar në të gjithë zonën por edhe më gjerë për zgjuarsi, atdhetari dhe përkushtim. Puna dhe djersa janë simbolika e së sotmes dhe garanci e së nesërës për ta kthyer vendlindjen në vëmëndjen ekonomike të së sotmes dhe të së nesërës. Patëritizmi dhe atdhetaria e djemve të Kryeziut si dhe gjithë trevës pukjane spikat në mençurinë dhe përfaqësimin dinjitoz në çdo fushë të jetës dhe të dijës, duke i bërë nder vendlindjes, trashëgimisë historiko-kulturore, që po t'i shtosh gjakun e derdhur të bijëve të saj e rendit trevën në avantagë të një prej trevave më të shquara të Republikës. Kryeziu është djepi i kulturës që lindi burra të mëdhenj, prandaj është i mbushur me histori, traditë, e kulturë, sepse është origjina e korifenjve të letrave shqipe At' Shtjefën Gjeçovi-Kryeziu dhe Ndre Mjeda, me të cilët krenohet kultura kombëtare shqiptare. Vatra e arsimimit që është shkolla e Kryeziut ku përgatiten brezat e së ardhmes mban emrin e shkrimtarit, poetit kombëtar, françeskanit dhe mëmëdhetarit të spikatur "Shtjefën Gjeçovi".

#### Bibliografi:

Ago Agaj, Lufta e Vlorës, Tiranë, Toena, 2002; AQSH, Fondi 58, Shtjefën Gjeçovi, Dosja 95/14 dhe 95/15; Arben Puto, Shqipëria politike 1912-1939, Tiranë, 2009; Bardhosh Gaçe, Osman Haxhiu, Tiranë, 2020; Bardhosh Gaçe, Spiro Jorgo Koleka dhe fati tragjik i atdheut, Tiranë, 2010; Bernard Zotaj, Shahin Leka, Strategjia dhe taktika e Luftës së Vlorës, Tiranë, 2016; Donat P. Kurti, Provinça Françeskane Shqiptare, Shkodër: Botime Françeskane, 1965; Faik Konica, portret mbi At Gjeçovin, "ca kujtime mbi At Gjeçovin", 1925; Gani Iliaz Abazi, "Lufta e Vlorës në kujtimet e mia", Tiranë, 1995. Gazeta "Koha", Korçë, nr.10, datë 11.9.1920 si dhe 13.11.1921; Gazeta "Mbrojtja Kombëtare", nr.4 datë 4.11.1920, nr.9 datë 2.12.1920 si dhe nr.46, datë 28.11.1921; Gazeta "Politika", Vlorë, periodiku, 1923-1924; Hamza Isai, Një jetë në shërbim të kombit, Tiranë, 2000; Historia e Shqipërisë, vëllimi II, Tiranë, 1965; Lufta Kombëtare e Vlorës, Rilindja e Pavarësisë, Përmblendje e kumesave të mbajtura për 100 vjetorin e Luftës së Vlorës, Tiranë, Onufri, 2020; Mihal Peço Doko, Kujtime për Lufta e Vlorës, Tiranë, 1964; Muin Çami, Lufta çlirimtare 1918-1920, Tiranë: Toena, 1969; Muin Çami, Lufta e Vlorës, Tiranë: Toena, 2000; Pavarësia e shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shek.XX, Tiranë, 2008; Revista "Arsimi Popullor", nr.3, viti 1963 botohen dokumente në lidhje me Gjeçovin-mësu i gjuhës shqipe; Ruzhdi Mata, "Shtjefën Gjeçovi, Jeta, vepra", Tiranë, (me 184 faqe); Ruzhdi Mata, Komisia Letrare Shqipe për lëvrimin e gjuhës shqipe, gazeta "Mësuesi", 28.8.1916; Shtjefën Gjeçovi, Agimi i Gjytetnisi, Shkodër, 1910; Shtjefën Gjeçovi, Vepra 4 - Redaksia e Botimeve Rilindja, Prishtinë, 1985; Lila O. Letrat e panjohura të Shtjefën Gjeçovit: korrespondenca në dorëshkrim, Gazeta shqiptare ("Milosao"-suplement), Nr. 4295, 27.07.2007, faqe II - III; Shtjefën Gjeçovi, Parradja e popullit ase Kryengritja e Dheut të rrethit të Krues me 54 pleq në krye, kundra urdhëve e dokeve të reja t'osmanllive: 1903-1904-1905-1906, (dorëshkrim), Laç-Sebaste, 1922; Dimitër Shuteriqi, Shtjefën Gjeçovi dhe kambana e Sopotit shkëputur nga Ditari i Dhimtër Shuteriqit, Belësh 7 maj 1972; Robert Elsie, Histori e Letërsisë shqiptare, përktheu Abdurrahman Myftiu, Tirana & Peja: Dukagjini, 1997.

# FORCAT E ARMATOSURA NË LUFTË PËR SHUARJEN E ZJARREVE

